



NDIHMA E
PARË NDAJ
TRASHËGIMISË
KULTURORE NË
KOHË KRIZASH

NDIHMJA E PARË NDAJ TRASHËGIMISË KULTURORE NË KOHË KRIZASH

1. Udhëzues

Për masat e sigurimit të trashëgimisë materiale dhe jomateriale përmes përgjigjes së bashkërenduar dhe gatishmërisë ndaj emergjencave.

Aparna Tandon

Botuar nga Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Ruajtjes dhe Restaurimit të Pasurisë Kulturore (ICCROM), Via di San Michele 13, 00153 Romë, Itali;

nga Fondi Prince Claus për Kulturë dhe Zhvillim, Herengracht 603, 1017 CE Amsterdam, Holandë;

dhe nga Fondacioni Trashëgimia Kulturore pa Kufij - Shqipëri (CHwB Albania), Rr. "Ismail Qemali", P.34/I Kt. VII Zy.31, Tiranë, Shqipëri, dhe Fondacioni Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB Kosovo*), Rr. "Nezir Gashi", nr.38, Prishtinë, Kosovë*;

në kuadrin e bashkëpunimit mes ICCROM-it, "Prince Claus Fund" dhe Institutit Smithsonian për zhvillimin e kapaciteteve të gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave për trashëgiminë kulturore.

©ICCROM, Fondi Prince Claus për Kulturë dhe Zhvillim, Fondacioni Trashëgimia Kulturore pa Kufij - Shqipëri (CHwB Albania), Fondacioni Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB Kosovo*) 2023

ICCROM, Prince Claus Fund, Cultural Heritage Without Borders, 2022

ISBN 978-92-9077-329-0

CHwB Albania ISBN 9789928801067

CHwB Kosovo* ISBN 9789951895743

BASHKAUTORË

Autor dhe redaktor kryesor Aparna Tandon, ICCROM

KONTRIBUES TË FUSHAVE PËRKATËSE

Vlerësimi në vend i dëmit dhe i riskut, pas ngjarjes

Rohit Jigyasu, Eugénie Crété, Elke Selter

Sigurimi dhe stabilizimi

Eugénie Crété, Elke Selter, Xavier Romão, Esmeralda Paupério

Shembuj

María Cecilia Rodríguez Moreno, Eugénie Crété, Ihor Poshyvailo, Kyaw Myo Ko, Elke Selter, Valentina Spano, Layla Salih

Redaktimi shkencor

Jessica Doyle, Jonathan Eaton, Sonia Giovinazzi

Puna kërkimore

Jessica Doyle, Valentina Spano

Kompozimi grafik

Christopher Malapitan

KOORDINIMI

ICCROM

Catherine Antomarchi, Aparna Tandon, Jennifer Copithorne, Isabelle de Brisic & Isabelle Verger

Prince Claus Fund

Deborah Stolk

KOORDINIMI I PUBLIKIMIT NË GJUHËN SHQIPE

Elena Mamani, Ana Pekmezi dhe Erinë Mulolli Zajmi
CHwB Albania dhe CHwB Kosovo*

Përkthimi në shqip

Enkeleda Roze, Anisa Mano, Marsela Plyku
Demaj, Klodjana Gjata

Redaktimi gjuhësor

Rudina Çupi dhe Boiken Abazi

Përkthimi dhe botimi në gjuhën shqipe është mundësuar falë mbështetjes së Prince Claus Fund dhe CER.



Ky botim është në dispozicion në Open Access nën licencën Attribution-NonCommercial-ShareAlike 4.0 International (CC BY-NC-SA 4.0) (<https://creativecommons.org/licenses/by-nc-sa/4.0/>). Duke përdorur përmbajtjen e këtij botimi, përdoruesit pranojnë të kufizohen nga kushtet e përdorimit të Open Access ICCROM.

Përcaktimet e përdorura dhe prezantimi i materialit në këtë botim nuk nënkuptojnë shprehjen e ndonjë mendimi nga ana e ICCROM-it dhe Fondit Prince Claus për Kulturë dhe Zhvillim lidhur me statusin ligjor të çdo vendi, territori, qyteti, zone ose autoriteteve të tij ose në lidhje me caktimin e kufijve ose zonave kufitare.

Idetë dhe mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve; ato nuk janë domosdoshmërisht të ICCROM-it dhe të Fondit Prince Claus për Kulturë dhe Zhvillim dhe nuk krijojnë detyrim për këto Organizata.

*Referenca për Kosovën nuk paragjykon pozicionet rreth statusit dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

PËRMBAJTJA

Parathënie	5
Hyrje	6
Përdorimi i Udhëzuesit	8



Prezantimi i ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore

• Çfarë është ndihma e parë ndaj trashëgimisë kulturore ...	10
• Si ta sigurojmë atë?	11
• Kush mund ta fillojë atë?	14
• Përse duhet koordinimi?	18
• Kur ta sigurojmë atë?	20



Hapi 1: Analiza e situatës

• Çfarë është analiza e situatës?	25
• Përse të ndërmerret analiza e situatës?	26
• Kush duhet të marrë pjesë?	27
• Si ta zbatojmë atë?	28



Hapi 2: Vlerësimi në vend i dëmit dhe i riskut, pas ngjarjes

• Çfarë është vlerësimi në vend i dëmit dhe i riskut, pas ngjarjes	43
• Pse duhet bërë ky vlerësim?	44
• Si ta zbatojmë atë?	45



Hapi 3: Sigurimi dhe stabilizimi

• Çfarë është sigurimi dhe stabilizimi?	69
• Kush mund ta zbatojë sigurimin dhe stabilizimin?	70
• Siguroni vendin	73
• Evakuimi pas ngjarjes	77
• Shpëtimi	88
• Stabilizimi emergjent i strukturave	104
• Sigurimi i trashëgimisë jomateriale	117



Rimëkëmbja e menjëhershme

• Çfarë është rimëkëmbja e menjëhershme ?	125
• Veprime të rekomanduara	127
• Përfundime	135

Fjalor	136
--------------	-----

Referenca	150
-----------------	-----

PARATHËNIE

Kultura njihet si shtytë për zhvillimin. Gjithsesi, vite të tëra përfitimesh nga zhvillimi mund të fshihen në një çast të vetëm kur godet një fatkeqësi, duke i kthyer komunitetet pas në kohë me pasoja tragjike. Megjithatë, në të tilla situata vuajtjesh dhe humbjesh, kanë spikatur histori rimëkëmbjeje në të cilat kultura ka luajtur rol thelbësor. Kjo e ka nxitur komunitetin shkencor për ta ndjekur më nga afër ndërveprimin midis traditave kulturore dhe mekanizmave të përballimit.

Kredoja e Fondacionit Prince Claus – sipas të cilit kultura është një nevojë themelore – lidhet ngushtë me parimin e vetë ICCROM-it për konservimin e kulturës dhe për promovimin e larmisë. Me këtë pikësynim, të dyja organizatat janë bashkuar për të zhvilluar një mjet, i cili do të ndihmojë në përfshirjen e palëve kryesore të interesit, komunitetit, në rimëkëmbjen e siteve dhe të objekteve me rëndësi. Kjo, nga ana tjetër, i ndihmon ata të zhvillojnë aftësi përtëritëse ndaj fatkeqësive në të ardhmen.

Një ndër sfidat kryesore me të cilat përballlemi është se konsideratat për trashëgiminë kulturore nuk janë zyrtarisht të përfshira, në shumicën e sistemeve kombëtare dhe lokale të përgjigjes ndaj emergjencave. Megjithatë, operatorët e ndihmës së parë do t’ju dëshmojnë se ata janë të përfshirë pashmangshmërisht në shpëtimin e trashëgimisë, në disa raste për të shmangur që vendasit të rrezikojnë jetën duke u përpjekur ta shpëtojnë atë dhe në raste të tjera sepse ata janë plotësisht të vetëdijshëm për rolin e rëndësishëm që luan trashëgimia në tejkalimin e humbjes dhe traumës.

Kultura nuk mund të presë. Si ICCROM-i, ashtu edhe Fondacioni “Prince Claus” e besojnë fort këtë. Në vitin 2010, ICCROM-i së bashku me Ministrinë Italiane të Kulturës dhe disa partnerë të tjerë, hapën kursin “Ndhima e parë ndaj trashëgimisë kulturore në kohë krizash”. Kjo nismë u zgjerua edhe më tej me pjesëmarrjen e Institutit Smithsonian dhe Fondacionit “Prince Claus”, i cili ka luajtur një rol kryesor në forcimin e rrjetit “të operatorëve të ndihmës së parë për kulturën” dhe në financimin e nismave të pjesëmarrësve, për t’u siguruar që rezultatet pozitive të shumëfishohen.

Ky libër ka për qëllim të përmbledhë proceset e Ndhmës së Parë dhe të nxisë më tej punën kërkimore, veprimtaritë dhe ndërjegjësimin. Krijuesit e këtij libri janë të vetëdijshëm se çdo emergjencë na mëson gjëra të reja dhe na bën të mundur të vazhdojmë të mbylлим boshllëqet që kemi në njohuri dhe në praktikë. Informacioni përmban pikëpamje të shumta, në përpjekje për të ndezur diskutime gjithëpërfshirëse për këtë temë dhe për të zgjeruar bashkëbisedimin.

Pa dyshim që zvogëlimi i riskut të fatkeqësive ka të bëjë me zhvillimin. Ne shpresojmë që ky *Udhëzues* dhe *Paketa e mjeteve* që e shoqëron, me këshillat e tyre praktike, të hapin shtigje të reja sa i përket ruajtjes së kulturës, gjë që fillon me zhvillimin dhe përfundon me rimëkëmbjen.

Webber Ndoro
Drejtor i Përgjithshëm, ICCROM

Joumana El Zein Khoury
Drejtor i Fondacionit Prince Claus
për Kulturë dhe Zhvillim

HYRJE

Pse duhet ta ruajmë trashëgiminë kulturore gjatë një krize humanitare?

Kultura nuk mund të presë. Thuajse një muaj pas tërmeteve shkatërruese të vitit 2015, midis rrënojave të tempujve të rënë në sheshin historik “Durbar” të Kathmandusë, në Nepal, u panë besimtarët dhe shitësit e luleve. Duke sfiduar pasgoditjet, ata shkuan atje për të gjetur ngushëllim në ritualet e përditshme fetare dhe për të rifilluar praktikën e tyre të zakonshme – duke treguar se, për të zvogëluar cenueshmërinë e popullit nepalez ndaj tërmeteve në të ardhmen, të parët që duhet të siguroheshin e të stabilizoheshin ishin tempujt antikë dhe sheshet e qyteteve të Nepalit.

Një vit më vonë, ndërsa po kryenin operacionet e kërkim-shpëtimit pas tërmetit, zjarrfikësit në Itali ndihmuan komunitetin lokal në evakuimin e pikturës “Maddonna Addolorata” (“Zoja e Dhimbshme”) të një kishe në Norcia (Norça), para se ajo të shembej plotësisht dy muaj më vonë nga tërmeti pasardhës. Zjarrfikësit i dhanë përparësi shpëtimit të pikturës, sepse e kuptuan që për njerëzit e Norica-s, Zoja simbolizonte vazhdimësinë dhe përtëritjen, pasi njihej fakti që ajo u kishte mbijetuar tërmeteve të mëparshme.

Aktet vetëmohuese dhe vullnetare të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore gjatë krizave humanitare nuk kufizohen vetëm në rastet e fatkeqësive. Njihen shumë raste që komunitete të përfshira në konflikte të dhunshme i kanë dhënë përparësi mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, edhe duke vënë në rrezik sigurinë personale. Fotografii, dokumente, artefakte fetare dhe personale, tradita dhe ndërtesa – gjithçka që i lidh njerëzit me njëri-tjetrin dhe që u ofron ndjesinë e identitetit ose që përbën mënyrën e tyre të jetesës, merr më shumë vlerë në rast shkatërrimesh apo shpërnguljesh. Prandaj është thelbësore që mbrojtja dhe rimëkëmbja e trashëgimisë kulturore të mos vonohet dhe as të veçohet nga ndihma humanitare e ofruar gjatë dhe pas një emergjence, veçanërisht kur qëllimi i përgjithshëm është të ndihmohen njerëzit të tejklojnë traumën dhe të rifillojnë jetën e tyre normale të përditshme.

Pse duhet ky *Udhëzues*?

Sigurimi i trashëgimisë kulturore gjatë krizave humanitare të shumanëshme dhe të përmasave të mëdha, është sprovë e rëndë për shumë arsye. Një ndër arsyet kryesore është mungesa e vëmendjes ndaj trashëgimisë kulturore të sistemeve kombëtare dhe ndërkombëtare të menaxhimit të emergjencave. Ndërsa si arsye të tjera renditen çështje si: Në rast se preken shumë zona kulturore, nga duhet filluar? Kush mundëson qasjen? Kush mund të ndihmojë? Kur është koha e duhur për të ndërhyrë? Si duhet ndërhyrë?

Ky *Udhëzues* dhe *Paketa e mjeteve* që e shoqëron shpjegojnë “ndihmën e parë ndaj trashëgimisë kulturore”: veprimet e menjëhershme dhe të ndërvarura që duhen ndërmarrë për të stabilizuar dhe për të zvogëluar risqet ndaj trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale, me qëllim nxitjen për rimëkëmbjen e saj. Me anë të një procedure prej tri hapash të testuar në terren, *Udhëzuesi* përcakton se kur dhe si të mbrohet trashëgimia kulturore që rrezikohet, dhe na njeh me të gjithë ata që mund të ndihmojnë në ndërhyrje të tilla. Hapat dhe rendi i punës të ofruara në këtë *Udhëzues* mund t’u përshtaten llojeve të ndryshme të emergjencave dhe konteksteve të tyre të veçanta.

Ky *Udhëzues* ka për qëllim të shërbejë si një:

- Referencë për të trajnuar operatorët e ndihmës së parë të trashëgimisë kulturore, reaguesit e emergjencave dhe vullnetarët.
- Mjet për të përmirësuar planet e institucioneve të trashëgimisë kulturore, për gatishmërinë dhe përgjigjen ndaj emergjencave.
- *Udhëzues* për të ndihmuar në zbatimin e ndërhyrjeve të ndihmës së parë, së bashku me ndihmën humanitare dhe rimëkëmbjen.

Udhëzuesi përcakton aspektet e ndihmës së parë të trashëgimisë kulturore, zbatimin i koordinuar i të cilave mund të ndihmojë në uljen e cenueshmërisë së popullatës së prekur. Duke vepruar kështu, ne shpresojmë të mbështesim përfshirjen e ndihmës së parë të trashëgimisë kulturore në sistemet ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale për përgjigje ndaj emergjencave, si dhe në sistemet e ndihmës humanitare.

Ky *Udhëzues* dhe *Paketa* e tij shoqëruese janë një punë në vazhdim dhe hartuesit e tyre janë të interesuar të marrin reagime, në mënyrë që të mund të vazhdojnë t’i japin rëndësi kësaj fushe dhe të sigurojnë informacione cilësore për ata që kanë më shumë nevojë.

Aparna Tandon

Koordinator e programit të Ndihmës së Parë për Trashëgiminë Kulturore në Kohë Krizash, ICCROM fac@iccrom.org

Përdorimi i Udhëzuesit

Ju lutemi të gjeni më poshtë disa këshilla që ju ndihmojnë të lexoni këtë *Udhëzues* dhe *Paketën* e tij shoqëruese.

SKEDAT E LIBRAVE

Në anën e sipërme të djathtë të çdo faqeje do të gjeni simbole orientuese, të cilat ju ndihmojnë të kaloni në seksionin e dëshiruar të *Udhëzuesit*.

HIPERLIDHJET

Me germa blu dhe “bold”: Lidhje me pjesë të caktuara në dokument.

Me germa portokalli dhe “bold”: Lidhje me fjalorin.



KËSHILLA: Këshilla të bazuara në përvojë.



KUJDES: Kërkohet vëmendje për të shmangur rreziqet dhe / ose gabimet e paparashikuara.



LEXONI MË SHUMË: Lexime plotësuese.



RASTE STUDIMORE: Sfidat e hasura në raste specifike, praktikat e mira ose mësimet e marra në terren.



PJESË NDËRVEPRUESE: Provoni ushtrimin ose aktivitetin.



**NJOHJA ME NDIHMËN
E PARË NDAJ
TRASHËGIMISË
KULTURORE**



Çfarë është ndihma e parë ndaj trashëgimisë kulturore?

Si ndihmë e parë ndaj trashëgimisë kulturore njihen ndërhyrjet e menjëhershme dhe të ndërvarura, që ndërmerren për të stabilizuar dhe për të zvogëluar **risqet** ndaj **trashëgimisë kulturore** të rrezikuar gjatë dhe pas një **emergjence**. Shkaku i menjëhershëm i një emergjence të tillë mund të jetë një **rrezik natyror**, një rrezik **i shkaktuar nga njeriu** ose një kombinim i të dyjave. Ndihma e parë përfshin **analizën** e një situatë emergjente dhe efektet e mundshme të saj në trashëgiminë kulturore; **vlerësimi në vend i dëmit dhe i riskut**, si dhe **sigurimi dhe stabilizimi**.

Qëllimi i përgjithshëm i ndihmës së parë është nxitja e rimëkëmbjes së trashëgimisë kulturore që është prekur nga fatkeqësia, duke lehtësuar në këtë mënyrë edhe rimëkëmbjen e komuniteteve që lidhen me të.

Brenda një plani institucional të procedurave të përgjigjes ndaj emergjencave ose krizave, bën pjesë edhe ndihma e parë ndaj trashëgimisë kulturore. Në shumë raste, veçanërisht pas fatkeqësive të përmasave të mëdha, ndihma e parë ndaj trashëgimisë kulturore shpesh nis vetëm pasi përfundon gjendja e emergjencës e deklaruar zyrtarisht. Sidoqoftë, përgatitja dhe koordinimi paraprak do të ndihmojë për të siguruar ndihmën e shpejtë dhe të efektshme ndaj trashëgimisë kulturore në rastin e një emergjence.



Stabilizimi emergjent i një tempulli në Kathmandu, Nepal, 2015. Foto: ICCROM.

Si mund të sigurojmë ndihmën e parë për lloje të ndryshme të trashëgimisë kulturore në raste emergjente?


Në këtë *Udhëzues* përshkruhet një procedurë me tre hapa për sigurimin e ndihmës së parë për të gjitha llojet e trashëgimisë kulturore dhe në shumë vende.

Procedura bazohet në kursin ndërkombëtar të ICCROM-it, të kryer me shumë partnerë, mbi **Ndihmën e Parë ndaj Trashëgimisë Kulturore në Kohë Krizash ("FAC")**, në përvojën e gjerë në terren dhe në bashkëpunim ndërdisiplinor me profesionistë në të gjithë botën.

Duke qenë se asnjë emergjencë nuk është e njëjtë me të tjerat, veprimet e përshkuara në këtë *Udhëzues* duhet të përshtaten sipas konteksteve vetjake.



PROCEDURA E VEPRIMIT TË NDIHMËS SË PARË NDAJ TRASHËGIMISË KULTURORE



Çdo hap i procedurës ka një rend të veçantë pune që mund të ndahet në veprime më të vogla.



Hapi 1: Analiza e situatës

Analiza e situatës siguron aftësinë e të kuptuarit të kontekstit më të gjerë të emergjencës. Kjo u mundëson operatorëve të ndihmës së parë të zhvillojnë një plan të posaçëm sipas kontekstit, për veprimet që do të ndërmerren në vend. Në fund të fazës së emergjencës bëhet një analizë e thelluar e situatës për të përcaktuar nevojat afatmesme dhe ato afatgjata për **rimëkëmbjen** e **trashëgimisë kulturore**.



Hapi 2: Vlerësimi në vend i dëmit dhe riskut

Vlerësimi **në vend** i **dëmit** dhe i riskut lejon identifikimin dhe regjistrimin e dëmit të shkaktuar dhe të risqeve që paraqiten ndaj trashëgimisë kulturore pas një **fatkeqësie**. Rezultatet e këtij hapi ndihmojnë në përcaktimin e përparësive për veprimet në terren.



Hapi 3: Sigurimi dhe stabilizimi

Sigurimi dhe **stabilizimi** përfshijnë veprime që ndihmojnë në frenimin e dëmtimeve dhe zvogëlimin e risqeve, duke e çuar trashëgiminë e prekur një hap më afër rimëkëmbjes. Në këtë fazë, veprimet që ndërmerren për trashëgiminë materiale dhe jomateriale janë të ndryshme.

Dokumentimi, menaxhimi i vazhdueshëm **i riskut, komunikimi** dhe **bashkërendimi** me **reaguesit e tjerë të emergjencave**, janë procese thelbësore për zbatimin me sukses të hapave të përshkruara në procedurën e punës. Proceset e punës të përshkruara brenda kësaj procedure ndihmojnë në identifikimin e fushave të përbashkëta të veprimit ndërmjet operatorëve të ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore, komuniteteve vendase, forcave reaguese ndaj emergjencave dhe organizatave humanitare.

Veprimet e ndërmarra për të siguruar dhe për të rimëkëmbur trashëgiminë kulturore duhet të harmonizohen me parimet humanitare të njerëzimit, neutralitetin, paanshmërinë dhe pavarësinë. Për të mbështetur këtë ideal në praktikë, ky *Udhëzues* sugjeron më poshtë një sërë parimesh udhëzuese, të cilat u përmbahen atyre që përshkruhen për ndihmat humanitare



Parimet udhëzuese për ndihmën e parë ndaj trashëgimisë kulturore



1. Ndihma e parë me përparësi njerëzit

Dhënia përparësi e nevojave të njerëzve dhe rritja e aftësisë së tyre për të siguruar dhe rimëkëmbur trashëgiminë e tyre janë pjesë përbërëse e hartimit dhe e përqasjes së Procedurës së Ndihmës së Parë.



Vendndodhjet e trashëgimisë shpesh përdoren për të siguruar strehim për njerëzit e zhvendosur gjatë krizave. Ndihma e parë ndaj trashëgimisë kulturore duhet t'i marrë parasysh këto nevoja dhe të lehtësojë punën gjatë këtij procesi. Statistikat tregojnë se në shumicën e fatkeqësive komunitetet vendase janë të parët që reagojnë për sigurimin e trashëgimisë së tyre kulturore. Për shembull, gjatë konfliktit të vitit 2012 në pjesën veriore të Malit, dorëshkrimet e lashta u mbajtën të sigurta në mënyrë private përmes rrjeteve tradicionale ndërkomunale. Shpesh, komunitetet kanë mekanizma përballues të testuara në kohë dhe një mori njohurish (p.sh., metodat tradicionale të ndërtimit), të cilat duhet të përdoren në rindërtimin dhe rimëkëmbjen e trashëgimisë.



2. Qëndrimi gjithëpërfshirës dhe respekti për larminë

Ndihma e parë duhet të përfshijë një këndvështrim gjithëpërfshirës për të ndihmuar në njohjen e elementeve që përbëjnë trashëgiminë kulturore të zonës së prekur nga katastrofa.



Si individë dhe si profesionistë, operatorët e ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore mund të bëjnë, në mënyrë të paqëllimshme, gjykime të bazuara në vlera subjektive, duke çuar në vlerësim selektiv të trashëgimisë kulturore dhe në rritjen e pabarazive ekzistuese në zonën e prekur. Për shembull, tradicionalisht, reagimet e institucioneve përgjegjëse janë përqendruar në mbrojtjen e trashëgimisë ikonike ose monumentale, ndërsa trashëgimisë së arkitekturës popullore kryesisht nuk i është kushtuar rëndësi.



3. Përgjigjja në përputhje me kontekstin

Kuptimi i kontekstit më të gjerë të emergjencës është thelbësor për sigurimin e një ndihme të parë efektive për trashëgiminë kulturore.



Çdo emergjencë ka një kontekst të caktuar. Analizimi i kontekstit mundëson që të identifikohen nevojat e menjëhershme të aktorëve kryesorë përgjegjës dhe kapacitetet e tyre përkatëse për të mbrojtur trashëgiminë kulturore. Vlerësimi i kontekstit ndihmon gjithashtu për të identifikuar faktorët e riskut që mund të shkaktojnë dëme më të mëdha në trashëgiminë kulturore gjatë një krize të caktuar. Për shembull, mungesa e sigurisë mund të shtojë riskun e plaçkitjes sistematike të objekteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore gjatë konflikteve të dhunshme.

4. Ndërthurja e kulturës me ndihmën humanitare

Ndihma e parë për trashëgiminë kulturore duhet të sigurohet krahas ndihmës dhe rimëkëmbjes humanitare.



Duhet pranuar që në çdo situatë krize, shpëtimi i jetës së njerëzve është përparësia numër një, por gjithashtu që njerëzit e prekur nga fatkeqësia kanë të drejtë të ndihmohen të sigurojnë vazhdimësinë e kulturave të tyre. Në këtë kuadër, Procedura e Ndihmës së Parë thekson ndërvarësinë e reagimeve kulturore dhe humanitare. Veprimet për sigurimin e trashëgimisë kulturore duhet të fillojnë në bashkëpunim dhe në bashkërendim të ngushtë me sistemin përkatës qeveritar dhe agjencitë ndihmëse humanitare, p.sh., programet e mbrojtjes sociale të ndërmarra nga organizata humanitare mund të përdoren për të klasifikuar mbetjet e shkatërrimit dhe objektet e shpëtuara të trashëgimisë, si dhe për të ndërtuar fragmentet e dëmtuara në vendndodhjet e trashëgimisë.



5. Mos dëmtoni

Veprimet e ndihmës së shpejtë ndaj trashëgimisë duhet të parandalojnë dëmtimin e mëtejshëm dhe të ndihmojnë rimëkëmbjen.



Një nga objektivat kryesore të ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore është parandalimi i dëmtimeve të mëtejshme, duke vlerësuar, duke lehtësuar dhe duke u përgatitur për risqe të tjera. Për shembull, nëse krijoni një vend magazinimi të përkohshëm për koleksionet kulturore për t'i mbrojur nga shpërthimet e bombave, sigurohuni që ky vend të mos jetë i ekspozuar ndaj rreziqeve të tjera, si përmbytja ose plaçkitja.

Kush mund të japë leje për të filluar veprimet e ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore?

Në shumicën e rasteve, lejen për fillimin e ndërhyrjeve të ndihmës së shpejtë e jep administratori i trashëgimisë kulturore që është prekur. Administratori mund të jetë i ndryshëm, për shembull, mund të jetë një institucion i qeverisjes qendrore, i asaj lokale ose një komunitet fetar.

Sidoqoftë, administratori nuk është autoriteti i vetëm. Gjatë një gjendje emergjence të shpallur zyrtarisht, prioritetet për **përgjigje** përcaktohen nga agjencitë përgjegjëse për menaxhimin e situatës.

Legjislacioni kombëtar për menaxhimin e emergjencave luan një rol të madh në përcaktimin se cili institucion apo cila agjenci ka autoritetin kryesor për të filluar veprimet e përgjigjes dhe për të siguruar hyrjen në zonën apo zonat e prekura. Prandaj kërkohet autorizimi paraprak dhe bashkërendimi me agjencinë përgjegjëse për organizimin e përgjithshëm të përgjigjes ndaj emergjencës, si dhe leja e administratorit për të filluar ndërhyrjet e ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore.



Menjëherë pas tërmetit po zhvillohen operacionet e pastrimit në Kathmandu, Nepal, 2015. Foto: Tapash Paul/Drik.



Gjatë një gjendje emergjence të shpallur zyrtarisht, autoriteti shtetëror vendimmarrës zakonisht cakton një **koordinator për përgjigjen ndaj emergjencës** ose një **drejtues të operacionit**, i cili do të ngrejë **sistemin për menaxhimin e emergjencës** në përputhje me një procedurë të paracaktuar. Për shembull, në Indi, Autoriteti Kombëtar i Menaxhimit të Fatkeqësive koordinon përgjigjen ndaj të gjitha fatkeqësive natyrore dhe ato të shkaktuara nga njerëzit, bazuar në **Aktin Kombëtar të Menaxhimit të Fatkeqësive 2005**.

Forcat për përgjigje ndaj emergjencave, si njësitë e mbrojtjes civile, vullnetarët e Kryqit të Kuq, policia dhe ushtria, në varësi të nevojave dhe të shkallës së rrezikut të ngjarjes, punojnë brenda sistemit të menaxhimit të emergjencave të një vendi për të siguruar jetët e njerëzve, për të rikthyer mjetet e komunikimit dhe transportit dhe plotësimin e nevojave të tjera themelore.

Në rast **emergjence madhore**, qeveria në nivel kombëtar mund të kërkojë ndihmë nga një vend tjetër ose nga bashkësia ndërkombëtare, nën udhëheqjen e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). OKB-ja drejton reagimet humanitare përmes Komitetit të Përhershëm Ndër-Agjencor ("IASC") i cili përbëhet nga **aktorë kryesorë humanitarë** nga OKB-ja dhe agjenci ndërkombëtare. Brenda 48 orëve nga fillimi i një emergjence, IASC-ja e klasifikon gjendjen sipas shkallës, kompleksitetit, urgjencës dhe **kapacitetit** ekzistues lokal për menaxhimin e situatës, bazuar në një vlerësim fillestar.

Në rast të një emergjence të **Nivelit 2** ose të **Nivelit 3**, OKB-ja do të aktivizojë një përgjigje të koordinuar të shumë agjencive (OKB-ja, organizata ndërqeveritare dhe joqeveritare), duke i grupuar ndihmat humanitare në **grupe** tematike. Emergjencia të tilla shpesh tregojnë se autoritetet lokale dhe kapacitetet e tyre për përgjigje ndaj emergjencës janë prekur në mënyrë kritike. Në këto situata, qeveria lokale do të punojë në koordinim me agjencitë ndërkombëtare për të ndërmarrë veprime, siç janë vlerësimet apo kërkimet e fondeve brenda një grupi tematik. Aktualisht, kultura nuk është përfshirë në këtë sistem grupimi.

Në rastin e një emergjence të deklaruar si komplekse, ndihma humanitare e OKB-së mund të përfshijë operacione ushtarake dhe / ose policore në një mision paqeruajtës.

Shikoni referencat në faqen 151.



Kush mund ta planifikojë dhe ta zbatojë ndihmën e parë ndaj trashëgimisë kulturore?

Një operator i ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore mund të planifikojë dhe të zbatojë operacionet e ndihmës së parë, në koordinim me ekipet e reagimit ndaj emergjencave, profesionistët e ndihmës humanitare, pronarët e objekteve të trashëgimisë dhe vullnetarët.

Operatori i ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore është dikush që ka marrë trajnim paraprak për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të rrezikuar gjatë ose menjëherë pas një emergjence. Sigurimi i ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore gjatë **emergjencave madhore ose komplekse**, përfshin ekuilibrimin e nevojave të ushqimit, ujit, strehimit, sigurisë dhe identitetit. Një operator i ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore duhet të jetë në gjendje të përballojë kërkesat fizike, mendore, mjedisore dhe detyrat specifike të punës.

Ai / ajo duhet të ketë njohuri dhe aftësi për të vlerësuar, për të dokumentuar, për të siguruar dhe për të stabilizuar lloje të ndryshme të trashëgimisë kulturore në kontekste të ndryshme emergjence. Ai / ajo duhet të jetë në gjendje të punojë në ekipe shumëdisiplinare. Operatorët e ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore duhet të përzgjidhen nga komunitetet lokale, agjencitë e reagimit ndaj emergjencave dhe institucionet e trashëgimisë kulturore.

Lexojni cilësitë e renditura në faqen pasardhëse dhe identifikoni dikë nga institucioni juaj ose nga komuniteti vendas që do të përshtatej më mirë me rolin e një operatori të ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore.



*Operatorët e ndihmës së parë ndaj trashëgimisë në Port-au-Prince, Haiti, 2010.
Foto: Aparna Tandon, ICCROM.*

Tri cilësitë kryesore të një operatori të ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore



Mendjemprehtë

- kupton format e ndryshme të trashëgimisë kulturore
- i mirinformuar për kontekstin e emergjencës
- aftësi të forta analitike dhe kritike



I përqëndruar te njerëzit

- një dëgjues aktiv
- kupton dhe respekton strukturat ekzistuese shoqërore
- lojtar ekipi
- i ndjeshëm ndaj nevojave njerëzore
- i aftë për të krijuar besim



I organizuar dhe praktik

- me qëndrim optimist për punën
- krijues në zgjidhjen e problemeve
- i shpejtë në të menduar dhe me qëndrueshmëri fizike

Pse është e rëndësishme të koordinohet ndihma e parë ndaj trashëgimisë kulturore me reagimin e përgjithshëm ndaj emergjencës?

Gjatë një emergjence, prioritetet për ndihmë dhe rimëkëmbje identifikohen përmes sistemeve që janë organizuar paraprakisht në nivel kombëtar ose ndërkombëtar të menaxhimit të emergjencave. Ndhimja që duhet të jepet kanalizohet më pas përmes këtyre sistemeve, bazuar në përparësitë (prioritetet) e identifikuar. Për të garantuar mbrojtje dhe siguri, leja për hyrje në zonën e prekur kontrollonhet rreptësisht.

Që të mundësohet hyrja në zonën e prekur dhe për t'u siguruar që trashëgimia kulturore të konsiderohet si prioritet, është e rëndësishme që përpjekjet për ndihmën ndaj trashëgimisë kulturore të koordinohen brenda situatës së përgjithshme të përgjigjes ndaj emergjencës. Nëse nuk do të arrihet të bëhet e mundur kjo gjë, mund të rritet risku i dëmtimit ose i shkatërrimit të trashëgimisë që është prekur.



Çështja e koordinimit të ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore: Haiti

Në muajt pas tërmetit të Haitit në vitin 2010, “Institut de Sauvegarde du Patrimoine National (ISPAN)” (Instituti për mbrojtjen e Trashëgimisë Kombëtare) ndërmori një aksion për t’i shenjuar dhe për t’i emërtuar ndërtesat e dëmtuara historike në zonat e prekura. Duke mos pasur kapacitete të mjaftueshme



Shenjimi i strukturave të trashëgimisë në Jacmel, Haiti, 2010. Foto: Aparna Tandon, ICCROM.





(për sa i përket fondeve dhe burimeve njerëzore) për t'i mbrojtur dhe për t'i rimëkëmbur ndërtesat, Instituti synoi të parandalonte prishjen e ndërtesave dhe të merrte masa për t'i mbrojtur ato, sipas rëndësisë, funksionit dhe përdorimit të tyre.

Ky aksion u krye paralelisht me procesin e vlerësimeve strukturore të kryera nga Ministria e Punëve Publike dhe agjencitë mbështetëse të OKB-së. Koordinimi i plotë nuk ishte i mundur, pasi rimëkëmbja apo mbrojtja e trashëgimisë kulturore nuk ishin të përfshira në reagimin kombëtar apo ndërkombëtar ndaj emergjencës. Si përfundim, shumë struktura historike u shpallën të pasigurta dhe u shembën plotësisht.

Shikoni referencat ne faqen 153.



Ndërtesë e shenjuar e trashëgimisë në Jacmel, Haiti, 2010. Foto: Aparna Tandon, ICCROM.



Kur është e përshtatshme të sigurohet ndihma e parë ndaj trashëgimisë kulturore?

Gjatë një emergjence, prioriteti i parë është të shpëtohen jetë dhe të garantohet siguria. Pasi të përfundojnë këto operacione, mund të jepet ndihma e parë ndaj trashëgimisë kulturore. Sidoqoftë, mekanizmat bashkërendues në terren me përgjegjës të ndryshëm të emergjencave dhe me shoqata humanitare duhet të përcaktohen përpara se të ndodhë një situatë emergjence. Gjithashtu duhet t'u kushtohet vëmendja e duhur planeve të qeverive lokale dhe institucioneve të trashëgimisë kulturore, për gatishmërinë ndaj emergjencave. Në praktikë, koha e duhur për fillimin e ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore është e ndryshme dhe varet nga faktorët e mëposhtëm:

- Natyra dhe shkalla e emergjencës: në rastin e një **emergjence madhore ose komplekse**, e cila përfshin dëmtime të mëdha dhe humbje jetësh, operacionet e ndihmës së shpejtë mund të vonojnë.
- Hyrje-dalja në zonat e prekura: në rast të një konflikti të armatosur ose të një incidenti bërthamor, hyrje-daljet në zonën e prekur do të jenë shumë të kufizuara, gjë që mund të vonojë aktivizimin e ndihmës së parë ndaj trashëgimisë.
- Shkalla e dëmit të shkaktuar ndaj trashëgimisë kulturore dhe / ose rëndësia e saj për **palët e interesit** (p.sh., rëndësia lokale, kombëtare, ndërkombëtare): aty ku dëmtimi është i madh, nevoja për ndihmë nga jashtë mund të shkaktojë vonesa për ndërhyrjet në trashëgiminë kulturore. Në mënyrë të ngjashme, për vende ose objekte të trashëgimisë kulturore me rëndësi të veçantë, siç mund të jetë një sit i Trashëgimisë Botërore, mund të kërkohen inspektime nga ekspertë të jashtëm përpara se të ndërmerret ndonjë veprim.
- Kapaciteti dhe gatishmëria lokale: aty ku ka kapacitete lokale për sa i përket burimeve dhe personelit të trajnuar, si dhe aty ku mekanizmat e koordinimit me institucionet e menaxhimit të emergjencave janë gati, është më e lehtë të fillohet ndihma e parë ndaj trashëgimisë kulturore menjëherë pas operacioneve të shpëtimit të jetëve.



Fillimi i operacioneve të ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore: Italia dhe Iraku

Siç u përmend më lart, koha e duhur për të aktivizuar ndihmën e parë ndaj trashëgimisë kulturore varet nga natyra dhe nga shkalla e emergjencës. Për shembull, pas tërmetit të parë që goditi rajonin malor të Italisë qendrore në 24 gusht 2016, operacionet e kërkim-shpëtimit zgjatën dhjetë ditë. Vetëm pas përfundimit të tyre, Departamenti Italian për Mbrojtjen Civile, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, ndërmorën një vlerësim paraprak të dëmit të shkakuar në **trashëgiminë kulturore** të paluajtshme dhe **të luajtshme** në atë zonë.

Në Irakun verior, një vlerësim i siteve të trashëgimisë kulturore që ishin shkatërruar qëllimisht në vitin 2014, nuk mund të kryhej deri në gjashtë muaj pas çlirimit të qytetit të Mosulit. Pamundësia e hyrje-daljeve në zonat e pushtuara dhe kushtet e pasigurta pas çlirimit në fund të vitit 2016, vonuan ndjeshëm zbatimin e ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore në vendet e prekura.

Shikoni referencat ne faqen 153.



*Lart: Tërmeti në Italinë qendrore, 2016. Foto: Aparna Tandon, ICCROM.
Poshtë: Ndërhyrjet e ndihmës së parë në sitin arkeologjik Nimrud,
në Irakun verior, 2017. Foto: Layla Salih.*



PËRFYTYRONI sikur të jetë shpallur një gjendje emergjence në zonën tuaj. Situata është e paqartë, pasi raportet e dëmeve janë ende në vijim. Raportet paraprake dëshmojnë për dëmtime të trashëgimisë kulturore në shumë vende dhe parashikohen humbje të mëdha. Trashëgimia e larmishme dhe e pasur kulturore në zonën tuaj është e lidhur me identitetin tuaj kombëtar. Të shqetësuar për humbjen e mundshme të historisë, ju do të donit të ofronit ndihmën e parë.

Nga ku do të filloni?

Lexoni në vijim për ta zbuluar.

HAPI I PARË ANALIZA E SITUATËS



Çfarë është një analizë e situatës?

Mbledhja e informacionit të besueshëm gjatë një emergjence mund të jetë sfiduese, veçanërisht kur ai është i shkëputur dhe grumbullohet nga burime të pakonfirmuara. Prandaj, para se të ndërmerrni veprime për të siguruar trashëgiminë kulturore, gjeni kohën për vlerësimin e situatës, për të analizuar informacionin e mbledhur dhe për të përgatitur një strategji për sigurimin e ndihmës së parë. Dështimi në ndjekjen e këtyre hapave mund të shkaktojë pasaktësi në prioritizimin e trashëgimisë së prekur, rritjen e dëmtimit të trashëgimisë, madje dhe mund të vërë në rrezik jetën e njerëzve.

Vlerësimi sistematik i një emergjence të papritur ose i një krize që përshkallëzohet gradualisht quhet analizë e situatës. Ai përfshin mbledhjen e informacionit dhe vendosjen e lidhjeve midis të dhënave specifike para dhe pas ngjarjes, në mënyrë që të kalohet informacioni për veprimet në terren dhe të identifikohen nevojat e menjëhershme dhe kapacitetet ekzistuese për t'i përmbushur ato.

Analiza e situatës është një mjet i zakonshëm që përdoret nga organizatat humanitare. Ajo përdoret për të përcaktuar përparësitë për ofrimin e ndihmës, në periudhën menjëherë pas një fatkeqësie, si dhe në fillim të **rimëkëmbjes së menjëhershme**, për të identifikuar nevojat afatgjata humanitare



Analiza e situatës si pjesë e Kursit Ndërkombëtar mbi Ndihmën e Parë për Trashëgiminë Kulturore në Kohë Krize, Amsterdam, 2015, Holandë. Foto: ICCROM.

Përse duhet kryer një analizë e situatës për ndihmën e parë ndaj trashëgimisë kulturore?

Në një krizë me zhvillim të shpejtë, analiza e situatës mund të ndihmojë në zvogëlimin e risqeve ose në parandalimin e dëmit ndaj trashëgimisë kulturore. Nëse analiza e situatës kryhet në fillim të një operacioni në terren për të mbrojtur trashëgiminë kulturore, atëherë ajo mund të ndihmojë në përcaktimin e vendndodhjes, kohës, shkallës dhe qëllimit të operacionit.

Bazuar në informacionin para ngjarjes në lidhje me llojin dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore që është prekur, analiza e situatës ndihmon në përgjigjen e pyetjeve kritike, si p.sh.: çfarë duhet ndjekur me **përparësi** dhe si të ndërhyhet. Në të njëjtën kohë, analiza ndihmon në identifikimin e palëve të interesit që mund të ndihmojnë në zbatimin e ndihmës së parë, si dhe të roleve të tyre.

Për emergjencat e shkaktuara nga një konflikt, analiza e situatës mund të zgjerohet për të përfshirë një vlerësim të konfliktit, e njohur si **analiza e konfliktit** (shihni faqen 38).

Rezultatet e analizës së situatës përdoren për të zhvilluar një plan specifik, sipas kontekstit, për sigurimin dhe stabilizimin e trashëgimisë kulturore që është prekur. Plani mund të përditësohet bazuar në të dhënat e siguruar nga **vlerësimet në vend të dëmit dhe riskut**. (shihni faqen 42).



*Një kishë e dëmtuar nga tërmeti në Bohol, Filipine, 2013.
Foto: Aparna Tandon, ICCROM.*



Si ndihmoi analiza e situatës në parandalimin e dëmeve dhe në zvogëlimin e risqeve gjatë një situatë krize në përshkallëzim: Kiev, Ukrainë

Në shkurt të vitit 2014, në Kiev, Ukrainë, shpërthyen protesta publike. Në qendër të qytetit të Kievit, protestuesit dhe forcat speciale të policisë rrethuan disa institucione dhe site të trashëgimisë kulturore. Bazuar në një analizë të situatës së skenave të zhvilluara në mjediset e jashtme, kati i parë i Muzeut Kombëtar të Artit të Ukrainës u evakuua dhe artefakte me vlerë u zhvendosën përkohësisht në një vend më të sigurt, para se protestat të shndërroheshin në trazira të dhunshme. Gjatë zhvendosjes së pjesëve të koleksionit, stafi i muzeut kontaktoi forcat e sigurisë, duke i kërkuar me ngulm atyre të parandalonin vandalizmin. Këto veprime në kohën e duhur e shpëtuan koleksionin e muzeut nga dëmtime më të mëdha, ndërkohë që një prej muzeumeve pranë kishte pësuar vjedhje të një pjese të koleksionit gjatë trazirave.

Burimi: Ihor Poshyvailo, Drejtor i Kompleksit Memorial Kombëtar të Njëqind Heronjve Qiellorë – Muzeu i Revolucionit të Dinjitetit, Kiev, Ukrainë. Pjesëmarrës në Kursin Ndërkombëtar mbi Ndhimën e Parë për Trashëgiminë Kulturore në Kohë Krizash, 2015.

Kush duhet të marrë pjesë në një analizë situatë?

Një analizë situatë për zbatimin e ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore mund të përfshijë aktorët në vijim:

- ekipet ose institucionet që zbatojnë ndihmën e parë;
- pronarët ose institucionet përgjegjëse për trashëgiminë kulturore të prekur;
- përfaqësues nga institucionet përgjegjëse për menaxhimin e emergjencave që kontrollojnë hyrje-daljet në zonën e prekur dhe janë të ngarkuar me përcaktimin e përparësive për përgjigjen ndaj emergjencave;
- përfaqësues nga komuniteti vendas;
- vullnetarë dhe OJQ-të lokale.



Si kryhet një analizë e situatës për ndihmën e parë ndaj trashëgimisë kulturore?

Rendi i punës për analizën e situatës për ndihmën e parë ndaj trashëgimisë kulturore është dhënë më poshtë





Grumbullim të dhënash

Hapi i parë i analizës së situatës për ndihmën e parë të trashëgimisë kulturore është grumbullimi i të dhënave të posaçme mbi natyrën e emergjencës, vendndodhjen e saj gjeografike, llojin(et) dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore që është prekur, llojin(et) dhe masën e dëmtimit, si dhe palët e interesit të përfshira dhe rolet e tyre.

Konteksti i emergjencës



- 1 Cila krahinë, rajon ose shtet është përfshirë? Gjeni gjeo-koordinatat e sakta të zonës në fjalë.
- 2 Cili është **rreziku** kryesor që shkaktoi gjendjen e emergjencës?
- 3 Cilat rreziqe dytësore mund të shkaktojnë më shumë dëme në trashëgiminë kulturore në zonën e prekur?
- 4 Cilat janë pikat e **dobëta** në sistemin shoqëror, ekonomik ose politik që mund ta bëjnë trashëgiminë më të cenueshme ndaj dëmtimit? Për shembull: rrugët e dëmtuara mund të pengojnë përgjigjen në kohë ndaj fatkeqësisë, ose një prishje e rendit dhe e ligjit mund ta ekspozojë trashëgiminë ndaj një rreziku dytësor, atë të plaçkitjes.
- 5 Në cilën fazë të situatës jeni?
 - a. A është faza para emergjencës (p.sh., është lëshuar një paralajmërim fillestar për një shpërthim vullkanik)?
 - b. A është faza gjatë ose në kulmin e emergjencës (p.sh., trazirat kanë filluar, një stuhi po afrohet)?
 - c. A është faza menjëherë pas një fatkeqësie natyrore, ose një fatkeqësie të shkaktuar nga njeriu, siç është një incident bombardimi?



Ngjarjet në një situatë emergjence shumë-dimensionale nuk ndjekin një progresion linear. Për shembull, një tërmet mund të bëhet shkak për një zjarr. Në mënyrë të ngjashme, në një krizë të zgjatur, konflikti i ri mund të destabilizojë një marrëveshje ekzistuese paqeje. Prandaj, është shumë e rëndësishme të identifikoni saktë fazën në të cilën ndodheni gjatë një situatë në përshkallëzim e sipër, si dhe të përfshini planifikimin rezervë.



- 1 Sa dhe cilat lloje të **pasurive kulturore** ka të ngjarë të preken? Nëse përfshihen disa pasuri kulturore, sigurohuni që të keni gjeo-koordinata për të gjitha. Ky informacion mund të gjendet në **arkivat** ekzistues pranë ministrisë përgjegjëse për kulturën ose pranë departamenteve kombëtare të kulturës.
- 2 Cila është rëndësia e trashëgimisë kulturore që është prekur në zonë dhe për kë është e rëndësishme (domethënëse)? A është një pasuri e shpallur me rëndësi kombëtare apo rajonale?
- 3 Cilat janë besimet apo qëndrimet lokale që mund të ndikojnë në ndihmën e parë ndaj trashëgimisë kulturore? Këto mund të ndikojnë në disponueshmërinë e burimeve dhe të njerëzve që mund të ndihmojnë. Për shembull, pas tërmetit në Nepal në vitin 2015, inxhinierët konstruktorë të huaj (jo-hindu), nuk u lejuan të hynin në hapësirat e brendshme të tempujve hindu për të vlerësuar dëmin. Në mënyrë që të planifikoni një operacion të ndihmës së shpejtë që respekton kontekstin kulturor dhe shoqëror vendas, është thelbësore të kuptoni:
 - a. besimet fetare të zonës;
 - b. gjuhën dhe format e parapëlqyera të komunikimit;
 - c. rolin dhe përfshirjen e meshkujve dhe të femrave në trashëgiminë kulturore;
 - d. përfshirjen ose përfaqësimin e trashëgimisë së një komuniteti minoritar brenda sektorit kryesor të trashëgimisë së asaj zone;
 - e. pritshmëritë për ndihmë të jashtme në kuadër të rimëkëmbjes së trashëgimisë kulturore.
- 4 Cila ishte gjendja e trashëgimisë kulturore që është prekur para ngjarjes, d.m.th., cila ishte gjendja e saj fizike dhe cilat ishin pikat e saj të dobëta? A ishte e restauruar? A po i nënshtrohej një procesi konservimi? A ishte e mbrojtur mirë? A ishte dokumentuar mirë? Ky informacion mund të merret nga institucionet ose personat fizikë dhe juridikë që administrojnë pasuritë përkatëse të trashëgimisë kulturore.



Identifikimi dhe dokumentimi i trashëgimisë kulturore lokale janë të rëndësishme për t'u realizuar para se të ndodhë një krizë, në mënyrë që më vonë të jetë e mundur të identifikohet çdo dëm, nëse ndodhë një ngjarje. Trajnimi në mbajtjen dhe administrimin e dokumentacionit, përfshirë edhe mënyrën e regjistrimit të dëmit përmes fotografive, duhet t'u ofrohet anëtarëve të stafit të institucionit lokal. **(Për më shumë shiko seksionin mbi vlerësimin në vend të dëmit dhe riskut, faqja 53)**

- 5 A ekzistojnë plane funksionale për menaxhimin e emergjencave për trashëgiminë kulturore që është prekur? Nëse është kështu, mblidhni të dhënat e kontaktit të personit përgjegjës për koordinimin e përgjigjes për trashëgiminë kulturore në nivel lokal.
- 6 Çfarë lloj dëmtimi kanë pësuar pasuritë kulturore në zonë? Mblidhni informacione nga burime të njohura lokale.



Në përputhje me bindjet e tyre fetare, vullnetarët e organizuar nga komuniteti vendas, pa marrë parasysh sigurinë personale, punuan të zbathur për të shpëtuar fragmente të tempujve budistë dhe të pagodave të dëmtuara nga tërmeti në Bagan, Myanmar, 2016. Besimet dhe zakonet lokale gjithmonë do të ndikojnë në ndihmën e parë ndaj trashëgimisë kulturore. Sidoqoftë, para goditjes nga fatkeqësia, duhet të bëhen përpjekje për t'i bërë të vetëdijshëm komunitetet vendase për rreziqet që shaktohen gjatë shpëtimit të trashëgimisë kulturore nëse nuk përdoren veshje dhe pajisje sigurie personale. Foto: Aparna Tandon, ICCROM.





- 1 Cilët janë pronarët (institucionet / individët / grupet shoqërore) e **pasurive kulturore** në zonën e prekur? Mblidhni të dhënat e tyre të kontaktit dhe, nëse është e mundur, vendosni komunikim për të grumbulluar të dhëna paraprake në lidhje me dëmet e shkaktuara në pronat e tyre të trashëgimisë kulturore.
- 2 Cilët janë njerëzit ose komunitetet, jetesa e të cilëve varet nga vlerat e trashëgimisë kulturore?
- 3 Kush është përgjegjës për koordinimin e reagimit ndaj emergjencës dhe kush kontrollon hyrje-daljet në zonën e prekur? Mblidhni të dhënat e tyre të kontaktit për t'i përdorur më vonë për vlerësimin në vend, nëse do jetë e nevojshme.
- 4 Cilat bashkësi vendase, grupe vullnetarësh ose pjesë të stafit në vendngjarje mund të ndihmojnë në vlerësimin e dëmeve dhe të rreziqeve, si dhe në zbatimin e masave të sigurisë dhe stabilizimit?
- 5 Cilat forca reaguese ndaj emergjencave (për shembull, forcat zjarrfikëse, forcat e ushtrisë ose personeli i mbrojtjes civile) janë në gjendje të ndihmojnë në zbatimin e ndihmës së parë për trashëgiminë e prekur?
- 6 Çfarë lloj burimesh mund të sigurojnë palët e interesit të trashëgimisë së prekur?
- 7 Cili është niveli i bashkëpunimit midis aktorëve kryesorë të emergjencës dhe palëve të interesit?



Përcaktimi i rolit të palëve të interesit dhe të aktorëve të tjerë

Krijimi i një grafiku mund të jetë një mjet i dobishëm për të identifikuar dhe për të kuptuar marrëdhëniet komplekse midis palëve të interesit dhe aktorëve, si dhe interesat dhe rolet përkatëse të tyre në ndihmën e parë ndaj trashëgimisë kulturore. Si? Merrni në konsideratë shembullin në faqen vijuese, i cili identifikon palët e interesit dhe aktorët pas shpërthimit të një bombe në një vend të trashëgimisë fetare në Shtetin A. Sfondi i incidentit është një konflikt i vazhdueshëm.



Ushtria e shtetit është ngarkuar me operacionet paqeruajtëse kundër terrorizmit në zonën e prekur. Aktualisht, ushtria kontrollon hyrje-daljet në vendngjarje.

Anëtarët e bashkësisë vendase, të cilët jetojnë në afërsi të sitit, nuk kanë besim të plotë në forcat e ushtrisë. Ata janë të lidhur fort me sitin fetar dhe duan ta ruajnë atë.

Palët kryesore dhe **aktorë** të tjerë përfshijnë:

- Bordi Shtetëror i Antikiteteve, i cili ka ekspertizën për të ofruar ndihmën e parë për ndërtesat dhe objektet e dëmtuara në sitin fetar;
- Bordi Fetar i faltores së dëmtuar, i cili ka një marrëdhënie të dobët me Bordin Shtetëror të Antikiteteve, por me të cilin duhet të konsultohet para se Bordi Shtetëror të lejohet për të ndërmarrë masa të ndihmës së shpejtë;
- Organizata të huaja të trashëgimisë kulturore, të afruara nga Bordi Shtetëror i Antikiteteve për financim dhe ndihmë teknike;
- Profesionistë vendas të trashëgimisë kulturore, të cilët e njohin historinë e vendit dhe kanë ekspertizë në vlerësimin e dëmeve, në sigurimin dhe stabilizimin e trashëgimisë së dëmtuar.





Duke paraqitur në hartë të gjitha palët e interesit dhe aktorët në një situatë të caktuar, si dhe duke identifikuar interesat dhe ndërlidhjet e marrëdhënies të tyre, kjo hartë e palëve të interesit dhe aktorëve duhet t’ju ndihmojë të sqaroni se:

- Kush mund të sigurojë hyrje-dalje në sitin e trashëgimisë kulturore që është prekur?
- Kush mund ta financojë ndihmën e shpejtë për trashëgiminë kulturore?
- Kush e jep lejen për fillimin e operacioneve të ndihmës së shpejtë për trashëgiminë kulturore?
- Kush duhet të përfshihet dhe konsultohet në nivel komuniteti?
- Kush mund të sigurojë informacionin e kërkuar për një përgjigje specifike sipas kontekstit, me ndjeshmërinë e duhur ndaj nevojave lokale?

Harta e palëve të interesit dhe e aktorëve mundëson të kuptohen më mirë interesat përkatëse dhe marrëdhëniet midis të gjithë aktorëve dhe palëve të interesit, gjë që, nga ana tjetër, ndihmon në shmangien e konflikteve të mundshme dhe keqkuptimeve në komunikim.



Analizimi i informacionit

- 1 Analizoni informacionin e mbledhur dhe identifikoni pasuritë kulturore, të cilat:
 - a. janë më të rëndësishme;
 - b. janë dëmtuar rëndë;
 - c. kanë pësuar disa dëme dhe janë të cenuara nga rreziqet dytësore, të cilat mund të çojnë drejt dëmtimeve të mëtejshme, nëse nuk trajtohen.
- 2 Identifikoni pasuritë kulturore që kanë nevojë për një vlerësim të dëmit dhe riskut. Duhet t'u jepet përparësi për një vlerësim në terren pasurive kulturore të dëmtuara pjesërisht ose rëndë dhe që rrezikojnë të pësojnë humbje të mëtejshme. Në mënyrë të ngjashme, vlerat e trashëgimisë kulturore që janë shumë të rëndësishme dhe janë në rrezik mund të përfshihen në listën emergjente për vlerësim në terren.
- 3 Kini parasysh llojin e ekspertizës që do t'ju duhet për **vlerësimin në vend të dëmit dhe riskut** (shihni faqen 46), i cili, përveç rishikimit të dëmeve dhe risqeve, mund të kërkojë edhe një vlerësim të përgjithshëm të sigurisë teknike në vend, si dhe atë në ndërtesë (nëse ka). Për shembull, pas një përmytjeje, një vlerësim në terren për një ndërtesë dhe koleksion historik mund të kërkojë angazhimin e një inxhinieri konstruktor me përvojë për sa i përket strukturave të trashëgimisë të dëmtuara nga uji, si dhe një administrues koleksionesh që mund të vlerësojë dëmin, rreziqet e shkaktuara nga dekompozimi dhe myku. Po kështu, vlerësimi pas një konflikti të armatosur i pasurive të ngjashme kulturore mund të kërkojë së pari një kontroll sigurie për praninë ose jo të mjeteve shpërthyes në zonë.



Në varësi të nivelit dhe të shkallës së emergjencës, vlerësimet mbi përdorshmërinë e ndërtesave, si shkolla, spitale dhe njësi banimi në zonën e prekur, kryhen si pjesë e procesit të reagimit ndaj emergjencës. Sidoqoftë, këto vlerësime nuk i japin përparësi domosdoshmërisht siteve dhe ndërtesave të trashëgimisë kulturore. Prandaj, për të bashkërenduar përpjekjet, sigurohuni që në analizën e situatës për trashëgiminë kulturore të marrë pjesë edhe një përfaqësues nga institucioni që koordinon reagimin ndaj emergjencave.



- 4 Bazuar në informacionin e disponueshëm, analizoni **veprimet e menjëhershme të sigurisë** (shihni faqen 73) të kërkuara në secilin sit. Për shembull, a duhet mbuluar siti, apo a duhet caktuar një roje për të mbrojtur zonën? Në rastin e trashëgimisë jomateriale merrni parasysh llojin e ndihmës lehtësuese për të cilën ka nevojë komuniteti praktikues, në mënyrë që të rimëkëmbet nga emergjenca.
- 5 Identifikoni llojet e furnizimeve dhe të pajisjeve (*Paketa e mjeteve*, shihni faqen 9) kërkoni një vlerësim në vend të dëmit, si dhe vlerësimin e riskut.
- 6 Duke përdorur hartën e **grupeve të interesit dhe të aktorëve**, identifikoni se cilat nga palët e interesit dhe aktorët mund t'ju japin leje për punime në objekt, t'ju lehtësojnë hyrjen, t'ju sigurojnë burime, t'ju organizojnë logjistikën dhe t'ju sigurojnë ekspertizë për:
 - a. Vlerësimet në vend të dëmit dhe riskut;
 - b. operacionet për sigurimin dhe stabilizimin në secilën vendngjarje;
 - c. vlerësimin dhe monitorimin e punës së kryer në secilën vendngjarje.
- 7 Bazuar në informacionin e disponueshëm në lidhje me gjuhën (gjuhët) e preferuara lokale ose format e komunikimit në zonën e prekur, identifikoni **strategjitë** për komunikimin me aktorët e emergjencave, palët e interesit, komunitetet e prekura dhe grupet e medias.



Planifikimi i veprimeve të ndihmës së shpejtë në vendngjarje

Pasi të keni analizuar të gjithë informacionin e mbledhur, përdorni rezultatet për të zhvilluar një plan strategjik për zbatimin e ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore, duke nënvizuar sa vijon:

- 1 Periudhën kohore të parashikuar, shkallën dhe qëllimin, kostot dhe objektivat e operacioneve në terren.
- 2 Rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve, të aktorëve të emergjencës, të operatorëve të ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore, si dhe të grupeve vullnetare të përfshira.
- 3 Lejet zyrtare dhe konsultimet me komunitetin, që janë të nevojshme për të filluar vlerësimet në vend dhe për marrjen e masave për sigurimin dhe stabilizimin.
- 4 **Planin e komunikimit:** cilat mjete komunikimi do të përdoren? Kush do të drejtojë procesin?
- 5 Përgatitjen dhe burimet e kërkuara për kryerjen e punimeve në vendngjarje, përfshirë dokumentacionin specifik para ngjarjes për pasuritë kulturore dhe listat e pajisjeve emergjente të nevojshme për punën në terren.
- 6 Llojin e trajnimit ose të orientimit në vendngjarje që kërkohet nga vullnetarët dhe përgjegjësit e emergjencave para ndihmës së parë.
- 7 Kriteret e sigurisë dhe të kontrollit të cilësisë për zbatimin e ndihmës së parë.
- 8 Kriteret dhe mënyrat e vlerësimit: kush do ta bëjë vlerësimin? Si?
- 9 Regjimin e monitorimit: kush do ta bëjë atë? Cili do të jetë afati kohor?



Kini parasysh që vlerësimet në vend të dëmit dhe riskut do të japin informacione më të hollësishme, të cilat mund të ndryshojnë ose të përsosin planin strategjik për zbatimin e ndihmës së parë.





Çfarë është analiza e konfliktit?

Analiza e konfliktit është një mjet që ndihmon për të identifikuar shkaqet themelore të një konflikti dhe për të kuptuar faktorët që mund ta kthejnë një konflikt të fshehur në një të dhunshëm. Këta faktorë mund të përfshijnë shënjestrimin e qëllimshëm të trashëgimisë kulturore.

Si të kryeni analizën e konfliktit?

Më poshtë paraqitet e përmbledhur një metodë me tre hapa për analizën e konfliktit: ajo bazohet në udhëzimet e dhëna nga “*Department for International Development (DFID)*” (Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar) në Mbretërinë e Bashkuar dhe mund të përshtatet për të identifikuar përparësitë për ndihmën e parë dhe rimëkëmbjen e trashëgimisë kulturore.

- 1. Analiza e shkaqeve të konfliktit.** Për të kuptuar shkaqet që fshihen pas një konflikti, është e nevojshme të analizohen pikat e dobëta në aspektin politik, shoqëror, ekonomik dhe atë të sigurisë. Kjo analizë duhet të përfshijë pikëpamje të ndryshme, si dhe të përfshijë elementet e mëposhtme:
 - a. analizën e gjerë kontekstuale (historia e konfliktit, tiparet fizike dhe demografike dhe pabarazitë strukturore);
 - b. hartën e burimeve të tensioneve dhe të konflikteve, e cila mund të përfshijë simbole kulturore;
 - c. Identifikimin e lidhjeve midis burimit të tensionit në sektorë të ndryshëm, përfshirë sektorin e trashëgimisë kulturore.
- 2. Analiza e aktorëve** që ndikojnë në krijimin e një konflikti ose që preken prej tij. Kjo përqëndrohet në analizën e stimujve dhe të interesave afatshkurtra dhe duhet të përfshijë:
 - a. listën e të gjithë aktorëve të përfshirë drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt në konflikt;
 - b. analizën e interesave, të marrëdhënieve, të kapaciteteve, të programit të paqes, të stimujve për çdo aktor;
 - c. grafikon.

Shënim: Për të analizuar konfliktet që përfshijnë trashëgiminë kulturore, hapi i dytë duhet të përfshijë grafikonin e palëve dhe të interesave të tyre në lidhje me trashëgiminë e prekur kulturore.





3. Analiza e dinamikës së konfliktit ka të bëjë me vlerësimin e mundësive që ka një konflikt për t'u zgjeruar, për t'u zvogëluar apo për të mbetur i qëndrueshëm, si dhe faktorët afatgjatë dhe afatshkurtër të përfshirë në konflikt. Kjo analizë duhet të përfshijë:

- a. analizën e prirjeve afatgjata;
- b. vlerësimin e shkaktarëve të mundshëm afatshkurtër;
- c. vlerësimin e faktorëve që mund të përshpejtojnë ose të ngadalësojnë dinamikën e konfliktit (duhet të merren parasysh institucionet dhe proceset);
- d. zhvillimin e skenarëve të konfliktit.

Shënim: Për të analizuar rreziqet ndaj trashëgimisë kulturore që është prekur, gjatë fazës së rimëkëmbjes së menjëhershme (shihni faqen 125) duhet të përfshihet një vlerësim se si do të perceptohen nga palët në konflikt veprimet e ndërmarra për të rimëkëmbur trashëgiminë kulturore.

Shikoni referencat në faqen 155.





PËRMIRËSONI GATISHMËRINË PËR RASTE EMERGJENTE!

Nëse do të ndodhte një emergjencë në qytetin tuaj dhe do prekeshin një numër koleksionesh dhe site të trashëgimisë kulturore:

- a) Kush mendoni se duhet të përfshihet në kryerjen e një analize të situatës?
- b) Si do t'i kontaktonit ata?
- c) A keni një hartë qyteti që tregon vendndodhjet e sakta të të gjitha siteve të trashëgimisë kulturore?
- d) A ekziston një listë përparësish që klasifikon pasuritë e ndryshme kulturore sipas rëndësisë së tyre

Çfarë vjen pas analizës së situatës?


PASI KA NDODHUR NJË EMERGJENCË në zonën tuaj, ju keni kryer një **analizë të situatës** me shumë palë interesi, anëtarë të komunitetit dhe aktorë përkatës të emergjencës; keni identifikuar vlera të trashëgimisë materiale dhe jomateriale që kanë pësuar dëme dhe / ose rrezikojnë të përkeqësohen më tej.

Cili duhet të jetë hapi juaj i ardhshëm?

Lexoni në vijim për ta zbuluar.

HAPI I DYTË

VLERËSIMI NË VEND I DËMIT DHE RISKUT, PAS NGJARJES



Çfarë është vlerësimi në vend i dëmit dhe i riskut, pas ngjarjes?

Kryerja e **analizës së situatës** ndihmon në identifikimin e vlerave të trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale, dhe kërkon inspektime të shpejta në terren. Këto njihen si **vlerësime në vend të dëmit dhe riskut** pas ngjarjes.

Përzgjedhja e pasurive kulturore për vlerësime të tilla bazohet në **rëndësinë** e tyre përkatëse, në shkallën e dëmit që kanë pësuar dhe rrezikun e dëmtimit të mëtejshëm.

Vlerësimi në vend i dëmit dhe riskut përfshin inspektimin pamor dhe dokumentimin e dëmit dhe të humbjeve. Ky hap është i dobishëm për vlerësimin e risqeve të menjëhershme, të cilat, nëse nuk trajtohen, mund të shkaktojnë më shumë dëm në trashëgiminë kulturore. Bazuar në informacionin para ngjarjes, ky vlerësim regjistron shkallën e dëmtimit fizik dhe atë çfarë mund të shpëtohet. Për më tepër, ai vlerëson humbjet – për shembull, mënyrën në të cilën fatkeqësia ka prekur njerëzit, të ardhurat dhe infrastrukturën e vendit të tyre.

Është e rëndësishme të ndërmerren vlerësime të integruara të dëmtimeve dhe të risqeve pas ngjarjes për të gjitha llojet e trashëgimisë kulturore, d.m.th. trashëgimi **të luajtshme, të paluajtshme** dhe **jomateriale**. Mosrealizimi i vlerësimeve të integruara mund të çojë në keqpërdorimin e kohës dhe të burimeve dhe në vlerësimin e gabuar të nevojave për rimëkëmbje. Ky lloj vlerësimi është thelbësor, pasi do të shërbejë si informacion për **planin strategjik** për zbatimin e veprimeve në terren, të përshkruara gjatë analizës së situatës.



Një ekip që kryen vlerësimin në vend të dëmit dhe të riskut , në Hanuman Muzeu "Dhoka Palace" në Kathmandu, Nepal, 2015. Foto: ICCROM



Pse duhet të ndërmerret vlerësimi në vend i dëmit dhe i riskut?

Një inspektim fillestar në vendin e prekur mundëson grumbullimin e informacioneve të mëtejshme mbi gjendjen e sitit / ndërtesës / objektit që nuk mund të merreshin ose verifikoheshin gjatë analizës së situatës.

Vlerësimi në vend ofron mundësinë:

- për të vlerësuar natyrën fizike të trashëgimisë së prekur brenda mjedisit të saj dhe për të identifikuar veprimet e nevojshme të sigurimit dhe stabilizimit.
- për të parë mënyrat se si fatkeqësia ka prekur grupin më të gjerë të palëve të interesit, p.sh., duke biseduar me komunitetin, drejtuesit lokalë, shitësit që shisnin сувенире në vendngjarje (ose pranë saj) si dhe punonjësit e bujtinave aty pranë.
- për të identifikuar risqet e menjëhershme dhe masat përkatëse lehtësuese.
- për të vlerësuar kostot specifike për veprimet e sigurisë dhe stabilizimit dhe rimëkëmbjen e plotë.

Vlerësimet në vend të dëmit dhe të riskut mund të përdoren për të siguruar fondet e nevojshme për ndihmën e parë dhe rimëkëmbjen e trashëgimisë kulturore. Vlerësime të tilla mund të shërbejnë si të dhëna për hartimin e “Post Disaster Needs Assessment (PDNA)” (**Vlerësimi të Nevojave Pas Fatkeqësisë**): një metodë vlerësimi shumë-sektoriale, e cila ndihmon qeveritë e prekura të përcaktojnë efektet e drejtpërdrejta, ndikimet afatgjata dhe nevojat e rimëkëmbjes pas një fatkeqësie në shkallë të gjerë.




Disa vende kanë metodat e tyre për të vlerësuar nevojat e rimëkëmbjes pas një fatkeqësie. Vlerësimi i nevojave pas fatkeqësisë kryhet vetëm kur një vend kërkon ndihmë nga organizata ndërkombëtare, të tilla si Kombet e Bashkuara.

Si të kryeni një vlerësim të integruar të dëmit dhe riskut në vend?

Më poshtë tregohet rendi i punës hap pas hapi për vlerësimin e integruar në vend të dëmit dhe riskut për trashëgiminë kulturore materiale, të luajtshme (objekte dhe koleksione), si dhe atë **jomateriale**.

Rendi i punës për vlerësimin në vend të dëmit dhe riskut pas ngjarjes





Përgatitja

Përdorni të dhënat e përfuara nga **analiza e situatës** si bazë, ndërkohë që:

1 Merrni të dhënat e kontaktit dhe lejet

Merrni leje nga kujdestarët apo administratorët kur është e nevojshme dhe nga koordinatori për përballimin dhe reagimin ndaj emergjencës, ose nga drejtuesi i operacionit, për hyrje-dalje në sitin(et) e prekur(a). Merrni të dhënat e kontaktit të anëtarëve të stafit ose të administratorëve që kanë njohuri të thelluara mbi trashëgiminë e prekur dhe gjendjen e saj para ngjarjes.

2 Përgatitni ekipin. Mblidhni dhe përgatitni një ekip për të kryer vlerësimin në vend të dëmit dhe të riskut. Ekipi duhet të krijohet në përputhje me natyrën e rrezikut, me shkallën e emergjencës dhe me llojin e trashëgimisë kulturore që është prekur.

Në rast emergjence në shkallë të gjerë, vlerësimi mund të ndërmerret në vende të shumta, nga vullnetarë dhe profesionistë me përvojë dhe me kualifikime nga fusha të ndryshme, si arkitektura, inxhinieria e ndërtimit, studimet muzeore, konservimi i objekteve të luajtshme dhe antropologjia. Në varësi të natyrës së emergjencës dhe të dëmit të shkaktuar, personeli ushtarak dhe reaguesit e emergjencës, siç janë inxhinierët për sigurinë e strukturave ndërtimore, mund të marrin pjesë në vlerësime të tilla. Për më tepër, në rast të një emergjence të madhe ose komplekse, ata mund të ofrojnë mbështetje logjistike për kryerjen e një vlerësimi.

Është e rëndësishme që ekipet që kryejnë vlerësimet të jenë trajnuar për të siguruar dokumentacion të qëndrueshëm, duke përfshirë:

- përdorimin uniform të mënyrave të vlerësimit dhe skicave të planimetrisë për regjistrimin e dëmeve dhe të risqeve;
- fotografimin me shkrepje të paracaktuara dhe standarde (shkrepje nga larg / panoramike ose shkrepje nga afër / foto-detaje) për të treguar një lloj specifik të dëmtimit ose të humbjes;
- zbatimi i paracaktuar dhe i saktë i shkallëve të dëmit të identifikuar, d.m.th., i madh, i moderuar / i mesëm ose i vogël, së bashku me një përshkrim të dëmit që i është shkaktuar objekteve, strukturave dhe vlerave të trashëgimisë jomateriale;

- d. përdorimi i formateve për të cilat është rënë dakord më parë për përpilimin e të dhënave për dëmet dhe për humbjet, të cilat duhet të kuptohen lehtë nga aktorët e emergjencës, palët e interesit dhe donatorët.

Shihni *Paketën e mjeteve* në faqen 15 për disa shembuj të praktikave të standardizuara të dokumentacionit dhe modelet për formularët e vlerësimit të dëmit dhe të riskut.

Orientimi për ekipet e vlerësimit në vend duhet të përfshijë procedurat për garantimin e sigurisë personale. Për më tepër, vullnetarët e përzgjedhur për një vlerësim në terren duhet të njohin kontekstin social dhe kulturor të zonës dhe duhet të jenë në gjendje të komunikojnë në gjuhën e komunitetit të prekur.

3 Mbledhja e të dhënave paraprake

Mblidhni dokumentacionin paraprak vijues:

- Një hartë, e cila tregon gjeo-koordinatat e trashëgimisë kulturore që është prekur;
- Hartën e sitit (*Paketa e mjeteve*, faqja 11) ose imazhin më të fundit satelitor, nëse është i disponueshëm;
- Mblidhni planimetritë, aty ku është e mundur, ose përndryshe përgatitni një skicë;
- Inventarët e mbajtur në vend, duke përkrahur llojin, numrin dhe vendndodhjen e ndërtesave, të objekteve dhe të elementeve jomateriale;
- Material fotografik para fatkeqësisë (kryesisht pamje të gjata ose të gjera) të vendeve të prekura, të ndërtesave, të objekteve dhe të trashëgimisë jomateriale.



Vini re, se lloji dhe rëndësia e të dhënave do të ndryshojnë ndjeshëm sipas llojit të trashëgimisë që është prekur. Për një institucion të vetëm kulturor, siç është një muze, planimetria e detajuar dhe inventari janë shumë më të rëndësishme sesa harta në shkallë të gjerë me gjeo-koordinatat. Po kështu, në rastin e një fatkeqësie që prek një zonë të madhe, planimetritë e veçanta të çdo kati, mund të jenë tepër të hollësishme për qëllimet e vlerësimit tuaj.




1-A

PLAN I NDEHTHUR I ZONIMIT DHE SIGURISE

PLANIFIKIMI PËR MENAXHIMIN E RISKUT PËR PALLATIN E QYTETIT, UDAIPUR

PLANI 3/2008
KONTROLIMI I DËSHMIMIT, KLASIFIKIMI
KONTROLIMI I RANIT, SIGURIA E ZONIT

- LEGJENDA**
- S PËRQAFI PËR SHTRIM
 - V PËRQAFI PËR VËDQET
 - O PËR KONTROLLIN
 - TËRTHI I PËRQAFI
 - ZONA E RANIT
 - "SHËNIMTAR"
 - MËZDUR PËR PALLATIN E QYTETIT
 - "RANIT"



Shembulli i hartës së shtit të Pallatit të Qytetit, (kompleks pallatesh në Udaipur, Indi, 2009.

Foto: Rohit Jigyasu

4 Mjetet dhe pajisjet

Mblidhni mjete për dokumentimin e dëmeve dhe të risqeve, si p.sh.: një aparat fotografik i pajisur me bateri rezervë dhe një formular të vlerësimit të integruar të dëmeve dhe të risqeve (shihni *Paketën e mjeteve*, faqja 15), i cili është specifik për kontekstin dhe lehtësisht i përdorshëm.

Mblidhni pajisjet personale të sigurisë sipas natyrës së rrezikut, p.sh., për një vlerësim në vend në një zonë të përmbytur, sigurohuni që të keni këpucë të papërshkueshme nga uji dhe maska fytyre mbrojtëse me mikrofiltra për të parandaluar infeksionet. Shikoni listën e përgjithshme të pajisjeve mbrojtëse personale në *Paketën e mjeteve* (shihni faqen 10).

5 Logjistika dhe mjetet e komunikimit

Përgatitni buxhetin për vlerësimin në vend, duke marrë parasysh kostot që lidhen me:

- a. Transportin
- b. Akomodimin
- c. Ushqimin dhe ujin e pijshëm
- d. Mbrojtjen dhe sigurinë
- e. Mjetet e komunikimit
- f. Pajisjet për regjistrimin e të dhënave gjatë vlerësimit
- g. Mjetet për sigurimin fillestar të vendit p.sh., litarë, shirit paralajmërimi, shenja, tabela udhëzuese, mushama mbrojtëse, etj.
- h. Personelin

Pasi vlerësimi të jetë gati, siguroni fondet e nevojshme dhe ndërmerrni veprimet e duhura për të organizuar të gjithë logjistikën në vend.



Në rastin e një emergjence në shkallë të gjerë, që përfshin shumë site, ngrini një zyrë të përkohshme (me çadër, ose materiale të tjera) në afërsi të zonës së prekur, që të shërbejë si qendër organizimi dhe si bazë operacionesh për ekipet që kryejnë vlerësimin në vend.



6 Koordinoni planin tuaj

Koordinoni planin tuaj me aktorët e tjerë të emergjencës dhe agjencitë që veprojnë në zonë. Kjo është e rëndësishme, pasi vlerësimet të sigurisë strukturore dhe të përdorshmërisë për ndërtesat publike mund të kryhen në të njëjtën kohë. Ndërtesat publike zakonisht përfshijnë muze, biblioteka, arkiva dhe struktura të trashëgimisë. Në mënyrë të ngjashme, agjencitë e menaxhimit të emergjencave mund të vendosin strehë të përkohshme në hapësira të hapura brenda siteve të trashëgimisë. Puna e tyre mund të përkojë me vlerësimet në vend dhe me veprimet për sigurimin dhe ato të stabilizimit të trashëgimisë kulturore.



Kur vendet e trashëgimisë po përdoren për të ngritur strehime të përkohshme, gjatë ndihmës së parë, konsultohuni me administratorët për të dhënë udhëzime se si ta përdorni vendin në mënyrë të sigurt.



Inspektoni vendngjarjen / sitin

- 1 E cni brenda dhe përreth vendit të ngjarjes dhe identifikoni nëse hyrjet në të gjitha zonat janë të lira apo të bllokuara. Shënoni pikat e hyrjes në planimetrinë e sitit.
- 2 Identifikoni, shenjoni dhe, nëse është e nevojshme, përgatitni rrugë të sigurta për hyrje-daljet në sit; sidomos për hyrjen deri në pikën ku automjetet mund të afrohen dhe për hapësirën ku mund të parkohen. Identifikoni gjithashtu daljet e sigurta dhe rrugët e evakuimit nga vendngjarja drejt zonave të sigurta, në rast se do të ketë nevojë për një largim të shpejtë.
- 3 Nëse ka një dëm të dukshëm në një ndërtesë, konsultohuni me një inxhinier konstruktor. Nëse hyrja është e sigurt, shënoni një rrugë të sigurt të hyrjes së brendshme në planimetri. Në rast se nuk është e disponueshme një planimetri, vizatoni një skicë.



Mos iu afroni një muri më afër sesa lartësia maksimale e tij, pa u kryer një vlerësim fillestar i qëndrueshmërisë së tij. Qëndroni larg strukturave të mureve të papërforuara (mur mbajtës), me çati / kulm me dy pjerrësi dhe me fronton, Ato, duke qenë më të larta se muret perimetrale, zakonisht janë më të cenueshme (shihni foton).



Një mur me fronton, me çati / kulm me dy pjerrësi, Gujarat, Indi, 2015. Foto: Rohit Jigyasu

- 4 Identifikoni elementet strukturore kryesore: a është një strukturë mbajtëse ose jo, e përforcuar apo jo me breza? Çfarë tipi çatie ka? Kjo do të ndihmojë në identifikimin e zonave më të rrezikuara të ndërtesës dhe ato për të cilat operatorët e ndihmës së parë dhe vullnetarët duhet të kenë kujdes.
- 5 Me ndihmën e drejtuesve lokalë të emergjencave, identifikoni vendet e sigurta të punës e të magazinimit brenda dhe përreth sitit, që mund të përdoren nga vullnetarët dhe operatorët e ndihmës së parë të trashëgimisë për të ndërmarrë veprime të vënies në siguri dhe stabilizimit.



Strukturë pa kornizë e dëmtuar nga tërmeti, Itali, 2017.

Foto: Eisuke Nishikawa


- 6 Identifikoni dhe regjistroni dëmet në shërbimet kryesore dhe infrastrukturë, p.sh., pajisjet me energji elektrike dhe ujë etj. Nëse ende nuk është kryer, mbyllini pajisjet e ujit, energjisë elektrike dhe gazit. Kini parasysh se më vonë mund t'ju duhet furnizim me ujë të freskët dhe energji elektrike për të stabilizuar objektet në vend.
- 7 Kontrolloni nëse ka inerte në mjedisin e jashtëm, që nuk nevojiten ose që janë mbetje të rrezikshme, siç janë kimikatet që duhen asgjësuar. Nëse jeni përpara një rasti të tillë, shënoni pozicionin e tyre në hartën e sitit. Në raste të tilla, duhet të thirren profesionistë të specializuar dhe të trajnuar për të menaxhuar inertet dhe shkatërrimin e tyre pas fatkeqësisë. Në të njëjtën kohë, kontrolloni nëse vendi ka dëmtime në pjesë të ndërtesës ose në fragmente të elementeve dekorative, të cilat duhet të shpëtohen. Shënojeni vendndodhjen e tyre në hartën e sitit.



Regjistroni dëmin dhe efektet e fatkeqësisë

Regjistroni dëmin e shkaktuar në trashëgiminë kulturore të paluajtshme

- 1 Në rastin e një siti arkeologjik, shënoni dëmin në një hartë të sitit. Ndërsa në rastin e ndërtesave me vlera të trashëgimisë, shënojeni në planimetri, pamje dhe prerje (nëse ka); përndryshe regjistroni dëmin në një skicë. Sidoqoftë, ndërkohë që jeni në vendngjarje, regjistroni vetëm dëmin kryesor: koha do të jetë e kufizuar dhe është me rëndësi jetike të vendosni përparësitë e veprimeve të përballimit për t'u dhënë zgjidhje kërcënimeve më kritike, për shembull, pjesë të mureve që janë në pikën e shembjes për shkak të inklinimit, epjeve, zbërthimit të strukturës ose për shkak të çarjeve të konsiderueshme dhe të thella. Për më shumë informacion, referojuni udhëzimeve për dëmet tipike të shkaktuara në strukturat e trashëgimisë kulturore nga rreziqe të ndryshme në *Paketën e mjeteve*, faqja 28.



Shembull i një skice, plan, pamje dhe prerje, Romë, 2018. Foto: Eisuke Nishikawa

- 2 Në rastin e ndërtesës (ose ndërtesave) së prekur(a): regjistroni vetëm dëmin e jashtëm të ndërtesës duke e vërejtur nga një largësi e sigurt, derisa eksperti i autorizuar t'ju japë lejen për të kryer një studim nga brenda.
- 3 Bëni një fotografi të dëmtimit në një pamje të përgjithshme të sitit / ndërtesës (pamje horizontale ose vertikale) dhe shënoni numrin

e referencës së fotos në hartën e sitit / planimetrinë e ndërtesës. Përshkruani llojin e dëmit, vendndodhjen dhe shkallën e tij në formularin e vlerësimit.

- 4 Identifikoni ndërtesat (në rastin e një siti më të madh) ose mjediset e brendshme (në rast të një ndërtese të vetme), që kanë pësuar dëme të mëdha në elementet strukturore dhe jostrukturore, si dhe shënoni vendndodhjen e tyre në planimetritë përkatëse. Përgatitni një formular të veçantë vlerësimi për secilën ndërtesë dhe përdoreni atë për të përshkruar llojin dhe shkallën e dëmtimit. Nëse është e mundur, bëni një fotografi të dëmtimit dhe shënoni numrin e referencës në planimetri.
- 5 Bisedoni me personat që punojnë ose jetojnë në sitin përkatës. Ata mund të kenë informacion të vlefshëm për çka ndodhet nën rrënoja ose për situatën para mbërritjes suaj në vend.
- 6 Regjistroni humbjet ekonomike – për shembull, humbjet në të ardhura ose të ardhurat që fitoheshin nga shitja e biletave për të hyrë në një vend të trashëgimisë ose muze.

Për referenca të mëtejshme udhëzuese dhe për një model për hartimin e formularit për vlerësimin e dëmit dhe të risqeve në trashëgiminë kulturore të paluajtshme dhe të luajtshme, shihni *Paketën e mjeteve*, faqja 15.

Regjistroni dëmet e shkaktuara në objektet dhe në koleksionet e trashëgimisë kulturore

- 1 Identifikoni dhe shënoni në një planimetri vendndodhjen e mjedisit / zonës që përmban objekte të dëmtuara të trashëgimisë kulturore. Nëse planimetritë nuk janë të disponueshme përdorni ose vizatoni një skicë.
- 2 Përdorni **inventarin** e gjendjes para ngjarjes dhe inspektimin pamor për të përcaktuar numrin e objekteve të dëmtuara, materialet e ndërtimit, si guri, druri, letra apo metal. Ky informacion duhet të regjistrohet në formularin tuaj për vlerësimin e dëmit dhe të riskut.
- 3 Mundohuni të identifikoni llojin dhe shkallën e dëmtimit. Për shembull, regjistroni nëse objektet janë thyer dhe / ose deformuar. Kontrolloni nëse objektet janë të lagura, të thata, të ndotura ose të djegura. Regjistrojini vëzhgimet tuaja në formularin e vlerësimit.
- 4 Regjistroni nëse objektet janë të ekspozuara ndaj mjedisëve me materiale të rrezikshme, siç janë kimikatet ose mbeturinat urbane.



Skulptura të dëmtuara në Hanuman Dhoka, Kathmandu, Nepal 2015.
Foto: Aparna Tandon, ICCROM.

- 5 Bëni fotografi të objekteve të dëmtuara. Nëse i gjeni të grumbulluara në një ose shumë grupe, bëni fotografi me kënd të gjerë të secilit grup. Regjistroni numrat e referencës së fotografive të marra në formularin e vlerësimit dhe në planimetrinë e katit.

Regjistroni efektet e një fatkeqësie në trashëgiminë jomateriale. Diskutoni me grupet përkatëse brenda komunitetit (udhëheqësit fetarë, grupimet e grave, të moshuarit, shoqatat e artizanëve etj.), për të përcaktuar se cila vlerë e trashëgimisë jomateriale është ndikuar dhe si.



Përdorni të dhënat e përfituara nga harta e **palëve të interesit**, e përgatitur gjatë analizës së situatës, në mënyrë që të identifikoni grupet përkatëse brenda komunitetit për një konsultim të tillë.

- 1 Udhëzoheni komunitetin për t'u siguruar që të mos marrin parasysht vetëm festat ose aktivitetet më të rëndësishme. Merrni në konsideratë kategoritë e **Konventës së UNESCO-s për Ruajtjen e Trashëgimisë Jomateriale të vitit 2003**: shprehjet gojore (përfshirë gjuhën); artet skenike; praktikat shoqërore, rritualët dhe ngjarjet festive; njohuritë / traditat lokale dhe zanatet.

Vlerësimi duhet të përfshijë interpretimin, qasjen dhe transmetimin e trashëgimisë jomateriale të prekur. Të tria janë të ndërlydhura fort.

- 2 Dokumentoni pasuritë kulturore materiale që kanë të bëjnë me trashëgiminë jomateriale (si vendet, sitet, objektet, kostumet dhe mjetet). Pasuritë materiale janë më të lehtë për t'u vlerësuar. Mund të përdoret e njëjta metodë siç përshkruhet në kapitujt e mësipërm.



Shpesh, dëmtimi i pasurive kulturore materiale nuk ndikon në trashëgiminë jomateriale. Për shembull, ritualet mund të vazhdojnë diku tjetër ose festivalet mund të zhvillohen me kostume të reja. Sidoqoftë, mos harroni humbjet e tjera: si për shembull, humbja e qasjes në tregje dhe humbja e veglave të punës mund të nënkuptojë humbje të të ardhurave për artizanët.

- 3 Komunikoni me njerëzit, përfshirë interpretuesit, praktikuesit, udhëheqësit shpirtërorë dhe të moshuarit. Nga vlerësimi duhet të shihet se si janë prekur bartësit e trashëgimisë jomateriale. Për shembull, një fatkeqësi mund të rezultojë në humbjen e jetës të bartësve të njohurive ose mund të çojë gjithashtu në shpërnguljen e tyre, gjë që mund të ndërllojë transmetimin e njohurive ose të traditave. Zhvendosja mund të nënkuptojë gjithashtu që shëruesit popullorë ose udhëheqësit shpirtërorë / klerikët nuk mund të hyjnë më në vendet e shenjta për të kryer rituale.
- 4 Identifikoni dhe vlerësoni traditat dhe njohuritë. Ky hap i vlerësimit është më i vështiri: ai kërkon të kuptohet mirë se si ka evoluar trashëgimia jomateriale në fjalë. Kjo do t'ju lejojë të vlerësoni shkallën e ndryshimit që ka sjellë fatkeqësia, si dhe efektin që kjo mund të ketë me kalimin e kohës. Shumë shpesh, në vend që të bëjë të humbin njohuritë ose traditat, një fatkeqësi mund të bëjë që trashëgimia jomateriale të ndryshojë ndjeshëm.

Për shembull, një procesion mund të vazhdojë të organizohet, por përsëritjet e ardhshme nuk do të ndjekin të njëjtën rrugë. Në mënyrë të ngjashme, historitë lokale mund të ritregohen ndryshe, duke patur parasysht elementet e ngjarjeve të fundit të fatkeqësisë. Është thelbësore që vlerësimet pas fatkeqësisë të marrin parasysht ndryshimet e tilla në praktika të sjella nga vetë fatkeqësia. Ato nuk janë domosdoshmërisht negative dhe mund të tregojnë aftësinë përtëritëse të trashëgimisë jomateriale dhe bartësve të saj.

Për një model për vlerësimin e efekteve të një fatkeqësie në trashëgiminë jomateriale, shihni *Paketën e mjeteve*, faqja 22.












Vlerësoni dhe regjistroni risqet e menjëhershme

Një vlerësim i riskut pas ngjarjes ndihmon në përcaktimin e menjëhershëm të riskut gjatë një situatë që ndryshon me shpejtësi në raste emergjence. Gjithashtu ndihmon në përcaktimin e masave që duhet të ndërmerren për zvogëlimin e riskut dhe për rritjen e gatishmërisë, para se trashëgimia kulturore të pësojë humbje të pariparueshme.

Rendi i punës për vlerësimin e risqeve paraqitet i detajuar më poshtë:

- 1 Identifikoni rreziqet e mundshme (natyrore ose të shkaktuara nga njerëzit) që mund të përbëjnë kërcënim të pashmangshëm për jetën dhe / ose të cilat mund të shkaktojnë dëme në trashëgiminë materiale dhe jomateriale.

Merrni parasysh rreziqet parësore dhe ato dytësore. Për shembull, një tërmet, si një rrezik kryesor, mund të shkaktojë rreziqe dytësore, të tilla si cunami, përmbytje, zjarrvënie ose vandalizëm. Nëse këto burime rreziku janë të lokalizuara, identifikoni vendndodhjen e tyre brenda dhe përreth sitit / ndërtesës / komunitetit.

Rreziqe parësore	Rreziqe dytësore
Rreziqet natyrore	
 Tërmet	Zjarr, rrëshqitje dheu, cunami, lëngëzim i terrenit
 Përmbytje	Rrëshqitje dheu, kërpudha / myk, kristalizimi i kripërave në sipërfaqe, korrozion
 Cunami	Zjarr, përmbytje
 Uragan/Tornado	Zjarr, dëmtim nga era
 Zjarre	Dëmtim nga uji, kërpudha / myk, efloreshencë ose kristalizimi i kripërave në sipërfaqe, korrozion
 Vullkan	Zjarr, rrëshqitje dheu, tërmet
Rreziqet e shkaktuara nga njerëzit	
 Luftime	Zjarr, bombardime, Shkatërrim
 Terrorizëm	Zjarr, bombardime
 Vandalizëm	Shkatërrim, vjedhje



- 2 Identifikoni pikat e dobëta fizike, sociale, ekonomike, politike dhe ato të sjelljeve / qëndrimeve, të cilat e ekspozojnë trashëgiminë ndaj rreziqeve të ndryshme.

Këto pika të dobëta mund të identifikohen siç përshkruhen më poshtë:

- a. Përdorni gjetjet e **analizës së situatës** për të kuptuar se si dhe pse trashëgimia u dëmtua dhe si mund të ekspozohet ndaj rreziqeve dytësore. Për shembull, një ndërtim i trashëgimisë kulturore i lënë pas dore, i cili ka pësuar dëme nga një stuhi, mund të vazhdojë të jetë i ekspozuar ndaj rreziqeve dytësore, siç janë dëmtimet nga zjarri dhe shiu. Mungesa e mirëmbajtjes së trashëgimisë mund të vijë nga një sërë shkaqesh me bazë sociale ose ekonomike, siç mund të jenë mungesa e burimeve, ose atje ku trashëgimia i përket një komuniteti minoritar.
- b. Ndërsa regjistroni dëmin, vëzhgoni se si tiparet e trashëgimisë mund ta bëjnë atë më të ndjeshme ndaj rreziqeve dytësore. Për shembull, objektet e lagura dhe të ndotura, të cilat përbëhen nga materiale organike, janë më të prirura të infektohen nga myku dhe insektet e dëmshme.
- c. Gjatë vlerësimeve në vend, regjistroni aktivitetet brenda dhe përreth sitit ose komunitetit, të cilat mund të krijojnë ose rritin cenueshmërinë dhe rreziqet. Për shembull, strehimi i njerëzve në një zonë të hapur pranë sitit të trashëgimisë mund të bëhet shkas për rreziqe si pasojë e plaçkitjeve dhe vandalizmave, ose ngritja e një kuzhine të improvizuar dhe të vendosur pranë sitit, mund ta ekspozojë atë ndaj rreziqeve nga zjarri.
Bëni intervista në vend, me grupet e interesit dhe aktorët e tjerë, për të vlerësuar perceptimin e tyre të kërcënimeve, kufizimeve dhe nevojave. Grupet e interesit dhe aktorët mund të përfshijnë administratorët e siteve, kujdestarët, rojet e sigurisë dhe fqinjët.
- d. Për trashëgiminë jomateriale merrni parasysh proceset shoqërore që ndikojnë në transmetimin, në qasjen në të ose në praktikën e vlerave të trashëgimisë jomateriale. Për shembull, njohuritë mund të mos jenë prekur, por zhvendosja në shkallë të gjerë e komuniteteve ose humbja e qasjes në tregje mund të sjellë që në planin afatmesëm dhe afatgjatë brezat e rinj ta humbin interesin ose të mos jenë në gjendje të mësojnë, ose të përvetësojnë një traditë të caktuar nga komuniteti i tyre.

3 Për të vlerësuar rreziqet e menjëhershme, hartoni deklaratat e riskut.

Një deklaratë rrishtu shpjegon se si rreziqet kryesore dhe dytësore mund të ndërliohen me pikat e dobëta dhe me nivelet e ekspozimit, duke patur një ndikim të menjëhershëm në llojet e ndryshme të trashëgimisë kulturore dhe në sigurinë e njerëzve.

Për shembull: gjatë reshjeve të dendura të shiut, çarjet në tavan mund të shkaktojnë depërtimin e ujrave, duke dëmtuar kështu interiere me vlera historike dhe sipërfaqet e afreskuara që ndodhen poshtë tij; ose mungesa e rrethimit dhe e sistemeve të sigurisë mund ta ekspozojnë një manastir ndaj rrezikut të plaçkitjes.

Ndërsa hartoni një deklaratë rrishtu, merrini parasysh të gjitha lidhjet e mundshme midis pikave të dobëta, **rreziqeve parësore dhe dytësore**, si dhe niveleve të ekspozimit të cilat mund të rritin efektet negative të fatkeqësisë (shihni figurën më poshtë).

Hartimi i deklaratës së riskut mund të marrë kohë. Kjo punë mund të kryhet jashtë sitit, ndërkohë që ju jeni duke përpiluar të dhëna.





Ndikimet e tërmetit Tohoku dhe cunamit: Japoni

Më 11 mars 2011, një tërmet me magnitudë 9.0 të shkallës Rihter goditi bregun verilindor të Honshusë, ishullit më të madh të Japonisë. Ai u pasua nga një cunami i madh dhe i fuqishëm, i cili përmbysi brigjet e Japonisë lindore dhe pjesë të qytetit të Sendait, duke përfshirë aeroportin e tij dhe shumë vendbanime tradicionale. Tërmeti gjithashtu shkaktoi dëme në një digë, uji i së cilës shkaktoi përmbytje përgjatë drejtimit të vërshimit. Cunami shkaktoi përmbysjen e cisternave dhe derdhje të naftës, duke shkaktuar zjarre; gjithashtu cunami shkaktoi shpërthime edhe në një termocentral bërthamor.



*Shembja e ndërtesës e shkaktuar nga cunami në Japoninë lindore, 2011.
Foto: Bordi i prefekturës Miyagi.*

Në këtë rast, tërmeti ishte rreziku kryesor dhe ai shkaktoi rreziqe dytësore të lidhura me të, siç ishin pasgoditjet, cunami, përmbytjet, zjarret dhe aksidenti bërthamor. Afërsia e Japonisë me detin dhe vendndodhja gjeografike e saj, e ekspozojnë vendin ndaj rreziqeve, si tërmete dhe cunami. Për më tepër, prania e cisternave të naftës dhe e një reaktori bërthamor në zonë u dëshmuar se ishin pika të dobëta, të cilat, nga ana tjetër, shkaktuan zjarre dhe rrezatim bërthamor. Efekti i kombinuar i këtij zinxhiri ngjarjesh të rrezikshme shkaktoi më shumë se 19 000 viktima, qindra mijëra të pastrehë





dhe shkatërrimin e infrastrukturës jetësore, përfshirë rrugët dhe termocentralet. Për më tepër, u regjistruan më shumë se 700 raste dëmtimesh të trashëgimisë kulturore. Shumë ndërtesa të trashëgimisë pësuan dëmtime strukturore të vogla dhe mesatare për shkak të tërmetit. Në disa pjesë të zonës së prekur dallgët e cunamit zhdukën objekte historike, tradicionale dhe koleksione.

Më në brendësi të territorit, ku dallgët e cunamit nuk mund të arrinin, një vend depozitimi arkeologjik dhe trashëgimi të tjera të luajtshme u dëmtuan nga përmytja, shkaktuar si rezultat i dëmtimit të digës. Trashëgimia e luajtshme u prek gjithashtu nga rrezatimi bërthamor dhe prania e rrezatimeve vonoi rikuperimin e objekteve. Ndërprerja e energjisë në zonën e prekur ekspozoi objektet e lagura - të përbëra nga materiale organike, si druri dhe letra - ndaj rrezikut të mykut dhe formave të tjera të bio-degradimit.

Shikoni referencat në faqen 159.

- 4 Identifikoni nivelin e riskut (të ulët, të mesëm ose të lartë) për secilën deklaratë të riskut, bazuar në natyrën e risqeve parësore dhe dytësore, në mundësinë që ka për të ndodhur, si dhe në ndikimin e mundshëm të tyre në sigurinë e njerëzve dhe të vlerave të trashëgimisë. Për shembull, për shkak të çarjeve strukturore pas një tërmeti, rreziku i shembjes së një ndërtese gjatë pasgoditjeve është i lartë. Përkundrazi, rreziku i shembjes, në rastin e përmytjeve të pjesshme, të shkaktuara nga kombinimi i shirave të dendur dhe depërtimit të ujit përmes një çarjeje të vogël në tavanin e së njëjtës ndërtesë, është relativisht i ulët.

Shihni *Paketën e mjeteve*, faqja 14, për formularët dhe burimet e tjera që mund t'ju vijnë në ndihmë për vlerësimin e rrezikut të menjëhershëm.





Përpiloni të dhënat

- 1 Menjëherë pas vlerësimeve në terren, digjitalizoni në mënyrë sistematike formularët e vlerësimit dhe skicat për secilin lloj të trashëgimisë. Kjo do të ndihmojë në parandalimin e humbjes së të dhënave dhe në shkëmbimin e informacionit në një format të përdorshëm. Ju duhet të planifikoni të digjitalizoni rezultatet të paktën çdo ditë, kështu që sigurohuni që të keni përcaktuar një metodë digjitalizimi dhe procedurë për ndjekjen e punës para se të fillojë puna në terren. Secili komponent i trashëgimisë apo pasurisë kulturore duhet të identifikohet lehtësisht përmes një numri unik identifikimi (shihni *Paketën e mjeteve*, faqja 42).
- 2 Për intervista me grupet e interesit: mblidhni shënime ose transkriptime të intervistave dhe ruajini këto së bashku me të dhëna të tjera. Sigurohuni që të përmendni emrin e burimit, datën dhe vendin e intervistës dhe, nëse është e mundur, një mënyrë për të kontaktuar me të intervistuarin.
- 3 Shkarkoni fotografitë nga kamera dhe bashkëlidhni ato me kopjen digjitale të planimetrive përmes numrave të tyre të referencës. Përndryshe, hiqni emërtimin origjinal të dokumentit apo emërtimin numerik të fotografisë të shkarkuar nga aparati dhe zëvendësojeni atë me një emërtim që tregon vendin, datën dhe llojin e dëmtimit në formën e kodeve të shkurtra. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rast të vlerësimeve që mbulojnë disa site dhe / ose ato që kryhen në faza të ndryshme. Sigurohuni që emrat dhe kodet e dosjeve/ dokumenteve të jenë të qëndrueshëm dhe të kuptueshëm nga të gjithë ata që janë të përfshirë në vlerësimin dhe në përpilimin e të dhënave.
- 4 Lidhni të dhënat që përmban formulari i vlerësimit me hartën e sitit, planimetritë dhe fotografitë e dëmit, duke përpiluar një skedar unik.
- 5 Nëse nuk keni qenë në gjendje ta bëni këtë në vendngjarje, përgatitni deklaratën tuaj të riskut dhe identifikoni nivelin e riskut për secilin formular.
- 6 Mblidhni, kategorizoni dhe ruani të gjitha të dhënat e mbledhura nga vendngjarja në një bazë të dhënash të standardizuar për të lehtësuar qasjen dhe analizën.



Mjeti i përpilimit dhe i vizualizimit

Aplikacioni i **Sistemeve të Informacionit Gjeografik (GIS)** i instaluar në celularin ose në tabletën tuaj elektronike mund të jetë shumë i dobishëm për dokumentimin “in-situ” përsa i përket trashëgimisë së paluajtshme (të ndërtuar) dhe fondet e vlerave kulturore. Formularët e vlerësimit të dëmit dhe riskut mund të plotësohen pa përdorur internetin nëpërmjet mjetit GIS, dhe fotografitë mund të bashkëngjiten drejtpërdrejt, në mënyrë që të gjithë formularët dhe fotografitë të mbahen së bashku. Pasi telefoni juaj celular të jetë lidhur në internet, formularët dhe fotot mund të eksportohen drejtpërdrejt në një bazë të dhënash qendrore. Është e rëndësishme të theksohet se çdo aplikacion që zgjidhni për të regjistruar, përpiluar dhe për të paraqitur të dhëna, do të duhet të personalizohet dhe ekipet tuaja të vlerësimit do të kenë nevojë për udhëzime për t’i përdorur ato në terren.

Shikoni referencat në faqen 158.



Përgatitni raportin e vlerësimit


Bazuar në studimin e sitit, përgatitni një raport vlerësimi të konsoliduar, që përfshin informacionin e mëposhtëm:

- Rëndësia (domethënita) e pasurive kulturore të prekura (siti / koleksioni / tradita e trashëgimisë).
- Natyra e fatkeqësisë ose e konfliktit. Çfarë ndodhi? Kur? Si u përfshi trashëgimia kulturore?
- Përshkrimi i dëmit në trashëgiminë kulturore të luajtshme dhe efektet e fatkeqësisë në trashëgiminë kulturore jomateriale. Ky duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtër të llojit të dëmit / efektit, vendndodhjes (duke iu referuar, kur është e nevojshme, hartës bazë, hartës së sitit dhe planimetrive ose skicave) dhe shkaqeve të mundshme. Përfshini një fotografi për të ilustruar secilin element të dëmtimit. Për trashëgiminë kulturore jomateriale, përshkrimi mund të përfshijë detajet mbi aspektet që janë prekur: elemente të prekshme, njerëz dhe / ose dije / tradita.
- Humbjet (nëse ka), duke iu referuar njerëzve, të ardhurave specifike dhe / ose infrastrukturës përkatëse, si dhe efektet

negative afatgjata të humbjeve në trashëgiminë kulturore të prekur.

- Deklaratat e riskut bazuar në identifikimin e rreziqeve, të pikave të dobëta dhe të rreziqeve pasuese për llojet e ndryshme të pasurive kulturore.
- Veprime të menjëhershme në vend për sigurimin dhe stabilizimin, të nevojshme për secilën pasuri kulturore.
- Burimet e kërkuara për sigurimin dhe stabilizimin e pasurive kulturore të prekura, së bashku me një afat kohor të përcaktuar.

Në raport duhet përmendur data, autorët, emrat dhe detajet / të dhënat e kontaktit të të gjithë atyre që janë përfshirë në vlerësimet në terren, së bashku me përgjegjësitë e tyre. Duhet gjithashtu të përmenden edhe emrat e të gjithë atyre që janë intervistuar gjatë vlerësimeve.



Përditësoni planin për zbatimin e veprimeve në vendngjarje

Një raport i konsoliduar i dëmit dhe i vlerësimit të riskut mund të përdoret për të përpunuar planin për zbatimin e **veprimeve të sigurimit dhe stabilizimit, të identifikuara gjatë analizës së situatës** (shihni faqen 37). Është veçanërisht e dobishme t'i jepet përparësi veprimeve specifike në vendngjarje – për shembull, duke siguruar një mbulesë të përkohshme të elementeve strukturore të ekspozuara dhe të dëmtuara. Gjithashtu ndihmon edhe përcaktimi i llojit të burimeve dhe të ekspertizës së nevojshme për të stabilizuar secilën pasuri të trashëgimisë kulturore që është prekur.



Vlerësimi i Nevojave Pas Fatkeqësive (“Post Disaster Needs Assessment - PDNA”)

Qëllimi i një PDNA-je është të kryejë vlerësimin e nevojave dhe të zhvillojë një sistem rimëkëmbjeje, i cili do të futet në kërkesat e përbashkëta për fonde emergjente (p.sh., thirrjet humanitare të shpejta) dhe mund të shërbejë si bazë për përcaktimin e përparësive të rimëkëmbjes në nivel kombëtar, gjithashtu dhe për fonde. Duke qenë se PDNA-ja ka për qëllim të informojë thirrjet për mbledhjen e fondeve, ajo zakonisht kryhet brenda katër deri në gjashtë javë nga fatkeqësia.



→ Rezultati më i drejtpërdrejtë i PDNA-së është një raport që përbëhet nga dy pjesë: **vlerësimi i nevojave** dhe **sistemi i rimëkëmbjes**. Ky raport është një përmbledhje e raporteve të ndryshme sektoriale, përfshirë edhe një të tillë për kulturën.

PDNA-ja është një proces i udhëhequr nga qeveria, i kryer së bashku me partnerët përkatës të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në varësi të kontekstit dhe ndikimit që një fatkeqësi ka pasur në **kapacitetet** qeveritare, qeveria mund të kërkojë që OKB-ja të marrë drejtimin. Gjatë vlerësimit, një PDNA mbështetet në pjesëmarrjen e gjerë të organizatave, të komuniteteve dhe të individëve; organizata dhe ekspertë ndërkombëtarë; qeverisje lokale, komunitete të prekura, kryesitë/kryetarët vendorë (zyrtarë, tradicionalë dhe shpirtëror, oficerët e sigurimit dhe sektori privat.

Në shumicën e rasteve, një PDNA për sektorin e kulturës drejtohet nga qeveria dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO), së bashku me një ekip ekspertësh nga fusha të ndryshme kulturore (arkitektë, inxhinierë, muzeologë, antropologë, arkeologë etj.).

Një **kapitull për vlerësimin e kulturës** është përfshirë nën komponentin social të udhëzimeve të PDNA –së (Vlerësimi i Nevojave pas Fatkeqësisë).

PDNA-ja dhe bashkëveprimi me hapat e ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore.

Ndërveprimi i **analizës së situatës** dhe **vlerësimit të dëmit dhe riskut në vend** me PDNA-në, varet nga koha e zbatimit të secilës prej tyre. Në parim, secili proces mund të integrohet lehtë me tjetrin, cilido të kryhet i pari. Meqenëse as ndihma e parë dhe as PDNA-ja nuk kanë një afat kohor të caktuar, kjo do të ndryshojë nga rasti në rast.

Burimi: Elke Selter, Shkolla e Studimeve Orientale dhe Afrikane, Universiteti i Londrës, MB.

Shikoni referencat në faqen 159.





Në lidhje me pasuritë kulturore, përmirësoni gatishmërinë për vlerësimet në vend të dëmit dhe riskut pas ngjarjes.

Merrni parasysh pyetjet e mëposhtme:

- A keni përgatitur një listë të të gjitha pasurive kulturore dhe a keni verifikuar nëse ekziston një hartë që paraqet koordinatat e tyre gjeografike?
- A keni informacion specifik para ngjarjes për pasuritë kulturore, siç janë inventarët, planimetritë, fotografitë dhe raportet e gjendjes?
- A keni përgatitur një model të formularit të vlerësimit të dëmit dhe riskut, të përshtatur për të mbuluar llojet e ndryshme të pasurive kulturore në zonën tuaj?
- A keni identifikuar profesionistët e trashëgimisë dhe menaxherët e emergjencave, të cilët do të jenë në gjendje të ndërmarrin vlerësime dëmi dhe risku në zonën tuaj?
- A e keni testuar formularin-model me ekipin e vlerësimit dhe a keni zhvilluar një sistem për përpilimin e të dhënave dhe paraqitjen e të dhënave së bashku?
- A keni bërë marrëveshje institucionale për financimin e vlerësimeve në vend të dëmit dhe riskut pas ngjarjes?
- A keni krijuar lidhje me institucionin vendor përgjegjës për menaxhimin e emergjencës dhe a keni bërë marrëveshje për koordinimin e vlerësimeve të sigurisë për sitet e trashëgimisë kulturore?


Cila është faza vijuese pas vlerësimit në vend të dëmit dhe riskut?

PAS NJË EMERGJENCE në zonën tuaj, ju dhe ekipi i operatorëve të ndihmës së parë të trashëgimisë kulturore, keni kryer **një analizë të situatës** dhe **vlerësimin në vend të dëmit dhe riskut** për trashëgiminë kulturore të prekur. Të dy këta hapa u ndërmorën në koordinim me aktorët përkatës të emergjencave, si dhe me pjesëmarrjen e grupeve përkatëse të interesit dhe komunitetit vendas. Për pasojë, ju keni qenë në gjendje të identifikoni përparësitë (prioritetet) për sigurimin dhe stabilizimin e strukturave, objekteve dhe trashëgimisë jomateriale.

Si do të vazhdoni?

Lexoni në vijim për ta zbuluar.

HAPI I TRETË SIGURIMI DHE STABILIZIMI



Çfarë është sigurimi dhe stabilizimi?

Veprimet që stabilizojnë gjendjen e trashëgimisë së prekur dhe parandalojnë dëmtimin dhe humbjen e mëtejshme, përmes zvogëlimit të riskut, quhen bashkërisht veprime të sigurimit dhe stabilizimit.

Këto veprime janë të natyrës së përkohshme dhe synojnë të sigurojnë ndihmën e duhur për trashëgiminë e dëmtuar gjatë një emergjence, derisa të bëhet e mundur që të realizohen trajtime të plota konservuese / restauruese.

Veprimet e sigurimit dhe stabilizimit apo qendrueshmërisë varen nga konteksti dhe jo gjithmonë ndjekin një rend të caktuar. Sidoqoftë, që një ndërhyrje të jetë e suksesshme, është thelbësore që të ketë një dokumentim të kujdesshëm të vlerave të trashëgimisë dhe të veprimeve të ndërmarra për ta stabilizuar dhe siguruar atë.



*Vënia në praktikë e stabilizimit emergjent gjatë një punëtorie në Shouf, Liban, 2014
Foto: ICCROM-ATHAR.*

Veprimet themelore të sigurimit dhe stabilizimit përfshijnë:

- Ngritjen e një rrethimi mbrojtës rreth zonës ose koleksionit të prekur.
- Sigurimin e strehës së përkohshme mbrojtëse (shikoni *Paketën e mjeteve* faqja 73) për elementet ndërtimore, fragmentet dhe objektet e ekspozuara.



- **Evakuimin pas ngjarjes** i objekteve të trashëgimisë kulturore në një vend tjetër depozitimi të përkohshëm dhe më të sigurt.
- **Shpëtimin** e koleksioneve të dëmtuara të trashëgimisë kulturore, fragmenteve të ndërtesave dhe të dekoracioneve. Ky veprim përfshin klasifikimin, stabilizimin nëpërmjet pastrimit të sipërfaqes dhe / ose tharjes së objekteve.
- Sigurimin i një **magazine të përkohshme dhe të sigurt** për materialet e trashëgimisë kulturore të evakuuara dhe të shpëtuara.
- **Tharjen** e ndërtesës ose të strukturës pas një përmytjeje.
- **Pajandimin** e një muri ose të një elementi tjetër strukturor mbajtës, në mënyrë që të sigurohet mbështetje e përkohshme.



Veprimet e sigurimit dhe të stabilizimit për trashëgiminë jomateriale janë të ndryshme nga ato të përmendura më sipër. Për trashëgiminë jomateriale, pas një katastrofe ose konflikti, konsiderohet më i rëndësishëm vazhdimi i traditës së rrezikuar ose i kalimit të sistemit të dijës dhe njohurive. Për më shumë hollësi, referojuni seksionit për sigurimin e trashëgimisë jomateriale.

Kush mund të ndërmarrë veprime të sigurimit dhe stabilizimit?

Operatorët e ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore, të cilët janë të trajnuar, si dhe specialistë të kualifikuar të trashëgimisë kulturore që kanë përvojë paraprake në vënien në



*Paqeruajtësit e OKB-së duke ndihmuar në një operacion shpëtimi në Qendrën e Artit në Haiti, 2010.
Foto: ICCROM.*

siguri të trashëgimisë kulturore në situata emergjente, mund të identifikojnë, të japin përparësi dhe të ndihmojnë në zbatimin e veprimeve të sigurimit dhe stabilizimit. Ky grup profesionistësh përfshin: restauratorë, arkeologë, kuratorë, arkivistë, inxhinierë konstruktorë, arkitektë restauratorë, antropologë dhe specialistë të trashëgimisë jomateriale.

Personeli ushtarak, zjarrfikësit dhe ekipet e kërkim-shpëtimit shpesh trajnohen për të kryer stabilizimin emergjent të strukturave. Sidoqoftë, atyre mund t'u mungojë koncepti i trajtimit të strukturave historike dhe mekanizmave të tyre specifike të kolapsit, kështu që, kudo që është e mundur, ata duhet të kërkojnë këshillat e një inxhinieri konstruktor dhe të një arkitekti restaurator. Edhe reaguesit e emergjencave gjithashtu mund të lehtësojnë dhe të ndihmojnë operacionet e evakuimit dhe të shpëtimit pas ngjarjes. Në situata kur hyrje-daljet janë të kufizuara ose strukturat janë të pasigurta, personeli ushtarak ose zjarrfikësit mund të ndihmojnë në shpëtimin e objekteve duke përdorur pajisje të specializuara.

Gjatë operacioneve në shkallë të gjerë, vullnetarët dhe anëtarët e komuniteteve vendase duhet të përfshihen në mënyrë aktive dhe të trajnohen në vend për të kryer veprime të mbikëqyrura specifike të sigurimit dhe të stabilizimit. Veprime të tilla mund të përfshijnë dokumentimin, transportimin e objekteve, klasifikimin e rrënojave, përgatitjen e **pajandave** dhe hartimin e inventarëve.

Çdo emergjencë është e ndryshme dhe kërkon reagim në përputhje me situatën.

Prandaj është thelbësore që edhe vullnetarët e trajnuar të marrin disa udhëzime për të zbatuar veprime të caktuara. Sidoqoftë, për të siguruar ndihmën e parë në kohën e duhur dhe në mënyrë të qëndrueshme, është thelbësore që profesionistët e trashëgimisë kulturore, reaguesit e emergjencave dhe vullnetarët të trajnohen para se të ndodhë një fatkeqësi.





Trajnimi mbi ndihmën e parë ndaj trashëgimisë kulturore në Mesdhe: projekti PROMEDHE

PROMEDHE (Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore Mesdhetare gjatë Fatkeqësive) është një nismë me shumë partnerë e Departamentit Italian të Mbrojtjes Civile, e cila financohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit Evropian për Mbrojtjen Civile dhe Ndhmën Humanitare ("DG ECHO"). Në kuadër të kësaj nisme, ICCROM-i u ftua të trajnojë ekipe të kombinuara me pjesëmarrjen e profesionistëve të sistemit të mbrojtjes civile, sigurisë civile dhe trashëgimisë kulturore nga pesë vende të rajonit të Mesdheut. Objektivat lidheshin me zhvillimin e kapaciteteve dhe të procedurave standarde operuese për ndihmën e parë ndaj trashëgimisë kulturore pas fatkeqësive natyrore. Si rezultat i trajnimit, vendet pjesëmarrëse kanë vazhduar të zhvillojnë në nivel kombëtar seminare për të trajnuar profesionistë të mbrojtjes civile, profesionistë të trashëgimisë kulturore dhe vullnetarë të tjerë, duke rritur kapacitetet e tyre përkatëse kombëtare për zbatimin e ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore në një shkallë të gjerë.

Shikoni referencat në faqen 165.



Città Castello, Itali, 2017. Foto: PROMEDHE dhe ICCROM.

Si të zbatoni veprimet e sigurimit (vënies në siguri) dhe të stabilizimit për trashëgiminë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme?

Veprimet për sigurimin (vënien në siguri) dhe ato të stabilizimit për trashëgiminë kulturore, varen nga konteksti dhe ndryshojnë në përputhje me rrethanat. Sidoqoftë, veprimet e mëposhtme mund të ndihmojnë në zbatimin e duhur të masave të posaçme, pavarësisht nga lloji i trashëgimisë së prekur dhe nga natyra e emergjencës.

Siguroni vendin / sitin

Para se të ndërhyri për stabilizimin e trashëgimisë së luajtshme dhe të paluajtshme në një sit, duhet të siguroheni që vendi të jetë i sigurt dhe i qasshëm. I gjithë personeli duhet të jetë i informuar për risqet dhe me pajisjet e duhura mbrojtëse personale (shihni *Paketën e mjeteve*, faqja 10). Hapat e mëposhtëm do të ndihmojnë për të siguruar që siti të jetë i parrezikshëm dhe i sigurt për të filluar punën:

- 1 Ngrini rrethime / gardhe / pengesa sigurie.** Pasi të ketë përfunduar vlerësimi në vend i dëmeve dhe risqeve, rrethojini të gjitha zonat që konsiderohen si të pasigurta, rreth sitit ose koleksionit të prekur.



Rrethimet me gardh dhe shiritët e kujdesit ndihmojnë për të paralajmëruar njerëzit dhe për të siguruar një kishë të dëmtuar rëndë në Filipine, 2013. Foto: Aparna Tandon, ICCROM.



Nëse dyshohet për rrezik shembjeje të një elementi strukturor, elementi të palidhur ose konsol, krijoni një zonë mbrojtëse rrethore rreth elementit, duke siguruar që rrezja e zonës të jetë e barabartë me lartësinë e elementit në fjalë.

- 2 Kontrolloni shërbimet komunale.** Aty ku është e mundur kontrolloni nëse pajisjet e gazit, të energjisë elektrike dhe të ujit mund të përdoren në mënyrë të sigurt.
- 3 Vendosni tabela sinjalistike.** Vendosni sinjalistikën e duhur përreth zonave të rrethuara. Sinjalistika duhet të jetë e përmasave të mëdha, që të duket qartë dhe të lexohet lehtë nga i gjithë personeli.
- 4 Siguroni rrugët e hyrjes.** Identifikoni shtigje dhe rrugë hyrëse dhe shënojin ato qartë në hartën e sitit dhe në planimetri (nëse ka). Nëse hyrje-daljet janë të sigurta, pastroni mbetjet e shkatërrimit nga shtegu për të përmirësuar qasjen. Këtu mund të përfshihet heqja e elementeve të paqëndrueshme, të palidhura, ose konsol, elementeve jostrukturore, si rrasa / tjegulla për mbulimin e çatave, oxhaqe dhe panele druri ose sigurimi i dyshemesë nëse ekzistojnë çarje të mëdha.



Para se të çmontoni elementet ose fragmentet e paqëndrueshme e të palidhura nga një strukturë historike, sigurohuni që të dokumentoni pozicionin dhe llojin e tyre, si dhe nivelin e dëmit të shkaktuar. Bëni fotografi (një pamje nga afër dhe një pamje nga larg) dhe regjistroni vendndodhjen e elementeve ose të fragmenteve në një hartë të sitit / katit. Nëse keni dyshime në lidhje me çmontimin e elementeve strukturale, konsultohuni me një inxhinier konstruktor se si të bëhet në mënyrë të sigurt.

- 5 Siguroni një mbulesë të përkohshme mbrojtëse.** Në rastin e një shembjeje strukturale, si strukturat e ekspozuara, ashtu edhe objektet e trashëgimisë kulturore të bllokuara duhet të pajisen me një mbulesë të përkohshme mbrojtëse, derisa të ndërmerren veprime të mëtejshme. Shihni si të siguroni mbulesë mbrojtëse të përkohshme në *Paketën e mjeteve*, faqja 73.
- 6** Nëse lihen të ekspozuara, llaçrat dhe materialet kulturore organike, mund të degradojnë shpejt. Mbulimi i një grumbulli objektesh të ekspozuara të trashëgimisë kulturore është një masë vetëm e përkohshme që nuk duhet të zgjasë më shumë se disa ditë.

- 7 Hiqni mbeturinat e rrezikshme.** Pas një fatkeqësie natyrore ose një ngjarjeje të shkaktuar nga një konflikt, sitet e trashëgimisë kulturore mund të përmbajnë materiale dhe mbetje të rrezikshme: për shembull, eksplozivë, kimikate, naftë, tuba PVC-je, lëndë izoluese ose materiale izoluese ndaj zjarrit. Në raste të tilla, identifikoni dhe konsultohuni me agjencinë e specializuar përgjegjëse për asgjësimin e sigurt të materialit të gjetur, para se të ndërmerrni ndonjë veprim tjetër në vend.



Si ta bëni të sigurt një sit të përmytur

Në rast përmytjeje, vlerësimi në vend i dëmit dhe riskut duhet të përfshijë konsultime me ekspertët përkatës për klasifikimin e ujërave të përmytura në lidhje me furnizimin me ujë të pijshëm – për shembull, a është në kategorinë “i pastër” (i sigurt për t’u pirë), në kategorinë “gri” apo në kategorinë “i zi”? Kur ujrata klasifikohen si “gri” ose “të zeza”, rreziku i ndotjes biologjike është i lartë, pasi mund të përmbajnë kimikate dhe / ose ujëra të zeza. Në raste të tilla është e rëndësishme të dezinfektoni vendin në konsultim me ekspertët dhe të izoloni materialet historike të ndotura duke i vendosur ato në kuti të mbyllura ose qese plastike.

[Shikoni referencat në faqen 162.](#)

- 8 Sigurohuni që strukturat dhe sipërfaqet e lagura të jenë tharë plotësisht.**

Në rast se një ndërtesë, strukturë ose sipërfaqe e zbukuar pëson dëmtime të konsiderueshme nga uji, është e rëndësishme që të thahet, për të parandaluar:

- shtrembërimin, shformimin dhe kalbjen e elementeve prej druri;
- plasaritjet në shtresën e suvatimit;
- praninë e mykut;
- Njolloshjen / çngjyrosjen;
- efloreshencën ose kristalizimin e kripërave në sipërfaqe.

Është thelbësore që procesi i tharjes në strukturat e vjetra të mos kryhet shumë shpejt. Ndryshimet e shpejta të niveleve të



lagështisë mund t'i dëmtojnë elementet e holla prej druri, duke rritur rrezikun e zhvendosjes kapilare të kripërave në muraturë, apo duke shkaktuar plasaritje në shtresat e suvasë. Në mënyrë që të thahen strukturat dhe sipërfaqet e lagura:

- Kontrolloni dhe pastroni tubacionet nga bllokimet, për të nxjerrë ujin. Hiqni mbetjet e shkatërrimit nga sipërfaqet e pjerrëta që mund të parandalojnë kullimin e ujrave.
- Përdorni kova dhe pompa për të hequr ujin e bllokuar.



Dëmtime serioze ka më shumë gjasa të ketë në objektet ku ka pasur rrjedhje të shpejta uji (për shembull, në kodra ose pranë një dige të dëmtuar), ku niveli i ujit brenda objektit është (ose ishte) në lartësi mbi 1 m, ose nëse muret mbajtëse janë ndërtuar prej balte ose qerpiçi. Në këto raste, kërkoni ndihmën e një inxhinieri konstruktor për të vlerësuar dëmtimin strukturor ose nevojën për ndërhyrje stabilizuese para se të nxirni ujin me pompë.

- Pastroni llumin dhe mbeturinat, pasi ato mbajnë të bllokuar lagështinë dhe ngadalësojnë procesin e tharjes. Mos prisni që balta dhe mbeturinat të thahen. Balta hiqet më lehtë dhe në mënyrë më të sigurt kur është e lagur.
 - Shmangni përdorimin e solucionëve pastruese, të cilat mbajnë të bllokuar lagështinë ose pengojnë lëvizjen e saj brenda materialeve historike.
 - Hiqni qilimat e lagur dhe mbulesat e dyshemesë / murit.
 - Zhvendosini mobiliet larg mureve dhe hiqni sendet e varura në mure, për të përshpejtuar procesin e tharjes. Referojuni **evakuimit pas ngjarjes** në faqen 80.
 - Nëse është e mundur, hiqni elementet metalike që janë në kontakt me suva të lagura, për të shmangur njolllosjen dhe ndryshkjen.
 - Sigurohuni që hapjet që ju nevojiten për tharjen e objektit të mos jenë në asnjë mënyrë të bllokuara. Për më shumë informacion referojuni *Paketës së Mjeteve*, faqja 92.
- 9 Përcaktoni** dhe krijoni hapësira pune dhe hapësira për ruajtjen e përkohshme të objekteve të trashëgimisë kulturore, fragmenteve dhe elementeve dekorative.

Veprime të tjera për sigurimin (vënien në siguri) dhe stabilizimin

Me ndihmën e ekipit tuaj, grumbulloni mjetet e nevojshme dhe merrni masa të tjera të sigurimit (vënies në siguri) dhe stabilizimit të përcaktuara paraprakisht. Këto mund të përfshijnë:

- Evakuimin pas ngjarjes
- Shpëtimin
- Stabilizimin emergjent të strukturave historike

Shihni seksionet vijuese për përshkrime të hollësishme të secilës prej këtyre masave.

Në një sit të prekur të trashëgimisë kulturore ndoshta do t'ju duhet të zbatoni shumë prej masave të sigurimit (vënies në siguri) dhe stabilizimit.

Evakuimi pas ngjarjes

Evakuimet pas ngjarjes bëhen të nevojshme kur një ndërtesë ose strukturë, që ka në ruajtje objekte të trashëgimisë kulturore, shpallet e pasigurt për përdorim / e pabanueshme, por bëhet mjaftueshmërisht e qëndrueshme për të lejuar evakuimin e objekteve. Evakuimi përfshin **dokumentimin, paketimin dhe transportimin** e objekteve në një vend të sigurt të përkohshëm.

Evakuimet pas ngjarjes mund të kërkojnë asistencë teknike nga forcat zjarrfikëse dhe / ose personeli ushtarak ose ai i mbrojtjes civile, pasi ata janë të trajnuar për të evakuuar njerëzit nga ndërtesat e pasigurta. Sidoqoftë, ata kanë nevojë për udhëzime se çfarë duhet evakuuar, nga ku, si dhe udhëzime për trajtimin në mënyrë të sigurt të objekteve të trashëgimisë.





Mësime nga evakuimi pas ngjarjes i Muzeut të Pallatit Hanuman Dhoka, Nepal

Pas tërmetit në vitin 2015 në Kathmandu, Nepal, pjesë të Pallatit Hanuman Dhoka, në të cilin ndodhej një muze, u shpallën të pasigurta për përdorim / të pabanueshme, për shkak të dëmtimeve të mëdha strukturore. Stafi i muzeut i kërkoi ndihmë ushtrisë nepaleze për të evakuuar Fronin e Artë dhe objekte të tjera të rëndësishme. Në kohën e evakuimit nuk kishte në dispozicion asnjë inventar për të treguar vendndodhjen e secilit objekt. Si rezultat, personelit të ushtrisë iu desh të kalonte më shumë kohë nga ç'ishte parashikuar për të gjetur objektet që kishin rëndësi të madhe. Gjatë evakuimit ata hasën vështirësi në manovrimin dhe në nxjerrjen e Fronit të Artë përmes derës së katit të sipërm të ndërtesës. Si pasojë, disa pjesë të frontit duhej të çmontoheshin, para se ai të zhvendosej nga ndërtesa.



Personeli i ushtrisë nepaleze duke evakuuar një objekt nga muzeu.

Foto: Aparna Tandon, ICCROM.

Drejtori i Muzeut dhe Nëpunësi i Dokumentacionit ishin në vend për të ndihmuar dhe për të marrë zyrtarisht kujdestarinë e objekteve të evakuuara. Pasi u evakuuan nga ndërtesa, Froni i Artë dhe objektet e tjera u mbajtën në oborrin e Pallatit, derisa u gjet një vend më i sigurt disa ditë më vonë. Ushtria vuri në dispozicion personel me turne për të siguruar mbrojtjen e tyre gjatë gjithë kohës.





Mësimet kryesore që duhet të nxirren nga kjo përvojë:

- Që të jemi sa më të mirëpërgatitur për një evakuim pas ngjarjes, operatorët e ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore duhet të pajisen me kopje të shumta të planimetrive, të cilat tregojnë qartë vendet dhe dimensionet e objekteve më të rëndësishme. Sidoqoftë, për të garantuar sigurinë e objekteve, këto plane duhet të qëndrojnë konfidenciale për ata që nuk janë zakonisht pjesë e grupit të reaguesve të ndihmës së parë.
- Evakuimi i objekteve të trashëgimisë kulturore duhet të bëhet vetëm nëse është identifikuar një vend i përkohshëm më i sigurt dhe nëse ekziston logjistika e nevojshme për operacione të tilla.
- Për reaguesit e emergjencave dhe profesionistët e trashëgimisë që kanë në ngarkim një koleksion është i domosdoshëm trajnimi paraprak për mënyrën se si do trajtohen, paketohen, dokumentohen dhe transportohen objektet gjatë një gjendjeje emergjence.

Shikoni referencat në faqen 167.



Si të kryeni një evakuim pas ngjarjes?

Rendi i mëposhtëm i punës për evakuimin pas ngjarjes bazohet në Udhëzuesin për evakuimin emergjent para ngjarjes, **Trashëgimi e Rrezikuar: Evakuimi Emergjent i Koleksioneve të Trashëgimisë**. Mos harroni se vendimi për evakuimin e objekteve nga një vend i pasigurt duhet të merret bazuar në vlerësimin në vend të dëmit dhe riskut pas ngjarjes.





Leja / Autorizimi

Para se të ndërmerrni evakuimin e pasurive kulturore, siguroni lejet / autorizimet nga administratorët dhe sigurohuni që ata ose anëtarët e stafit, të jenë të pranishëm në vend për të dhënë këshilla dhe për të mbikëqyrur të gjithë operacionin.



Dokumentimi. Kërkoni një dokument zyrtar të lejes, ku thuhet se administratori ka autorizuar për numrin 'x' të operatorëve të ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore për të evakuuar numrin 'y' të objekteve dhe transportimin e tyre në një vend tjetër të sigurt (specifikoni emrin e saktë të vendit dhe gjeo-koordinatat). Ky dokument duhet të ketë nënshkrimin e administratorit, së bashku me detaje të tjera të rëndësishme, siç janë data, koha dhe vendi.



Përgatitja

1 Mblidhni një ekip për evakuim. Ai duhet të përfshijë të gjithë anëtarët e stafit që kanë drejtpërdrejt në ngarkim koleksionin që do të evakuohet. Zgjidhni një drejtues ekipi, i cili mund të shpjegojë fushën dhe qëllimet e operacionit dhe t'u caktojë detyrat specifike anëtarëve të ekipit. Këto detyra përfshijnë:

- dokumentimin;
- trajtimin dhe paketimin;
- transportin e objekteve;
- përgatitjen e një hapësire të përkohshme magazinimi;
- logjistikën si furnizimet, ushqimi, uji etj.;
- komunikimin brenda ekipit, me aktorët e jashtëm dhe grupet e interesit.

2 Duke përdorur rezultatet nga **vlërësimi në vend i dëmit dhe risikut**, identifikoni dhe përgatitni:

- a. një **shteg të sigurt evakuimi** për transportimin e objekteve brenda dhe jashtë ndërtesës së prekur.
- b. një **mjedis për klasifikimin dhe paketimin** ose një dhomë që ka hapësirë të mjaftueshme për të paktën dy vende pune për proceset e klasifikimit, dokumentimit dhe paketimit të objekteve.
- c. një **vend të sigurt për ruajtjen** e përkohshme të objekteve, brenda ose jashtë sitit.



Kur zgjidhni një hapësirë të sigurt për magazinim, sigurohuni që:

- të jetë mjaft e madhe për të ruajtur numrin e objekteve që duhet të zhvendosen;
- të jetë e pastër dhe mos ketë prani të dëmtuesve si brejtës, insekte ose myk;
- të jetë e ajrosur mirë dhe mos ketë lagështi;
- të jetë e siguruar nga vjedhjet dhe vandalizmat;
- të jetë e arritshme / të ketë rrugë kalimi të lirë, duke lejuar transportin e sigurt të objekteve;
- nëse është e nevojshme, objektet mund të lihen në hapësirën e magazinimit për një periudhë të pacaktuar



3 Mbledhja e informacionit dhe dokumentimi

- a. Kur t'ju jepet mundësia, siguroni listën e objekteve që do të evakuohen me përparësi. Në rast të kundërt, kërkoni nga ekipi i dokumentacionit të konsultohet me regjistrat e mëparshëm, në mënyrë që të përgatisë një listë të objekteve, bazuar në vlerat, pikat e dobëta dhe lehtësinë që paraqesin për t'u trajtuar ose transportuar. Në rast se nuk ka ndonjë listë të tillë, këshillohuni me administratorët ose anëtarët e stafit për të përgatitur një listë të objekteve sipas përparësisë. *Shikoni Paketën e mjeteve, faqja 55.*
- b. Siguroni kopje të planimetrive të kateve të ndërtesës nga e cila do të evakuohen objektet. Identifikoni dhe shënoni në këto planimetri vendet fizike të objekteve që do të evakuohen, duke përdorur kodet ekzistuese të vendndodhjes. Nëse nuk ekzistojnë kode të tilla ose nuk përputhen, ekipi i dokumentacionit duhet të caktojë kode të reja të vendndodhjes, të cilat janë të qëndrueshme dhe të lehta për t'u kuptuar. Shikoni në faqen 42 të *Paketës së mjeteve* se si të krijoni kodet e vendndodhjeve.
- c. Nëse koha është e mjaftueshme, pasi të keni shënuar kodet e vendndodhjeve të objekteve në planimetritë e kateve, etiketoni mjediset dhe objektet me kodet përkatëse të vendndodhjes. Sigurohuni që etiketat të jenë të dukshme.

- d. Përgatitni një inventar për evakuimin. Në këtë proces mund të ndihmojë dokumentacioni i mëparshëm, nëse është i disponueshëm. Nëse nuk keni një inventar të parapërgatitur, mund ta krijoni një duke përdorur modelin e dhënë.

Numri rendor	Numri i mëparshëm	Numri i identifikimit	Lloji objekti	Materiali	Dimensionet, gjatësi, gjerësi, lartësi	Pesha	Kodi i vendndodhjes filestare	Fotografi apo numri i referencës ne plan	Vendndodhja e re	Fotografi apo numri i referencës ne plan
<p>Tregohet numri i objekteve të evakuuara, në rend numerik progresiv, duke filluar nga 1 deri te objekti i fundit</p> <p>Kjo fushë përdoret për të shënuar numrin unik të identifikimit me të cilin është pajisur objekti për qëllimin e evakuimit</p> <p>Përdoret për të përshkruar shkurtimisht objektin, p.sh. dorëshkrim i ilustruar, skulpturë, vazë, etj.</p> <p>Përbërja e objektit, p.sh. qeramike, metal, tekstil, etj.</p> <p>Vendosni kodin e vendndodhjes filestare të objektit.</p> <p>Kjo fushë duhet të plotësohet kur evakuimi të jetë përfunduar, dhe objektet të jenë vendosur në një mjedis të ri të sigurt.</p> <p>Të gjitha fotot dhe planimetritë duhet të kenë një numër referencë.</p> <p>Plotësohet pesha e objektit. Në mungesë të një peshëgjorie, të përdoren simbole si +, për të shënuar peshën. P.sh. një objekt që mund të mbahet e transportohet lehtësisht nga një person mund të shënohet ++; nëse nevojiten dy persona për ta ngritur, shënohet ++; nëse nevojiten pajisje të veçanta për ta lëvizur e transportuar, të përdoret +++.</p>										

- Grumbulloni mjete** për paketimin dhe për transportimin e koleksioneve. Për një listë të thjeshtë mjetesh shihni *Paketën e mjeteve* në faqen 67.
- Krijoni vende pune** për klasifikimin, dokumentimin dhe për paketimin e objekteve në zonën e sigurt të caktuar në vend (të identifikuar në vlerësimin në vend të dëmit dhe riskut).



Nxjerrja



Dokumentimi: përpara se të transportoni objekte në zonën e klasifikimit dhe paketimit, shënoni kodin e vendndodhjes së tyre në etiketën e vendosur në ambalazhin / kutinë e përdorur për të lëvizur objektin. Në rast se nuk mund të realizohet shënimi nga ekipi i transportit, një person nga ekipi i dokumentacionit mund të shoqërojë ekipin e transportit dhe të shënojë kodet e vendndodhjes në inventarin e hartuar për evakuimin.



Paketimi dhe Lëvizja

- Transportoni objektet në zonën e klasifikimit dhe paketimit; renditini objektet e nxjerra sipas llojit të materialit.
- a. Caktوني një **numër unik identifikimi** për çdo objekt. Ky numër është i ndryshëm nga kodi i vendndodhjes, pasi identifikon secilin objekt brenda një hapësire të caktuar. Emërtoni objektet në rend numerik progresiv ose përdorni një kombinim të shkronjave dhe të numrave.



Si të krijoni një numër unik identifikimi

Para se të lëvizni një objekt në një vend tjetër, emërtojeni me një numër unik identifikimi, në mënyrë që të mund të gjurmoni lëvizjen e tij gjatë operacionit të evakuimit. Sigurohuni që sistemi i numërimit i zhvilluar për qëllime evakuimi të jetë i thjeshtë, i unifikuar dhe i kuptueshëm nga të gjithë personat e përfshirë. Mund të jenë thjesht numra në rend progresiv (p.sh., 01, 02) ose një kombinim i shkronjave dhe i numrave (p.sh., A001, A002). Për informacione të mëtejshme, shihni *Paketën e mjeteve*, faqja 43.

- b. Vendosni një etiketë që tregon si kodin e vendndodhjes, ashtu edhe numrin unik të identifikimit në ambalazhin dytësor, d.m.th, në pjesën e kartonit, shportën ose kutinë e përdorur për të transportuar objektin.
 - c. Plotësoni **inventarin e evakuimit** dhe regjistroni çdo **numër hyrës** (nëse gjendet në objekt), materialin, madhësinë, peshën dhe çdo kriter tjetër të dokumentacionit.
- 2** Transportoni objektet, bashkë me etiketat e tyre të bashkëngjitura në ambalazhin dytësor, në hapësirën e përgatitur të punës, dhe paketojini ato (shihni *Paketën e mjeteve*, faqja 49). Sigurohuni që një kopje e **inventarit të përfunduar të evakuimit** të shoqërojë objektet e paketuara.



Muzeu Kombëtar Nepal, Katmandu, Nepal, 2016. Foto: Aparna Tandon, ICCROM.

- 3** Gjatë paketimit të objekteve, sigurohuni që etiketat me numrat unikë të identifikimit dhe kodet e vendndodhjes të qëndrojnë të fiksuara. Këto etiketa duhet gjithashtu të vendosen edhe te paketimet. Për më shumë informacion, referojuni udhëzimeve për paketimin e objekteve në *Paketën e mjeteve*, faqja numër 48.



*Paketimi i objekteve në Muzeun Kombëtar në Nepal, Kathmandu, Nepal, 2016.
Foto: Aparna Tandon, ICCROM.*

- 4 Sigurohuni që të paktën një anëtar i ekipit të dokumentacionit të ndjekë vendosjen e objekteve në kutitë e tyre duke plotësuar një **formular për gjurmimin e lëvizjes**. Ky formular përdoret për t'u siguruar që të gjitha objektet kanë mbërritur në vendin e ri të përkohshëm të ruajtjes. Përgatitni shumë kopje të formularit të gjurmimit të lëvizjes (shihni shembullin më poshtë).

Formulari i gjurmimit të lëvizjes

Numri hyrës	Numri i kutisë	Numri total i artikujve në kuti	Udhëzime për trajtimin e objekteve / transportimin	Dërguar nga:	Data e dërgimit:	Korrier / numri i makines:	Data e mbërritjes:	Numri i kutisë	Numri total i artikujve në kuti	Marrë nga:
1	12	20		Kurator Abdel Hamid	25 Janar	xxx256	25 Janar	12	20	xxx magazinin
...

- 5 Kur të gjitha objektet të jenë të paketuara, ato mund të transportohen në vendin e ri. Paketimi duhet të përfshijë kopjet e inventarit të evakuimit dhe formularin e gjurmimit të lëvizjes.



Zhvendosja

Ndërsa një pjesë e ekipit është e angazhuar me proceset e rikuperimit, të dokumentimit dhe të paketimit të objekteve, të tjerët mund të përqendrohen në përgatitjen e hapësirës së përkohshme të magazinimit.

- 1 Filloni të mendoni për sistemimin sa më të mirë të objekteve në hapësirën e re të magazinimit.
- 2 Caktoni kodet e zhvendosjes: lëvizni sipas rastit mobilet që ndodhen aty dhe caktoni kode të vendndodhjeve në dollapë dhe rafta për të piketuar vendet e reja të objekteve. Sigurohuni që kjo të bëhet para mbërritjes së objekteve. Për më shumë informacion referojuni përgatitjes së kodeve të zhvendosjes në hapësirën e përkohshme të magazinimit në *Paketën e mjeteve*, faqja 41.



Magazini i përkohshëm në Italinë qendrore, 2017. Foto: Aparna Tandon, ICCROM.

- 3 Mund të mos jetë e mundur që gjatë një evakuimi emergjent të blini pajisje magazinimi të përshtatshme për ruajtjen e objekteve, siç janë njësitë e rafteve. Në këtë rast, objektet duhet të mbahen në dysheme brenda paketimit të tyre. Përdorni paleta dhe / ose mushama për të shmangur kontaktin e drejtpërdrejtë midis kontejnerëve të magazinimit dhe dyshemesë. Nëse jeni duke përdorur paleta druri, kontrolloni që të mos kenë prani insektesh apo myku.

- 4 Pranojini zyrtarisht objektet në magazinën e re të përkohshme duke përdorur si dokumentacion mbështetës formularin e gjurmimit të lëvizjes. Pastaj, kontrolloni inventarin shoqërues të evakuimit dhe ndajini objektet sipas llojit dhe madhësisë së materialit.

Vendosini objektet e paketuara në rafte ose pastroni paletat dhe mobiliet e tjera të disponueshme. Mundohuni t'i mbani objektet e brishta larg tokës dhe t'i vendosni në skajin e largët të mjedisit, që të mos jenë lehtësisht të arritshme. Po kështu, sendet e mëdha ose të rënda duhet të vendosen së bashku në një skaj të dhomës, në mënyrë që të pastrohet hapësira për lëvizjen dhe organizimin e objekteve më të vogla.

- 5 Me qëllim dokumentimin e pozicionit fizik të secilit objekt në magazinën e re të përkohshme, shënoni numrin e kutisë / ambalazhit, si dhe numrin e raftit në fushën 'vendndodhja e re' të formularit të inventarit.
- 6 Merrni masat e duhura të sigurisë në hapësirën e re të magazinimit të përkohshëm për të parandaluar vjedhjet dhe vandalizmat. Nëse është e nevojshme, siguronit roje.



Në zonat me konflikt të pranishëm është e rëndësishme të monitorohet vazhdimisht situata e sigurisë, në mënyrë që, nëse është e nevojshme, të ketë kohë të mjaftueshme për të zhvendosur objektet në një vend tjetër.



Raportimi

Jepini përgjegjësve të objekteve inventarin e përditësuar, të plotësuar me vendndodhjet e reja të objekteve, së bashku me një raport përmbledhës të të gjithë operacionit të evakuimit. Ky raport duhet të përmbajë: fotografi që dokumentojnë hapat kryesorë të operacionit; detajet e materialeve të përdorura për paketimin e objekteve; informacion në lidhje me kostot e shpenzuara; dhe të dhëna kontakti të ekipit të përfshirë në evakuim. Raporti duhet të firmoset nga udhëheqësi i ekipit, në cilësinë e mbikëqyrësit të operacionit.



Monitorimi

Përcaktoni një regjim për pastrimin dhe monitorimin e hapësirës së re të magazinimit të përkohshëm, në mënyrë që të parandaloni praninë e insekteve / brejtësve, zjarrin, ujin dhe çdo agjent tjetër që mund të shkaktojë dëmtime të objekteve.



Shpëtimi

Pasi të ketë përfunduar evakuimi pas ngjarjes, trashëgimia kulturore e dëmtuar duhet të stabilizohet. Shpëtimi lidhet me rikuperimin sistematik të objekteve të dëmtuara të trashëgimisë kulturore, fragmenteve të ndërtesave dhe elementeve dekorative të evakuara nga një monument i prekur negativisht nga një situatë e rrezikshme.

Shpëtimi i trashëgimisë kulturore të luajtshme përfshin një proces evakuimi të ngjashëm me rendin e punës për evakuimin pas ngjarjes, ku mund të përfshihen veprime shtesë për përzgjedhjen dhe për stabilizimin e materialit të trashëgimisë kulturore. Ky proces është projektuar për të parandaluar dëmtimet e mëtejshme, derisa të mund të ndërmerren ndërhyrje më profesionale. Në rast të shembjes së pjesshme ose tërësore të një strukture historike, shpëtimi do të përfshijë gjithashtu edhe klasifikimin e rrënojave për të rikuperuar elemente origjinale guri, tulle ose druri, që do të përdoren për procesin e ardhshëm të **rindërtimit**.

Në varësi të emergjencës, mund të jetë e nevojshme të ndërmerrni në të njëjtën kohë evakuimin dhe shpëtimin; ose mund të zbuloni se asgjë nuk është dëmtuar në një monument të rrezikuar dhe evakuimi pas ngjarjes do të kërkohet për të dezinfektuar monumentin.



Port-au-Prince, Haiti, 2010. Foto: Aparna Tandon, ICCROM.



Shpëtimi i një arkivi historik të përmbytur: Kili

Në qershor të vitit 2016, reshjet e dendura të shiut shkaktuan përmbytje të mëdha në pjesë të shumta të Talca-s, një qytet 250 km në jug të Santiagos. Dalja jashtë përdorimit e sistemit të drenazhit çoi në përmbytjen e një qendre dokumentacioni në bodrumin e një ndërtese në Universitetin e Talca-s, i cili strehonte një koleksion të rëndësishëm të dorëshkrimeve të vjetra dhe pentagrame origjinale muzikore. Uji u ngrit në një lartësi prej 50cm përpara se të pushonte shiu. Të gjithë librat dhe dorëshkrimet e vendosura në raftet e poshtme dhe ato që ishin ruajtur në kutitë në dyshe, u lagën me ujë, duke përfshirë gjithsej rreth 5000 libra dhe dorëshkrime.

Uji u largua nga bodrumi me anë të pompave dhe dyshemetë u thanë sa më shpejt që ishte e mundur, para instalimit të ventilatorëve dhe dehidratuesve. Për shkak të vëllimit të madh të objekteve të prekura, u mor vendimi për ngrirjen e tyre, derisa të thaheshin në mënyrën e duhur. Objektet u klasifikuan sipas shkallës së lagështisë të marrë nga uji dhe u sistemuan në mënyrë të tillë që të thaheshin ose të ngriheshin.

U morën hua kamionë frigoriferikë dhe ngrirës nga një kompani e eksportit të frutave. Librat e lagur u ndanë me kujdes dhe u vendosën në qese plastike individuale për t'i përgatitur për ngrirje, përpara se t'i vendosnin në kuti magazinimi. Më pas librat u transportuan me kamionë në ambientet e ngrirjes, ku ishin ruajtur për dhjetë muaj në temperaturën -24 ° C.

Librat e ngrirë u hoqën nga ngrirësit pak nga pak dhe u shkrinë me kujdes. Përfundimisht, të gjithë librat dhe dorëshkrimet u shkrinë dhe u thanë. Si rezultat i planifikimit të fatkeqësisë dhe reagimit të shpejtë që pasoi, të gjitha objektet u rimëkëmbën me sukses.

Burimi: María Cecilia Rodríguez Moreno, Kuratori Kryesor, Laboratori i Letrës dhe Librave, Qendra Kombëtare për Konservimin dhe Restaurimin, Drejtoria e Bibliotekave, Arkivave dhe Muzeve, Kili.


Shikoni referencat në faqen 166.

*Ndarja e faqeve të librave të lagur,
Qendra Kombëtare për
Konservimin dhe Restaurimin,
Kili, 2016
Foto: Mariela Arriagada.*



Si të ndërmerret procesi i shpëtimit?

Rendi i punës për shpëtimin





Leja / Autorizimi

Konsultohuni me palët përkatëse përgjegjëse dhe siguroni **lejen** (mundësisht në formë të shkruar) për operacionin e shpëtimit dhe për zhvendosjen e objekteve të shpëtuara në një vend të përkohshëm më të sigurt, brenda ose jashtë vendndodhjes.



Përgatitja

- 1 Informoni ekipin:** mblidhni ekipin që do të përfshihet në operacionin e shpëtimit dhe:
 - sigurohuni që të gjithë anëtarët e ekipit të kuptojnë se cilat janë zonat me kalim të kufizuar ku nuk lejohet hyrja;
 - shpjegoni rendin e punës së operacionit të shpëtimit;
 - zgjidhni një drejtues grupi, i cili do të mbikëqyrë të gjithë operacionin e shpëtimit.

Ndajini njerëzit në nënekipe dhe caktoni rolet sipas nivelit të ekspertizës dhe interesit për detyrat gjatë operacionit të shpëtimit. Detyrat përfshijnë **dokumentacionin, rimëkëmbjen e objekteve, klasifikimin sipas përparësisë, stabilizimin, paketimin, transportin, logjistikën dhe komunikimin**. Nëse nuk keni në dispozicion numrin e mjaftueshëm të njerëzve të trajnuar, merrni kohën e duhur për të trajnuar vullnetarë që të ndihmojnë me detyra që nuk kanë nevojë për njohuri të veçanta.

- 2 Grumbulloni pajisje** sipas llojit të objekteve që do të shpëtohen, llojit të dëmit të shkaktuar dhe natyrës së fatkeqësisë. Për shembull, nëse objektet e prekura janë të përbëra nga materiale organike dhe janë të lagura e të ndotura, do të duhen materiale si rrjeta poliesteri për trajtimin dhe tharjen. Përdorni përfundimet e vlerësimit në vend të dëmit dhe riskut për të zgjedhur pajisjet që do t'ju nevojiten. Për hartimin e listës së përgjithshme të pajisjeve të shpëtimit referojuni *Paketës së mjeteve* në faqen 70.
- 3 Përgatitni hapësirën:** përcaktoni një zonë për kryerjen e trajtimeve të stabilizimit dhe sigurohuni që çdo mjedis pune të ketë hapësirë të mjaftueshme për trajtimin e numrit të objekteve të prekura. Çdo mjedis pune duhet të përqendrohet në një lloj trajtimi. Për shembull, mos kryeni trajtime të pastrimit të objekteve të lagura dhe të pastrimit të objekteve të thata në të njëjtin mjedis pune, pasi do të rrezikoni të ndotni objektet e lagura me papastërti shtesë ose rrezikoni të lagni objektet e thata, duke shkaktuar më shumë dëme.





4 Dokumentoni: përgatitni një sistem për dokumentimin dhe gjurmimin e objekteve që do të rimëkëmben. Sistemi i dokumentimit duhet të përmbajë tre elemente kryesore:

- a. Një sistem për **regjistrimin e vendndodhjes** nga ku do të rimëkëmben objektet. Nëse keni një kopje të planimetrisë së objektit, përdoreni atë për të identifikuar hapësirat, duke përdorur sistemin e numërimit të dhënë në planimetri. Nëse sistemi i numërimit në planimetri është i paqartë, krijoni kodet të reja të vendndodhjes. Shihni se si të krijoni kodet e vendndodhjeve në *Paketën e mjeteve*, faqja 42.
- b. Nëse ndërtesa ose struktura është shembur pjesërisht ose plotësisht dhe objektet gjenden nën një shtresë rrënojash, krijoni një rrjet kuadratik për të piketuar vendndodhjen e objekteve. Rrjeti kuadratik mund të jetë i vogël ose i madh, në varësi të nevojës. Për zona të shumta mbetjesh të lokalizuara në vende të ndryshme brenda të njëjtit objekt, vendosni sa më shumë rrjete të nevojshme dhe caktoni numra unikë për secilin rrjet kuadratik. Më pas, vendosini në një hartë të vetme të objektit që tregon veriu. Në rastin e zonave të mëdha arkeologjike, ku operacioni i shpëtimit përfshin lokacione të shumta, rrjeti mund të hidhet në një hartë të lidhur me **Sistemin Gjeografik të Informacionit (GIS)**. Për më tepër informacion shikoni *Paketën e mjeteve*, faqja 11.
- c. **Një sistem për emërtimin sipas një sistemi numerik të objekteve** që janë rimëkëmbur (shikoni *Paketën e mjeteve*, faqja 43). Në mënyrë që të emërtoni dhe të gjurmoni objektet, krijoni një sistem për të caktuar një numër unik identifikimi për secilin objekt dhe pjesët e tij.
- d. **Një formular regjistrimi gjatë shpëtimit.** Ky formular përdoret për të regjistruar numrin e objekteve të rimëkëmbura dhe gjurmon lëvizjen e tyre gjatë gjithë operacionit të shpëtimit. Ai siguron gjithashtu informacione mbështetëse, si numri i fotografisë i secilit objekt, numri origjinal i inventarit dhe numri i referencës së planimetrisë. Formulari mund të ndahet në tri pjesë, të cilat mund të plotësohen gjatë tri fazave të ndryshme të operacionit të shpëtimit, përkatësisht: (i) nxjerrja (ii) **klasifikimi sipas përparësisë** dhe stabilizimi dhe (iii) paketimi dhe zhvendosja. Shihni faqen tjetër për shembuj.

1 NXJERRJA

Numri hyrës	Vendndodhja fillestare	Numër i caktuar identifikimi	Numra të mëparshëm



Në rend progresiv numerik, nga objekti i parë i lëvizur tek i fundit, tregohet numri i objekteve të shpëtuara.

Kjo fushë tregon numrin unik të identifikimit që i caktohet objektit .

2a KLASIFIKIMI SIPAS PËRPARËSISË DHE STABILIZIMI

Pronari/Institucioni	Kodi fillestar i vendndodhjes	Lloji i objektit	Materialet	Përmasat: gjatësia, gjerësia, lartësia

Kjo fushë tregon kodin original të vendndodhjes të objektit të shpëtuar. Kodi i vendndodhjes fillestare mund t'i referohet një numri rrjeti ose një kombinimi të numrave të raftit, ambientit dhe katit, në varësi të sistemit të miratuar për caktimin e kodeve të vendndodhjes.

Fusha 'Lloji i objektit' përdoret për të përshkruar shkurtimisht objektin.

Materialet përbërës të objektit p.sh., qelq, qeramikë, metal, tekstil etj.



2b KLASIFIKIMI SIPAS PËRPARËSISË DHE STABILIZIMI

Pesha	Numër referimi i fotografisë ose vizatimit	Lloji i dëmtimit	Trajtimi i dhënë (të plotësohet gjatë stabilizimit)	Trajtimi i stabilizimit i dhënë nga
-------	--	------------------	---	-------------------------------------

"Numër referimi i fotografisë ose vizatimit" i referohet fotografisë / vizatimit të objektit. Nëse nuk ka kohë të mjaftueshme për të bërë fotografi të objekteve individuale në vend, bëni fotografi të një grupi objekteve me numrat e tyre të identifikimit. Regjistroni numrin e fotos. Kjo fushë mund të plotësohet në fazën e klasifikimit sipas përparësisë ose në vendin e magazinimit të përkohshëm, në varësi të kohës në dispozicion.

"Lloji i dëmtimit" tregon shkurtimisht gjendjen fizike të objektit dhe llojin, si dhe shkallën e dëmit që ka pësuar.

Plotësoni peshën e objektit. Nëse nuk është e disponueshme një peshore, përdorni simbole, p.sh., përdorni + për të treguar që një person mund të lëvizë objektin, ++ për të treguar se duhen dy persona të lëvizin objektin, dhe +++për të treguar se duhen më shumë se një person dhe pajtje të specializuara për të lëvizur objektin.

Kjo fushë përshkruan llojin e trajtimit të stabilizimit që i është dhënë objektit. Për shembull, një objekt i lagur dhe i ndotur mund të duhet të shpëlahet përpara se të transferohet në magazinën e re të përkohshme. Trajtime të tilla duhet të jepen nga konservuesit dhe operatorët e ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore të trajnuar.

3 PAKETIMI DHE ZHVENDOSJA

Lëvizur nga	Data	Kodi i zhvendosjes

Kjo fushë tregon kodin e zhvendosjes për një objekt të caktuar pasi lëvizet për në hapësirën e re të magazinimit. Kjo fushë duhet të plotësohet pasi të gjitha objektet të jenë zhvendosur.



Nxjerrja

Gjatë shembjes së një strukture, fragmente të ndërtesave historike dhe objekte mund të mbeten nën struktura betoni dhe nën rrënoja të tjera të padëshiruara. Në raste të tilla, kontaktoni koordinatorin e përgjigjes emergjente ose drejtuesin e operacioneve për këshilla mbi zhvendosjen e tyre. Mund të keni nevojë për makineri të rënda, të tilla si eskavatorë. Kërkoni këshillat e drejtuesit të makinerive dhe ato të një inxhinieri konstruktor për t'u siguruar që veprime të tilla janë të sigurta.



Nxjerrja e kujdesshme dhe sistematike e objekteve nga një mjedis i ndotur kërkon aftësi dhe durim. Gjithmonë punoni në çift për të shmangur lëndimet personale dhe për të parandaluar dëmtimin e mundshëm të objekteve të trashëgimisë kulturore gjatë procesit të nxjerrjes.

Për të nxjerrë objekte nga një pjesë ndërtese ose rrjeti:

- Nxirni fillimisht objektet e vogla, të thata dhe të padëmtuara.
- Pajisuni me mbështetës të papërkulshëm (siç janë kartonat e rëndë ose dërrasat e sheshta) të gatshme për nxjerrjen dhe transportimin e objekteve të brishta dhe të dëmtuara.
- Sigurohuni që të jenë gjithmonë të paktën dy persona gjatë procesit të shpëtimit të objekteve të mëdha ose të rënda, si dhe sigurohuni që objekti është mbështetur në mënyrë të përshtatshme.
- Nëse një objekt është thyer, sigurohuni që të gjitha copat e thyera të mblidhen dhe të mbahen së bashku. Për lehtësi mbajtjeje vendoseni objektin dhe pjesët e tij të thyera në kuti, ose në qese plastike të pastër.
- Ruajini ambalazhet (kornizat, kutitë dhe pjesët mbështetëse) e objekteve të veçanta me objektet e tyre përkatëse.
- Në përputhje me formularin e dokumentimit të përzgjedhur, regjistroni numrin e vendndodhjes fillestare të objektit, caktojini një numër objektit dhe shkruani numrin e objekteve të nxjerra



Hiqini fragmentet nga rrjeti kuadratik me rradhë, kuadrat pas kuadrati, për të shmangur gabimet kur etiketoni vendndodhjen.





*Nxjerrja e objekteve në një operacion shpëtimi, në Port-au-Prince, Haiti, 2010.
Foto: Aparna Tandon, ICCROM.*



Nxjerrja e pjesëve dhe elementeve strukturore historike

Nxjerrja e strukturave historike të copëtuara, e sipërfaqeve dhe e veprave të artit “in situ”, mund të jetë një proces delikat që kërkon shumë kohë. Përdorni të dhënat e përfituara nga **vlerësimi në vend i dëmit dhe riskut** (shihni faqen 63) për përgatitjen e metodologjisë dhe të hapësirës tuaj të punës.

Para nxjerrjes së materialeve historike në vendngjarje, merrni parasysh sa vijon:

- Ilojet e mbetjeve dhe pjesët e materialeve që prisni të gjeni në vend.
- rëndësinë e materialeve origjinale të ndërtesës dhe elementeve dekorativë ose veprave të artit “in situ”.
- Cilat pjesë të materialit ndërtimor janë jothelbësore ose joautentike për strukturën origjinale ose trashëgiminë kulturore? Cilat nga mbetjet mund të ripërdoren ose duhet të zëvendësohen dhe cilat mund të hidhen?
- Çfarë trajtimesh **stabilizimi** u nevojiten fragmenteve përpara magazinimit të tyre?





Në rast se ju duhet të lëvizni pjesët historike, sigurohuni që të regjistroni vendndodhjen e tyre fillestare para se t'i zhvendosni. Dokumentimi ndihmon për të sqaruar pozicionin fillestar të elementeve strukturore ose të trashëgimisë "in situ", në mënyrë që të riintegrohen në strukturë gjatë restaurimit. Gjithashtu sigurohuni që pjesët të mos humbasin ose të vidhen gjatë lëvizjes. Krijoni një kod vendndodhjeje (shihni *Paketën e mjeteve*, në faqen 42), bazuar në rrjetin kuadratik nga i cili keni nxjerrë fragmentet dhe përfshini dokumentacion pamor aty ku është e mundur.

Pasi të keni nxjerrë pjesët, mund të ndiqni rendin e punës së shpëtimit të përdorur për objektet e trashëgimisë kulturore të luajtshme.



Klasifikimi sipas përparësisë

Vendosja e përparësive është me rëndësi jetike në operacionet e shpëtimit në shkallë të gjerë, në të cilat mijëra objekte duhet të nxirren dhe të kategorizohen për trajtim në një periudhë të shkurtër kohe. Kjo mund të bëhet në mënyrë më efektive përmes një sistemi të klasifikimit sipas përparësisë.

Klasifikimi sipas përparësisë i materialeve të trashëgimisë kulturore i referohet ndarjes së objekteve të nxjerra dhe dhënies së përparësisë për veprimet e stabilizimit, bazuar në tri kritere:

- shkalla e dëmtimit e trashëgimisë kulturore.
- risku për dëmtim të mëtejshëm, nëse nuk trajtohen.
- rëndësia ose vlerat e objektit ose strukturës.

Përcaktimi i vlerave të një objekti është i ndërlikuar. Në situata emergjente është më mirë që përcaktimi i vlerave të kryhet gjatë fazave të **analizës së situatës** (shihni faqen 30) dhe të **vlerësimit në vend të dëmit dhe riskut** (shihni faqen 42). Një vlerësim i tillë duhet të bazohet në të dhënat ekzistuese institucionale para ngjarjes, si për +shembull një inventar ose **regjistër themeltar i objekteve**. Përdorni *Paketën e Mjeteve*, faqja 55, për të mësuar se si të ndërmerri procesin e klasifikimit sipas përparësisë, kur vlerat e objektit janë të panjohura.



Kur klasifikoni materialin e trashëgimisë kulturore të nxjerrë, ndiqni hapat e renditur më poshtë:

- 1 Ndajini objektet e dëmtuara nga ato të padëmtuarat.** Gjithashtu, veçojini objektet e thata nga ato të lagurat. Hiqini objektet e mykura dhe mbyllini ato në qese plastike, ose kuti, dhe mbajini larg objekteve të tjera. Sigurohuni që gjatë seleksionimit të objekteve, kodi i tyre fillestar i vendndodhjes të mbetet i bashkëngjitur në objekt në vazhdimësi.



Seleksionimi i objekteve të shpëtuara si pjesë e një ushtrimi gjatë kursit ndërkombëtar mbi Ndihmën e Parë ndaj Trashëgimisë Kulturore në Kohë Krizash, Washington DC 2016. Foto: ICCROM-i dhe Instituti Smithsonian.

- 2 Grupojini objektet sipas gjendjes së tyre fizike, llojit të materialit dhe llojit të trajtimit që ato kërkojnë.** Për shembull, objektet e përbëra nga letra ose tekstilet që janë të thata, por që kërkojnë pastrim të sipërfaqes, duhet të mbahen së bashku. Në mënyrë të ngjashme, qeramika e brishtë dhe qelqi i padëmtuar duhet të grupohen së bashku.

- 3** **Vendosni një numër unik identifikimi** për secilin objekt pasi të ketë përfunduar seleksionimi. Vendosni një etiketë që mban numrin unik të identifikimit dhe kodin e vendndodhjes në mbështetësen dytësore të përdorur për të trajtuar dhe për të lëvizur objektin.



Një pikturë e shpëtuar që ka një etiketë e cila tregon numrin e identifikimit dhe vendndodhjen origjinale, Itali, 2017. Foto: Aparna Tandon, ICCROM.



- 4** **Dokumentimi.** Plotësoni pjesët e **formularit të regjistrimit të shpëtimit** (shihni faqen 92) që kanë të bëjnë me identifikimin, vendndodhjen fillestare, dimensionet dhe gjendjen e objektit (shihni faqen 93).





Nëse materiali i trashëgimisë kulturore duhet të zhvendoset jashtë vendndodhjes për stabilizim dhe ka pak kohë për të plotësuar formularin e regjistrimit të shpëtimit, sigurohuni që:

- Secilit objekt t'i jetë caktuar një **numër unik identifikimi** (shihni *Paketën e mjeteve*, faqja 42).
- Të gjitha objektet, paketimet dhe kutitë të kenë etiketat me numrat e tyre të caktuar.
- Të jenë të regjistruar në **formularin e regjistrimit të shpëtimit** (shihni faqen 92), **numri unik i identifikimit** (shihni *Paketën e mjeteve*, faqja 42), vendndodhja fillestare, lloji i materialit dhe pesha e objekteve.

Nëse objektet e nxjerra janë të padëmtuara, plotësoni formularin e regjistrimit të shpëtimit, paketoni objektet dhe zhvendosini ato në magazinën e përkohshme të caktuar (shihni "Zhvendosja" në faqen 103).



Stabilizimi

Pas klasifikimit sipas përparësisë (triazhimit), objektet e dëmtuara duhet të stabilizohen, gjë që mund të bëhet brenda ose jashtë vendngjarjes në një zonë të pastër dhe të përgatitur. Trajtimet e stabilizimit ndihmojnë në parandalimin e dëmtimeve dhe të përkeqësimeve të mëtejshme të atyre materialeve të trashëgimisë kulturore që janë nxjerrë.



Një vend pune për stabilizimin dhe pastrimin e sipërfaqeve të thata të objekteve në Port-au-Prince, Haiti, 2010. Foto: Aparna Tandon, ICCROM.

Ka dy hapa për stabilizimin, të përshkruara më poshtë:

- 1 Pastrimi i sipërfaqes.** Një ngjarje e rrezikshme mund të lërë pas pluhur, blazë, papastërti dhe **kontaminues**, të cilat nëse lihen në sipërfaqen e objekteve mund të shkaktojnë dëme dhe përkeqësime të mëtejshme. Nëse një objekt është i lagur dhe ka ndotës në të, mund të duhet të lahet me ujë të pastër për të hequr ndotësit.

Lloji i përshtatshëm për pastrimin e sipërfaqes varet nga natyra e fatkeqësisë, shkalla e dëmtimit dhe materialet nga i cili përbëhet objekti i trashëgimisë kulturore. Mundohuni të kuptoni përbërjen materiale të objektit dhe mënyren se si një trajtim stabilizimi mund të ndikojë në integritetin e tij strukturor. Mendoni në mënyrë kritike dhe zgjidhni rrugën më të përshtatshme të trajtimit për stabilizim.

- 2 Dokumentimi.** Ruani kodin e vendndodhjes dhe numrin unik të identifikimit që i është caktuar objektit gjatë gjithë trajtimit të stabilizimit. Plotësoni fushat përkatëse të **formularit të regjistrimit të shpëtimit** (shihni faqen 94) pas përfundimit të trajtimit të stabilizimit.

Referojuni seksionit “Stabilizimi i trashëgimisë së luajtshme të dëmtuar” te *Paketa e mjeteve*, faqja 57, për udhëzime hap pas hapi të veprimeve më të zakonshme për trashëgiminë kulturore të luajtshme.



Paketimi (ambalazhimi) dhe lëvizja

Pas nxjerrjes, klasifikimit sipas përparësisë, stabilizimit dhe dokumentimit (nëse bëhet në vend), objektet duhet të përgatiten për zhvendosje dhe magazinim.

- 1 Paketimi (ambalazhimi).** Përpara se të magazinohen, objektet e thata duhet të mbulohen me një shtresë mbrojtëse, të tillë si sfungjeri ose pëlhurë pambuku, për ta mbrojtur objektin nga dëmtimet e mëtejshme dhe për ta siguruar atë gjatë transportit. Për këshilla mbi trajtimin dhe paketimin e llojeve të ndryshme të objekteve të trashëgimisë kulturore, shihni *Paketën e mjeteve*, faqja 49.





Në rast se për objektet e dëmtuara nuk mund të realizohet qendrushmëria në vend, paketojini ato në mënyrë të sigurt për transport në zonën e caktuar për stabilizim. Bëjuni fotografi objekteve dhe vendosuni etiketa që shfaqin numrin unik të identifikimit të secilit objekt. Bëjeni këtë përpara paketimit, në mënyrë që secili objekt të mund të identifikohet lehtësisht në vendin e caktuar për stabilizim.

Sigurohuni që objektet e lagura të mbështillen me kujdes, për të shmangur ndotjen e objekteve të tjera dhe për të parandaluar tharjen e shpejtë gjatë transportit. Nëse është e mundur duhet të përdoren kamionët frigoriferikë për transportimin e objekteve të lagura, për ngrirje ose përmes tharjes me ngrirje.

2 Etiketoni dhe plotësoni formularin e regjistrimit të shpëtimit

- Etiketoni objektet e paketuara me numrat unikë të identifikimit të caktuar për objektet gjatë fazës së mëparshme. Sigurohuni që çdo etiketë të jetë e dukshme dhe e bashkëngjitur në mënyrë të sigurt. Kutitë që përmbajnë më shumë se një objekt, duhet të tregojnë numrin e objekteve që kanë brenda dhe të kenë një listë numrash unikë të identifikimit të secilit objekt që ka brenda.
- Plotësoni formularin e regjistrimit të shpëtimit (shihni faqen numër 92) dhe formularin e gjurmimit të lëvizjes. (shihni shembullin më poshtë).

Formulari i gjurmimit të lëvizjes

Numri hyrës	Numri i kutisë	Numri total i artikujve në kuti	Udhëzime për trajtimin e objekteve / transportimin	Dërguar nga:	Data e dërgimit:	Korrier / numri i makinës:	Data e mbërritjes:	Numri i kutisë	Numri total i artikujve në kuti	Marrë nga:
1	12	20		Kurator Abdel Hamid	25 Janar	xxx256	25 Janar	12	20	xxx magazinier
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

- Të paktën një anëtar i ekipit të dokumentimit duhet të gjurmojë zhvendosjen e objekteve pasi ato vendosen në kuti. Të paktën një kopje e secilit formular duhet t'i shoqërojë objektet në vendin e tyre të magazinimit.
- Kur paketon objektet në kuti, vendosni në pjesën e poshtme objektet e rënda dhe në pjesën e sipërme objektet më të lehta ose më të brishta. Mos e mbingarkoni kutinë. Pasi të jenë paketuar të gjitha objektet, ato mund të transportohen në hapësirën e re të përkohshme magazinuese.



Zhvendosja

Në mënyrë të ngjashme me rendin e punës për evakuimin pas ngjarjes, ky hap përfshin zhvendosjen e objekteve në një vend të përkohshëm më të sigurt, brenda ose jashtë vendngjarjes. Ndërsa një pjesë e ekipit është e përfshirë në shpëtimin e objekteve, të tjerët mund të ndihmojnë në përgatitjen e hapësirës së përkohshme të magazinimit. Hapësira e magazinimit duhet të pastrohet dhe të sterilizohet para se të futen objektet në të. Sapo të gjitha objektet të jenë zhvendosur në hapësirën e re të magazinimit, vendosni kodet e zhvendosjes së objekteve në formularin e regjistrimit të shpëtimit.



Hapësira të magazinimit të përkohshëm në Italinë qendrore për magazinimit e objekteve të evakuara dhe të shpëtuara pas tërmeteve të viteve 2016 dhe 2017. Foto: Aparna Tandon, ICCROM.



Raportimi

Përgatisni një raport të të gjithë operacionit për administratorët. Raporti duhet të përmbajë:

- një përmbledhje të operacionit;
- fotografi që dokumentojnë hapat kryesorë të punës;
- llojin e trajtimeve të stabilizimit të kryera dhe materialet e përdorura;
- **formularin e përditësuar të regjistrimit të shpëtimit** (shihni faqen 92);
- shpenzimet e bëra;
- nevojat për rimëkëmbje;
- informacion të kontakteve të ekipit të përfshirë në operacion;
- emri, firma dhe informacioni i kontaktit të udhëheqësit të skuadrës së operacionit.





Monitorimi

Përgatisni një program për kontrollin periodik dhe pastrimin e hapësirës së magazinimit, duke u këshilluar me administratorët.

Stabilizimi emergjent i strukturave historike

Stabilizimi emergjent i një strukture ose ndërtese përfshin ndërmarrjen e hapave që ndihmojnë përkohësisht në kufizimin e dëmtimit të trashëgimisë së ndërtuar, si dhe ul riskun e mëtejshëm të shembjes ose të përkeqësimit për shkak të dobësisht strukturor. Këto hapa janë veçanërisht të rëndësishme kur një strukturë është pjesërisht e dëmtuar dhe mund të riparohet (pjesërisht ose plotësisht), ose kur komuniteti vendas dëshiron të përdorë hapësirën përreth saj. Stabilizimi emergjent i një strukture mund të jetë thelbësor kur struktura ruan brenda saj mjedise me vlerë apo trashëgimi të paluajtshme me vlerë, si piktura murale, dysheme me mozaikë apo varre.

Është e rëndësishme të theksohet se këto masa të përkohëshme nuk do të rikthejnë nivelet fillestare të sigurisë së strukturës. Do të jetë e nevojshme të gjenden zgjidhje afatgjata gjatë tranzicionit ose gjatë **fazës së rimëkëmbjes të menjëhershme**.



Stabilizimi emergjent i strukturave kërkon ekspertizë të specializuar. Mos e kryeni këtë hap pa u konsultuar me një inxhinier konstruktor, i cili ka njohuri mbi strukturat dhe materialet e trashëgimisë kulturore në zonë.

Pse është e rëndësishme të realizohet stabilizimi emergjent?

Nëse një strukturë dëmtohet dhe lihet pa mbikëqyrje, rritet risku i dëmtimit të mëtejshëm ose i shembjes së saj, duke rrezikuar jetë njerëzish.

Pas një fatkeqësie, një strukturë mund të shembet ose të bëhet e pasigurt për t'u përdorur nëse:

- është prekur **vazhdimësia e saj** strukture dhe **ngarkesat** (qofshin ato të zakonshme apo të veçanta) nuk mund të shkarkohen më në mënyrë të sigurt në tokë;

- shembja e pjesshme e strukturës shkakton **mbingarkesa** të lokalizuara;
- elementet e brendshme strukturore nuk mbrohen më nga mjedisi i jashtëm, për shembull, kur elementet e brendshme të një muri janë të ekspozuara si pasojë e dëmtimit të faqes së jashtme të murit.

Ndërhyrja në kohë është e rëndësishme, sidomos pas fatkeqësive të cilat mund të përsëriten brenda një periudhe të shkurtër kohe. Për shembull, është e nevojshme të zbatohen masat e stabilizimit pas një tërmeti, pasi pasgoditjet mund të çojnë në dëmtime të mëtejshme dhe, në disa raste, në shembjen e plotë të një strukture. Në mënyrë të ngjashme, në një zonë të prirë ndaj cikloneve ose në një zonë të përfshirë në konflikt, është e rëndësishme të sigurohen strukturat historike sa më shpejt të jetë e mundur.



Bagan, Mianmar, 2016. Foto: ICCROM.



Rëndësia e ruajtjes së vazhdimësisë strukturore: Mianmari - Birmani

Më 24 gusht të vitit 2016, një tërmet me magnitudë 6.8 goditi Chauk-un, Mianmar-in, duke shkaktuar dëme në monumente të shumta pranë zonës arkeologjike në Bagan. Tërmeti ndodhi në fillim të sezonit të shirave. Më poshtë jepen shembuj të dëmtimit strukturor ku u parandalua degradimi i mëtejshëm duke përdorur sigurimin emergjent dhe ndërhyrjet stabilizuese.

Shembje për shkak të ndërprerjes së vazhdimësisë strukturore

Para tërmetit, në “Tempullin Sulejmanie” ishte shembur pjesërisht një qemer dhe elementet që kishin mbetur nuk ishin stabilizuar, duke çuar në ndërprerje strukturore. Gjatë tërmetit në vitin 2016, qemeri u shemb plotësisht. Një dëmtim në përmasa të tilla mund të ishte shmangur, duke punteluar ose duke çmontuar në mënyrë të kontrolluar elementet strukturore të cenueshme.



*Bagan, Mianmar, 2016.
Foto: Eugénie Crété*

Mbingarkesa nga rrënojat

Grumbujt e inerteve krijuan një mbingarkesë të jashtëzakonshme në strukturat që ishin dobësuar tashmë nga tërmeti. Ishte e rëndësishme të hiqeshin inertet sa më shpejt të ishte e mundur, sepse risku i një shiu të rrëmbyer ishte i lartë. Inertet bllokojnë rrjedhjen e ujit dhe kjo krijon mbingarkesë shtesë. Një zgjidhje e përkohshme në situata të tilla është mbrojtja e rrënojave me mushama, ndërsa përgatiteni për zhvendosjen e tyre. Për të qenë efektiv, mbulesa e plastikës së gomuar duhet të fiksohet në mënyrë të sigurt.



“Tempulli Sulejmanie” në Bagan, Mianmar, 2016. Foto: Eugénie Crété






Ekspozimi i elementeve të brendshme strukturor dhe i sipërfaqeve dekorative

Në çatitë dhe sistemet e tyre të hidroizolimit u gjetën hapje dhe çarje, që lejonin depërtimin e ujit në brendësi të objektit, duke shkaktuar dëme të mëdha. Ulluqet ishin të prishura ose të bllokuara nga mbeturinat dhe për këtë arsye nuk ishin në gjendje të largonin ujin nga çatia. Muret e dëmtuara, pas tërmetit, janë shumë të ndjeshëm ndaj shiut, veçanërisht kur ekspozohet llaçi prej balte. Në të vërtetë, për shkak të shiut të rrëmbyer, në javët pas tërmetit ndodhën shembje të mëtejshme.

Origjina: Eugénie Crété, Arkitektura Mjedisi dhe Kulturat Ndërtimore – CRATerre, Grenoble.



*Bagan, Mianmar, 2016.
Foto: Eugénie Crété.*



Çarje në çatinë e një tempulli, Bagan, Mianmar, 2016. Foto: Eugénie Crété.




Hapje në sistemin e hidroizolimit të çatisë (kulmit) të një pagode në Bagan, Mianmar, 2016. Foto: Eugénie Crété.



Si mund të zbatoni veprime të stabilizimit strukturor emergjent?

Seksioni i mëposhtëm përshkruan disa nga hapat bazë të stabilizimit emergjent për strukturat historike. Përpara se të kryeni ndonjë veprim stabilizimi, **garantoni sigurinë personale** dhe **siguroni sitin**.

Më poshtë jepet një rend i përgjithshëm i punës për zbatimin e llojeve të ndryshme të hapave të stabilizimit emergjent për ndërtesat dhe strukturat historike, të cilat gjithashtu përfshijnë rrënoja të ekspozuara në sitet arkeologjike.





Përgatitja

- 1 Siguroni leje / autorizim me shkrim nga administratorët dhe kur është e mundur, nga koordinatori **për përballimin e gjendjes së emergjencës**, për të zbatuar ndërhyrje stabilizuese emergjente në një ndërtesë, ose një strukturë.
- 2 Krijoni një ekip që përfshin një inxhinier konstruktor, një arkitekt, si dhe punëtorë të trajnuar dhe vullnetarë. Sigurohuni që arkitekti dhe inxhinieri konstruktor t'i njohin vlerat e ndërtesave të trashëgimisë, si dhe teknikën e ndërtimit. Ekipi mund të përfshijë edhe një historian të zonës ose anëtar të komunitetit, i cili ka njohuri paraprake për specifikat e stilit të ndërtimit dhe materialet e përdorura.

Pjesë e ekipit mund të jetë dhe personeli ushtarak dhe zjarrfikësit, të cilët janë të trajnuar për ndërhyrje emergjente të stabilizimit të strukturave. Në disa shtete, legjislacioni mbi emergjencat kërkon që zjarrfikësit ose personeli ushtarak të mbikëqyrin ose të zbatojnë stabilizimin emergjent të strukturave. Sidoqoftë, atyre duhet t'u jepet informacion në lidhje me rëndësinë e ndërtesës dhe elementet e trashëgimisë që duhet të mbrohen.

- 3 Përdorni **raportin e vlerësimit të dëmit dhe riskut** (shihni faqen 63), së bashku me vizatimet përkatëse të objekteve dhe planimetritë e kateve, për të identifikuar dëmtimet kritike strukturore dhe jostrukturore. Kryeni një **vlerësim teknik të thelluar** të llojit të dëmit dhe të shkaqeve të tij. Ky vlerësim mund të përfshijë një studim të gjendjes së themeleve dhe llojeve të ndryshme të ngarkesave të përfshira.
- 4 Identifikoni hapësirat e sigurta për të punuar, për të magazinuar materialet dhe për ushqimin. Shënojin këto zona në hartën e vendndodhjes dhe krijoni sinjalistikë të përshtatshme.
- 5 Nëse ndërtesa është e sigurt për të hyrë, identifikoni “in situ” elementet dekorative, si dysheme me pllaka ose me dru, pikturat murale dhe mozaikë, të cilat mund të kenë nevojë të mbulohen dhe të mbrohen para se të kryhet ndërhyrja për stabilizim emergjent. Në mënyrë të ngjashme, identifikoni orenditë me vlerë, si qilima, sixhade dhe tablo, të cilat mund të kenë nevojë të **evakuohen** përpara procesit për vënien në siguri të ndërtesës.



- 6 Konsultohuni me një inxhinier konstruktor për të projektuar ndërhyrjet stabilizuese emergjente dhe përgatitni skicat përkatëse. Mbi bazën e skicave, përgatitni specifikimet teknike të materialeve dhe të pajisjeve të nevojshme për zbatimin e ndërhyrjeve.
- 7 Konsultohuni me administratorët dhe shpjegojuni atyre llojin e masave të përzgjedhura për ndërhyrjet stabilizuese emergjente ndaj ndërtesës ose strukturës, kohëzgjatjen e zbatimit të tyre, burimet njerëzore dhe financiare të nevojshme për zbatimin e saj. Nëse është e nevojshme, kërkoni ndihmën e administratorëve dhe të komunitetit vendas për të **evakuar** (shihni faqen 79) objekte me vlera dhe për të mbrojtur elementet dekorative në vend.
- 8 Grumbulloni mjete dhe pajisje, p.sh., dërrasa, litarë, çekanë, sharra etj. Për më shumë informacion mbi llojin e mjeteve dhe pajisjeve të kërkuara për masat specifike të stabilizimit strukturor, shihni *Paketën e mjeteve*, faqja 93.



Dokumentimi

- 1 Dokumentoni vendin e saktë, llojin dhe përmasat e dëmit të shkaktuar, p.sh. çarje, shformim i planeve dhe shkëputje e suvasë. Përdorni skicat e fasadave dhe planimetritë e kateve për të regjistruar dëmin.
- 2 Bëni fotografi të zonave të dëmtuara, duke përfshirë fotografi nga afër (në detal) dhe pamje të përgjithshme. Ndërkohë që bëni fotografi, përdorni latën si një njësi metrike me ndarje prej 10 cm për të përcaktuar shkallën dhe një shenjë që tregon datën. Rregjistroni numrin e referencës së fotografive që korrespondojnë me llojin specifik të dëmtimit në planimetri.
- 3 Kur është e nevojshme, dokumentoni hollësi të tjera të rëndësishme, si llojet e ndryshme të ngarkesave, gjendjen e tokës apo sheshit etj. Shtoni skicën përkatëse të masave të stabilizimit që u ndërmorën në dokumentimin e dëmtimit, pasi të gjitha këto të dhëna së bashku ndihmojnë për të përcaktuar nevojat e rimëkëmbjes.

Zbatimi

Masat themelore të stabilizimit emergjent dhe vënies në siguri të ndërtesave dhe strukturave janë përshkruar më poshtë. Detajet teknike për zbatimin e masave të tilla janë përshkruar në *Paketën e mjeteve*, faqja 79.

1 Mbulesa të përkohshme

Në mënyrë që të mbrohen elementet e ndjeshme nga uji, era, shembja e mëtejshme e elementeve përreth dhe nga hyrja e kafshëve, përdorni mushama të përforcuara (me rretë teli të dyfishtë për të përmirësuar rezistencën ndaj objekteve që mund të bien), llamarinë të valëzuar dhe të galvanizuar, ose fletë çeliku, të fiksuara në një kornizë ekzistuese ose të përkohshme. Identifikoni zgjidhjen më të përshtatshme, duke marrë parasysh burimet njerëzore, materialet dhe aftësitë e disponueshme në zonë. Për zbatimin hap pas hapi, shihni *Paketa e mjeteve*, faqja 73.



Bagan, Mianmar, 2016. Foto: Aparna Tandon.

2 Pajandimi bazë

Pajandimi është teknika e përforcimit të elementeve ndërtimore gjatë riparimeve ose kur një strukturë rrezikon të shembet. Ajo vepron si një patericë apo mbështetëse dhe shkarkon **ngarkesat** në tokë.


Pajandat mund të përdoren për të mbështetur:

- trarë mbajtës që mbështeten mbi një mur ose kolonë të dëmtuar;
- një mur mbajtës me material tulle, guri ose qerpiç që ka pësuar epje apo inklinim / shmangie nga vertikalishteti, i cili është strukturalisht i paqëndrueshëm;
- një arkitra të thyer të një dëre ose dritareje.




Pajandimi bazë përbëhet nga katër elemente kryesore:

1. elementet që mbajnë ngarkesën (mbështetës vertikale - veshje me binarë/dërrasa ose mbështetës horizontale - trau i çatisë / kulmit);
2. elementet që transmetojnë ngarkesën (shtylla ose binarë shtytës diagonal);
3. shtrëngues anësor që siguron qëndrueshmërinë e sistemit të pajandimit;
4. pllaka mbajtëse / tabani që përcjellin ngarkesën në tokë.



Aty ku është e mundur, parapërgatiteni strukturën e pajandimit në një zonë të sigurt pranë objektit, ku ka hapësirë të lirë për të punuar në terren të sheshtë.

Para se të pajandoni, pastroni sipërfaqen nga mbetjet ku do të vendoset pllaka mbajtëse / tabani, pasi nevojitet një sipërfaqe e sheshtë për të shkarkuar ngarkesat në tokë.

 Kur përdorni puntela metalike, gjithmonë vendosni pllaka druri ndërmjet puntelës dhe strukturës së dëmtuar.

Lënda drusore zakonisht përdoret në pjesën e sipërme dhe / ose të poshtme të një sistemi emergjence pajandrie për të përthithur dhe për të shpërndarë ngarkesën. Për më tepër, disa e konsiderojnë lëndën drusore si një lloj alarmi dëgjimor ose vizual që paralajmëron për një rritje të ngarkesës kur pajandria fillon të deformohet.

Për udhëzime hap pas hapi për ndërtimin e një pajandre bazë prej druri, referojuni *Paketës së mjeteve*, faqja 79.



- Mos tentoni të pajandoni pjesë që janë më të larta se 3 m pa ekspertizën e një inxhinieri konstruktor.
- Kini kujdes kur pajandoni një muraturë guri me llaç të dobët ose të dëmtuar. Kërkoni ndihmën e një inxhinieri konstruktor për të projektuar një veshje me dërrasa mbështetëse për muratura që kanë madhësi të konsiderueshme, ose për të ndërtuar një numër pajandash të mjaftueshme për të punteluar të gjithë hapësirën.

3 Lidhja/shtrëngimi i strukturave

Shtrëngimi i një strukture përmirëson aftësinë e saj mbajtëse të ngarkesës vertikale duke siguruar mbërthim anësor dhe duke parandaluar deformimin e mëtejshëm.

Në nivel ndërtese, shtrëngimi ndihmon në rilidhjen e mureve perimetralë, duke siguruar rezistencë më të mirë kundrejt lëvizjeve anësore, si dhe duke penguar hapjen e strukturës. Lidhja apo shtrëngimi mund të kryhet duke përdorur fasha poliesteri, kablo çeliku ose elemente çeliku që janë salduar ose të lidhur me anë të bulonave apo muftave.




Figura 1.


Vizatim i përshtatur nga: Grimaz, S. et al. 2010. Vademecum, STOP, Shembuj Pajandimi dhe Procedura për puntelimin e Ndërtesave të dëmtuara nga tërmetet. Romë, Ministria e Brendshme - Shërbimi zjarrfikës italian.



Mos e përdorni kurrë këtë teknikë në kolona betoni të dëmtuara.

- a. Para zbatimit të përforcimit perimetral strukturor, konsultohuni me një inxhinier konstruktor për çfarë ka nevojë struktura dhe për skicën e përforcimit.
- b. Pastroni mbetjet përpara se të kryeni përforcimin perimetral të elementeve strukturore.
- c. Kur shtrëngoni një strukturë me fasha lidhëse poliesteri dhe / ose kriket dhëmbëndaluese vendosni në strukturë tako druri ose piastra çeliku, në mënyrë që sforcimet të shpërndahen gjatë gjithë lartësisë. Takot e drurit duhet të jenë të trasha afërsisht 3 cm. Ato duhet të vendosen midis murit / kolonës dhe pllakave të çelikut.

d. Instaloni fashat duke filluar nga sipër (shihni figurën 2); shpërndajini ato në intervale të rregullta. Distanca ndërmjet fashave duhet të jetë nga 10 deri në 45 cm, sipas nivelit të dëmtimit dhe të ngarkesave që duhet të mbajë struktura. Për listën e materialeve dhe të pajisjeve të nevojshme për përforcimin perimetral të një strukture me fasha, shihni *Paketën e mjeteve*, faqja 95.



Vizatim i përshtatur nga:
 Grimaz, S. et al. 2010. *Vademecum, STOP, Shembuj pajandimi dhe procedura për puntelimin e ndërtesave të dëmtuara nga tërmetet. Romë, Ministria e Brendshme Italiane, Shërbimi zjarrfikës Italian*

4 Mbrojtja e elementeve dekorative në sit

Stabilizimi në vend përfshin një sërë veprimesh në objekt që mund të ndërmerren për të vënë në siguri elemente të paluajshme dekorative dhe vepra arti, si skulptura të mëdha, mozaikë në mur ose në dysheme, si dhe piktura murale.

Masat e stabilizimit emergjent për ndërtesat, si pajandimi dhe përforcimi perimetral mund të dëmtojnë potencialisht elementet në vend nëse nuk arrini të ndërmerri hapat e duhur për t'i mbrojtur ato. Këshillohuni gjithmonë me një restaurator arti përpara se të ndërmerri veprime për stabilizimin që përfshin elemente dekorative, ose kryhen në afërsi të tyre.



Shtresë mbrojtëse dhe izoluese midis pikturës murale dhe puntelës në kishën e Freixo de Espada à Cinta, Portugali, 2007.
 Foto: Esmeralda Paupério.

Para se të ndërmerrni masa për stabilizimin emergjent, sigurohuni që skulpturat, pllakat ose sipërfaqet të jenë të sigurta në vendin e tyre origjinal. Për të shmangur kontaktin e drejtpërdrejtë të një puntele ose të fashave shtrënguese me sipërfaqen e dekoruar, mund të përdorni një napë të bardhë natyrale ose një tekstil tjetër të butë pa ngjyrë. Po kështu, përdorimi i sfungjerit eviton kontaktin e drejtpërdrejtë me sipërfaqen e dekoruar. Sigurohuni që materiali amortizues të jetë i fiksuar mirë, në mënyrë që të zvogëlohet risku i rënies së tij aksidentalisht apo i gërvishtjes së sipërfaqes të elementit dekorativ.

Mund të përdorni gjithashtu edhe thasë rëre për të parandaluar kontaktin midis një binari çatie / kulmi ose veshjes me binarë druri të muraturës dhe një elementi dekorativ, megjithatë kini kujdes sepse thasët e rërës në klimat e lagështa prirën ta ruajnë lagështinë, e cila mund të shkaktojë dëme të mëtejshme. Për një listë të përgjithshme të pajisjeve të nevojshme, shihni *Paketën e mjeteve*, faqja 93.



Siguria në vendndodhje dhe stabilizimi i mozaikëve në Muzeun Ma'arra: Siri

Në situata konfliktesh, veprimet e sigurimit dhe stabilizimit mund të përfshijnë operacione të ndërlikuara dhe ekstreme, si rimbullimi i gjetjeve arkeologjike të ekspozuara ose vendosja e një shtrese mbrojtëse mbi një pikturë murale ose mbi një mozaik.

Muzeu i Mozaikut Ma'arra, i cili ruan një prej koleksioneve më të rëndësishme të mozaikëve romakë dhe bizantinë të shekullit të tretë deri në shekullin e gjashtë në Lindjen e Mesme, u dëmtua rëndë gjatë konfliktit që vazhdon në Siri. Përpara veprimeve të sigurimit (vënies në siguri) dhe të stabilizimit emergjent të miratuara nga profesionistë dhe vullnetarë të trashëgimisë kulturore vendase, ndërtesa ishte në rrezik shembjeje.

Për të mbrojtur mozaikët nga dëmtimet e mëtejshme gjatë konfliktit, ekipi sirian u këshillua me specialistët e konservimit të trashëgimisë kulturore për të hartuar një plan stabilizimi dhe vënien në siguri të mozaikëve. U riparuan hapjet e çatisë për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm të strukturës dhe shembjen e saj. Pastaj, në konsultim me restauratorët e mozaikut, ekipi vendosi mbi mozaikët një shtresë pëlhere me ngjitëse për të mbajtur teserat e mozaikut të bashkuara. Pasi u stabilizuan, disa kamionë sollën thasë me rërë, të cilat u vendosën mes mozaikëve për t'i mbrojtur nga dëmtimet e mëtejshme. Në total u mbrojtën rreth 148 m² mozaikë.

Burimi: Instituti Smithsonian. 2015. Aktivitetet e Ruajtjes Emergjente të realizuara në Muzeun e Mozaikëve të Ma'arra të Sirisë. Washington, DC.



Raportimi dhe komunikimi

- 1 Përgatitni një raport të shkurtër që përshkruan veprimet e sigurimit (vënies në siguri) dhe stabilizimit emergjent që keni zbatuar për ndërtesat / strukturat e trashëgimisë. Përfshini fotografi, skica dhe një planimetri që tregon vendndodhjet e tyre.
- 2 Përmendni hollësi të rëndësishme, të tilla si evakuimi i elementeve të trashëgimisë kulturore të luajtshme ose shpëtimi i fragmenteve të ndërtesave historike - procese të kryera gjatë përgatitjes për stabilizimin emergjent.
- 3 Bëni një llogaritje të shpenzimeve të bëra dhe një listë me emrat dhe kontaktet e anëtarëve të ekipit që u morën me punën e stabilizimit emergjent.
- 4 Raporti duhet të përmbajë një sistem monitorimi dhe të rekomandojë veprime për rimëkëmbjen dhe rehabilitimin e plotë.



Monitorimi

Masat e stabilizimit emergjent për strukturat dhe ndërtesa synojnë të jenë të natyrës së përkohshme. Prandaj është e rëndësishme të monitorohet efektiviteti i tyre, derisa të fillojë restaurimi i plotë. Për shembull, pajandat dhe puntelat mund të bëhen të rrezikshme në rast shembjeje, ndaj duhet të kontrollohen rregullisht (të paktën një herë në 12 orë gjatë ditëve të para) për ndonjë shenjë të shtrembërimit ose mbingarkesës.

Sigurohuni që shtyllat/puntelat të qëndrojnë në pozicionet e tyre origjinale. Për më tepër, lidhjet dhe pykat duhet të qëndrojnë të shtrënguara dhe të mos shtrembërohen. Kontrolloni për çdo lëvizje të mundshme në pozicionin e pllakës mbajtëse të një pajande ose për ndonjë shenjë të dëmtimit të tabanit të tokës. Po kështu, sigurohuni që skajet e shtyllave vertikale të mos jenë çarë ose që skajet e trarëve të mos jenë ndarë, pasi këto janë tregues se pajanda është e mbingarkuar. Nëse shfaqen çarje në veshjen me binarë e dërrasa, atëherë kjo nënkupton që pllaka nuk është e madhe sa duhet ose që muri nuk i reziston sforcimit të shkaktuar nga pajanda.

Kur janë përdorur **fasha shtrënguese perimetrale** ose kablllo çeliku për të shtënguar një strukturë, sigurohuni që ato të jenë të lidhura fort. Kontrolloni për të parë që elementet e drurit nuk po lëvizin dhe që nuk po shtypen nga sforcimi i shkaktuar nga fashat ose kabllo. Monitoroni në mënyrë periodike lëndën drusore të

përdorur, në mënyrë që të zbuloni shenja të përkeqësimit fizik ose të dëmtimit, p.sh. një infektim nga insektet.

Në një ndërtesë e cila është përmytur, sigurohuni që të regjistroni rregullisht sa vijon:

- a. Lagështinë e suvasë dhe / ose mureve, për këtë mund të përdorni një matës lagështie, një multimetër ose mund të nxirrni kampione, të cilat i peshoni para dhe pas tharjes në furrë;
- b. Nivelet e lagështisë në konstruksionet e bëra prej balte – qerpiçi. Duhet të kontrolloni për lagështinë në bazamentin e mureve dhe brenda vetë murit (lagështia në suva të murit nuk është e njëjtë me lagështinë në pjesën e saj strukturore);
- c. Shkallën e erozionit kristalor ose të rritjes së mykut;
- d. Çdo shtrembërim të elementeve prej druri;
- e. Çarjet ose epjet në pjesën e suvasë.

Si të sigurojmë dhe stabilizojmë trashëgiminë kulturore jomateriale?

Sigurimi dhe stabilizimi janë terma që nuk përshtaten logjikisht me trashëgiminë kulturore jomateriale. Siç shpjegohet në dokumentin mbi vlerësimin në vend të dëmit dhe riskut për trashëgiminë jomateriale, vlerësimi i dëmit dhe riskut për trashëgiminë jomateriale duhet të përfshijë:

- a. Qasjen në,
- b. interpretimin e,
- c. dhe transmetimin e trashëgimisë jomateriale të prekur.

Veprimet që lidhen me sigurinë dhe stabilizimin ndërmerren kryesisht në lidhje me dy nivelet e para, të cilat u referohen elementeve të trashëgimisë materiale të shoqëruara nga trashëgimia jomateriale dhe njerëzit si bartës të traditës. Për më tepër, çdo veprim i ndërmarrë për të siguruar ose për të stabilizuar trashëgiminë kulturore jomateriale duhet të bëhet mbi bazën e një kërkesë të posaçme të komunitetit të prekur dhe nevojave të tij të posaçme.

Në rastin e trashëgimisë jomateriale, vlera e trashëgimisë qëndron në traditat dhe njohuritë e një komuniteti, si dhe në praktikimin dhe transmetimin e tyre. Si i tillë, qëllimi i këtyre masave është i ndryshëm nga qëllimi i masave të trashëgimisë materiale. Stabilizimi i trashëgimisë jomateriale nënkupton diçka shumë të ndryshme nga stabilizimi i trashëgimisë së paluajtshme ose të luajtshme.





Praktika tradicionale e leximit të dorëshkrimeve fetare si pjesë e ritualeve të përditshme në Nepal, 2015. Foto: ICCROM

Kjo lidhet veçanërisht me:

- bërjen të mundur që një komunitet të mund të vazhdojë një praktikë specifike, një ritual etj. menjëherë pas një ngjarjeje fatkeqësie.
- bërjen të mundur që transmetimi i dijes dhe i aftësive të vazhdojë derisa të identifikohen zgjidhje më afatgjata.

Veprimet e sigurisë dhe të stabilizimit për komponentët e trashëgimisë materiale dhe njerëzit janë renditur më poshtë:

- 1 Komponentët e trashëgimisë materiale:** këtu përfshihen ndërtesa, site, objekte, mjete, kostume dhe çdo kulturë materiale e lidhur me një praktikë jomateriale. Nëse **analiza e situatës** dhe **vlerësimi në vend i dëmit dhe riskut** (faqja 43) kanë identifikuar nevoja emergjente, mund të ndërmerren të njëjtat hapa si më sipër për trashëgiminë e ndërtuar dhe të luajtshme.

Zakonisht, elementet e prekshme që lidhen me trashëgiminë jomateriale janë të rëndësishme nga ana kulturore, sepse ato ofrojnë një vend ose një kontekst për zhvillimin e traditave

jomateriale. Stabilizimi i elementeve materiale duhet të orientohet drejt lejimit të vazhdimit të traditave jomateriale. Kjo mund të nënkuptojë gjithashtu që komunitetet kanë preferenca të caktuara të stabilizimit. Për shembull, nëse një faltore dëmtohet, komuniteti mund të parapëlqejë një strehë të përkohshme në vend të një strukture të përforcuar me pajanda, në të cilën ata nuk do të ndiheshin të sigurt për të vijuar ritet e besimit.



- 4 Njerëzit:** Në shumicën e rasteve, masat e sigurisë ose të stabilizimit kufizohen në identifikimin se ku janë komunitetet dhe si mund të sigurohet përcjellja e traditave. Ky hap mund të përfshijë masa të tilla si dokumentimi, regjistrimi ose inventarizimi, në mënyrë që të sigurohet një regjistrim pamor dhe gojor për t'u përdorur kur të rikthehet normaliteti. Sidoqoftë, veçanërisht në rastet e shpërnguljes masive të popullsisë, ose kur komuniteti ka pësuar humbjen e bartësve kryesorë të traditës, për të siguruar transmetimin e njohurive dhe të traditës mund të nevojiten masa emergjente, si dokumentimi përmes videove ose trajnimet për përcjelljen e dijeve.



Këshilla për punën me trashëgiminë jomateriale

Trashëgimia jomateriale mund të jetë gjithashtu një aspekt i rëndësishëm i masave emergjente ndaj trashëgimisë së luajtshme ose asaj të ndërtuar. Gjithmonë merrni parasysh rëndësinë fetare ose shpirtërore të ndërtesave dhe të siteve, përpara se të ndërmerrni veprime sigurimi ose stabilizimi. Përfshini komunitetin vendas. Sigurohuni që veprimet që do të ndërmerrni të marrin një kuptim më të madh sesa thjesht veprime kundrejt aspekteve fizike të strukturës. Kjo vlen edhe për objektet kulturore, shumë prej të cilave mund të kenë një vlerë të rëndësishme jomateriale për komunitetin vendas. Kjo gjë duhet të merret parasysh gjatë evakuimit dhe shpëtimit të objekteve.

Ekziston vetëm një mënyrë për të kuptuar se si të silleni në këto vende, ndërtesa dhe objekte: përfshini komunitetet përkatëse, anëtarë të komunitetit dhe drejtues lokalë, si dhe merrni parasysh këshillat, bashkëpunimin dhe miratimin e tyre **para** ndërmarrjes së ndonjë veprimi.



Vazhdimi i traditave pas ciklonit Nargis: Mianmar, Birmani

Më 2 maj 2008, cikloni Nargis goditi Mianmar-in, i cili solli shkatërrim katastrofik dhe humbje jetësh. Vlerësimet e bëra nga Organizata e Kombeve të Bashkuara pas ciklonit tregojnë se rreth 2.4 milionë njerëz u prekën pas goditjes nga cikloni.

Cikloni goditi rëndë qendrat bazë prodhuese të mjeshtërive tradicionale dhe arteve skenike. Një qendër e tillë prodhonte marioneta tradicionale të Mianmar-it dhe organizonte shfaqje me marioneta dhe interpretime tradicionale të orkestrës së Mianmarit. Duke qenë qysh më parë një praktikë e cenuar, me pak praktikues të mbetur, efektet që pasuan pas ciklonit dhe bllokada ushtarake rrezikuan humbjen totale të mjeshtërive dhe njohurive që praktikoheshin që nga shekulli i pesëmbëdhjetë, periudha Inwa (“AVA”).



Trajnir për manovrimin e marionetave, Mandalay, Mianmar, 2016.

Foto: Giuseppe Salerno

“Myanmar Upper Land I Culture & Travel” u formua për të promovuar artet tradicionale të interpretimit, në veçanti interpretimin tradicional të marionetës së Mianmar-it. Kjo organizatë krijoi kapacitete të interpretimit përmes rritjes së ndërgjegjësimit social brenda Mianmar-it dhe punës për të mbrojtur të gjitha aspektet e kësaj trashëgimie, përfshirë metodën e prodhimit dhe të përdorimit të marionetave të Mianmar-it, vallëzimit, muzikës, skulpturës, qëndisjes me dorë dhe pikturës. Në bashkëpunim me Organizatën e Marionetave





të Mianmar-it, u përgatit një DVD edukative, u mbajt një trajnim mbi interpretimin, si dhe u organizua Festivali i parë Ndërkombëtar i Kukullave të Mianmar-it (2016) me qëllimin për të transmetuar mjeshtritë dhe njohuritë në komunitetet vendase, në përpjekje për të zvogëluar cenueshmërinë dhe për të rritur kapacitetin interpretues dhe qëndrueshmërinë. Ai vazhdon edhe sot.



Trajnim për interpretimin me marionetë, Mandalay, Mianmar, 2016.

Foto: Giuseppe Salerno

Shikoni referencat në faqen 164.





Përmirësoni gatishmërinë për emergjenca!

Nëse do të ndodhte një emergjencë në qytetin tuaj dhe do të preken një numër koleksionesh të trashëgimisë kulturore, ndërtesash dhe pasurish të trashëgimisë jomateriale:

- A do të merrnin institucionet e prekura ndihmën në kohë për të siguruar dhe për të stabilizuar trashëgiminë e rrezikuar?
- A ekzistojnë mekanizmat e koordinimit dhe të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të trashëgimisë kulturore dhe agjencive të menaxhimit të emergjencave për të lehtësuar qasjen në trashëgiminë e dëmtuar gjatë emergjencave **madhore**?
- A ekziston një ekip i trajnuar vullnetarësh dhe operatorësh të ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore?
- A do të kenë ata qasje në shumicën e mjeteve dhe të pajisjeve për të ndërmarrë shpëtimin, evakuimin dhe stabilizimin strukturor në shumë zona?
- A kanë institucionet përkatëse qasje në zona të sigurta për krijimin e hapësirave të përkohshme magazinimi ose për të krijuar zona për klasifikimin dhe për stabilizimin e një numri të madh objektesh dhe elementesh ndërtimore?


Çfarë vjen pas ndihmës së parë?

PAS NJË EMERGJENCE, ju dhe ekipi juaj ishit të suksesshëm në dhënien e ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore që është prekur: keni kryer një **analizë të situatës** dhe keni përdorur rezultatet e saj për të ndërmarrë një **vlerësim në vend të dëmit dhe riskut**; bazuar në këtë vlerësim, ju keni **siguruar dhe stabilizuar** trashëgiminë materiale dhe atë jomateriale.

Çfarë duhet të bëni tani?

Lexoni në vijim për ta zbuluar.

RIMËKËMBJA E MENJËHERSHME



Rimëkëmbja e menjëhershme

Ndihma e parë ndaj trashëgimisë kulturore është e suksesshme vetëm nëse pasohet nga ndërhyrje konservuese për të rikthyer funksionin dhe qasjen. Kështu, pasi të keni zbatuar ndihmën e parë për trashëgiminë kulturore që është dëmtuar, pasi të keni dokumentuar të gjithë procesin dhe të keni vendosur një sistem monitorimi periodik, hapi tjetër është përgatitja e një plani veprimi, të miratuar përmes konsensusit, për rimëkëmbjen dhe **rehabilitimin**. Planin duhet të përfshijë: vlerësim të hollësishëm të gjendjes; trajtimet konservuese (përfshirë riparimin dhe **restaurimin**) për trashëgiminë materiale; zvogëlim të riskut; rivendosje të strukturave themelore dhe të shërbimeve; përdorimin e përmirësuar të trashëgimisë kulturore duke ndjekur parimet e **zhvillimit të qëndrueshëm** dhe **'rindërto më mirë'**. Thënë thjesht, rimëkëmbja dhe rehabilitimi i trashëgimisë kulturore përfshin riparimin e dëmeve, rimëkëmbjen e humbjeve, zvogëlimin e risqeve dhe kthimin e trashëgimisë kulturore në një gjendje më të mirë konservimi, në mënyrë që të mund të përdoret përsëri në një mënyrë të qëndrueshme.

Periodua e ndërmjetme, e nevojshme për të hartuar një plan veprimi për rimëkëmbjen dhe rehabilitimin e trashëgimisë kulturore pas ndihmës së parë, njihet si faza e hershme e rimëkëmbjes në sektorin humanitar.



Sheshi Durbar, Kathmandu, Nepal, 2015. Foto: ICCROM.





Si e përcakton sektori humanitar rimëkëmbjen e menjëhershme?

Rimëkëmbja e menjëhershme përcaktohet si “një proces shumë-dimensional, i udhëhequr nga parimet e zhvillimit. Ajo synon të gjenerojë procese të vetë-qëndrueshme, të zbatuara në nivel kombëtar dhe të përtëritshme për rimëkëmbjen pas krizës” (IASC, 2006, fq. 1). Sipas këtij përkufizimi, individët janë në gjendje të përfitojnë nga veprimet humanitare për të përqaftuar mundësitë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe për t'u ripërtëritur. Kjo fazë nxit bashkëpunimin midis agjencive nga sektorët humanitarë dhe të zhvillimit. Për ta përmbledhur: faza e rimëkëmbjes së menjëhershme është pikëku ndërrhyrjet afatshkurtra, urgjente dhe jetë-shpëtuese mbarojnë dhe fillojnë programet afatgjata të zhvillimit dhe të rimëkëmbjes.

Synimet e rimëkëmbjes së menjëhershme në sektorin humanitar

1. Përmirësimi i veprimeve të ndihmës emergjente në vazhdim.
2. Nxitja dhe mbështetja e nismave nga komunitetet e prekura.
3. Vendosja e bazave për rimëkëmbjen afatgjatë, duke krijuar kushte për zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen.
4. Stabilizimi dhe rritja e kapaciteteve lokale dhe kombëtare, duke u siguruar që autoritetet lokale dhe kombëtare të mund të ofrojnë stabilitet, të rrijtëzojnë tregjet dhe mjetet e jetesës dhe gjithashtu të ofrojnë shërbime.
5. Parandalimi i rikthimit të krizës përmes ngritjes së kapaciteteve dhe zvogëlimin e cenueshmërisë, si dhe puna për rritjen e qëndrueshmërisë së aktorëve të ndryshëm.
6. Pajisja e komuniteteve me një rrjet mbështetës.

Shikoni referencat në faqen 167.



Në mjediset në gjendje konflikti, institucionet, mekanizmat e qeverisjes dhe marrëdhëniet shoqërore janë rrënjësisht të transformuara. Në situata të tilla, procese të tjera që lidhen me sigurinë dhe stabilizimin, **ndërtimin e paqes, drejtësinë tranzitore / kalimtare** dhe ndërtimin e shtetit dhe të kombit, mbivendosen ndaj çështjeve humanitare dhe të zhvillimit gjatë fazës së rimëkëmbjes së menjëhershme.

Në mënyrë të ngjashme, edhe për trashëgiminë kulturore, rimëkëmbja e menjëhershme në situatat pas konfliktit duhet të kontribuojë në transformimin e konfliktit, p.sh., duke përdorur rimëkëmbjen e trashëgimisë kulturore për të krijuar besim dhe për të kapërcyer përçarjet shoqërore.

Veprime të rekomanduara gjatë rimëkëmbjes së menjëhershme

Seksioni i mëposhtëm përshkruan veprimet që mund të ndërmerren në fazën e rimëkëmbjes së menjëhershme për të nxitur rikuperimin dhe rehabilitimin e trashëgimisë kulturore që është dëmtuar. Për të ndihmuar në arritjen e suksesit, është e rëndësishme që këto veprime të drejtohen nga institucionet e prekura brenda sektorit të kulturës dhe të zbatohen në konsultim me palët e interesit, aktorët dhe komunitetet vendase.

1 Analiza e situatës pas ndihmës së parë

Për të zhvilluar një plan veprimi për rimëkëmbjen dhe rehabilitimin e trashëgimisë kulturore pas krizës, është e rëndësishme të rishikohet dhe të përditësohet **analiza e situatës** (shihni faqen 25), e cila ishte kryer para planifikimit dhe dhënies së ndihmës së parë.

Për një emergjencë të shkaktuar nga konflikti, një analizë e situatës pas ndihmës së parë duhet të zgjerohet për të përfshirë një **analizë konflikti** (shihni faqen 38). Kjo do të lejojë përfshirjen e strategjive për parandalimin e konfliktit dhe ndërtimin e paqes në procesin e rindërtimit dhe të rehabilitimit të trashëgimisë kulturore.

Në veçanti është e rëndësishme të rishikoni:

- natyrën dhe shkaqet e ngjarjes që shkaktoi dëmtimin e trashëgimisë kulturore;
- cenueshmëritë ekzistuese shoqërore, politike dhe ekonomike;
- rëndësinë dhe vlerat shoqëruese të trashëgimisë kulturore që është prekur;
- hartën e **aktorëve dhe palëve të interesit** (shihni faqen 33), si dhe vlerësimin e roleve dhe interesave të tyre përkatëse në rimëkëmbjen dhe rehabilitimin.





Është thelbësore të merret në konsideratë fakti që aktorët e përfshirë në procesin e ndihmës së parë dhe fazat e rimëkëmbjes mund të jenë gjithnjë të ndryshëm. Mund të shfaqen aktorë të rinj (p.sh., aktorë të zhvillimit), ndërsa të tjerët, si zjarrfikësit ose personeli i mbrojtjes civile do të tërhiqen gjatë rimëkëmbjes së menjëhershme. Për më tepër, disa aktorë mund të ndryshojnë rolet e tyre dhe të kenë detyra të ndryshme gjatë rimëkëmbjes së hershme, krahasuar me ato të ndërmarra gjatë përgjigjes ndaj emergjencës. Për këtë arsye, është thelbësore që të rishikohen analiza dhe harta e aktorëve dhe palëve të interesit.

- Gjendjen e përgjithshme të trashëgimisë kulturore pas zbatimit të ndihmës së parë dhe risqet me të cilat përballet.
- Llojin e trajtimeve konservuese dhe zvogëlimin e riskut që kërkohet për rimëkëmbjen e plotë të trashëgimisë kulturore që është prekur.
- Burimet e kërkuara për rimëkëmbjen e trashëgimisë kulturore.

2 Vlerësimi i gjendjes

Përdorni të dhënat e **analizës së situatës pas ndihmës së parë** për të identifikuar pasuritë kulturore që kërkojnë vlerësim të hollësishëm të gjendjes për rimëkëmbje dhe rehabilitim. Vlerësimi i gjendjes ndihmon në identifikimin e përparësive për rimëkëmbje. Një vlerësim i gjendjes pas ngjarjes zakonisht përfshin vlerësimin e:

- dëmit të shkaktuar dhe humbjeve të të ardhurave (shikoni **PDNA**-n në faqen 64);
- proceseve të përkeqësimit që ndikojnë në trashëgiminë kulturore, për shembull, kristalizimi i kripërave në sipërfaqen e muraturës dhe çngjyrosja për shkak të ekspozimit të tepërt në dritë;
- veprimeve të sigurimit (vënies në siguri) dhe të stabilizimit të ndërmarra gjatë operacionit të ndihmës së parë;
- dobësive dhe risqeve ekzistuese dhe sidomos të proceseve aktive të përkeqësimit, që e bëjnë trashëgiminë të cenueshme nga fatkeqësitë e ardhshme.

Vlerësimet e gjendjes pas ngjarjes duhet të dokumentohen brenda një raporti që përmban: dokumentacion fotografik të detajuar të dëmit, përkeqësimit dhe risqeve; inventarët e përditësuar; hartën e shtit dhe planimetritë. Përfshini detajet e ndihmës së parë që është dhënë, të marra nga dokumentacioni i mbledhur gjatë **sigurimit dhe stabilizimit** (shihni faqen 68) të pasurive të trashëgimisë kulturore.

Një vlerësim i tillë mund të përfshijë studime analitike, si testi i fortësisë për llaçe të ndryshme ose analiza e adezivëve dhe e pigmenteve të përdorura në një pikturë. Kur është e mundur, përdorimi i mjeteve teknologjike, si skaneri me **lazer 3D ose fotogrametria** mund të sigurojë matje të sakta, të cilat janë të rëndësishme për restaurimin e plotë. Niveli i dokumentimit do të varet shumë nga rëndësia e trashëgimisë që është prekur, nga shkalla e dëmtimit dhe burimet në dispozicion.

Në vlerësimin e gjendjes duhet të angazhohen ekipe profesionistësh nga disiplina të ndryshme, të cilat mund të përfshijnë restauratorë, arkitektë, kuratorë, inxhinierë konstruktorë, kimistë, antropologë dhe historianë. Përbërja e ekipit do të varet nga natyra e trashëgimisë së prekur. Konsultimet me administratorët dhe përfaqësuesit e komunitetit vendas janë thelbësore për një vlerësim gjithëpërfshirës.

3 Zhvillimi i mekanizmave për bashkërendimin (koordinimin), pjesëmarrjen dhe ngritjen e kapaciteteve

Pas një fatkeqësie në shkallë të gjerë, institucioneve kulturore lokale dhe komuniteteve të prekura mund t'u mungojnë aftësitë e specializuara, pajisjet, fondet dhe / ose qasja e mekanizmave institucionale për të rimëkëmbur trashëgiminë kulturore. Faza e rimëkëmbjes së menjëhershme mund të përdoret: për të përcaktuar burimet e nevojshme për rimëkëmbjen; për forcimin e kapaciteteve lokale; dhe për të filluar trajnimin në mënyrë që të përmirsohen aftësitë, njohuritë dhe politikat institucionale.

Gjatë fazës së rimëkëmbjes së menjëhershme është thelbësore të koordinohet plani për rimëkëmbjen dhe rehabilitimin e trashëgimisë kulturore me planet përkatëse të sektorëve të tjerë dhe, në të njëjtën kohë, të zhvillohen mekanizma për të përfshirë popullsinë e prekur. Për shembull, gabimisht, mund të krijohen rregullore ose politika të reja ndërtimi në lidhje me përdorimin e tokës, të cilat mund të jenë të dëmshme për rimëkëmbjen e trashëgimisë së ndërtuar dhe përdorimin e saj në të ardhmen. Në mënyrë të ngjashme, komunitetet mund të kenë disa përparësi të caktuara lidhur me faktin se cila trashëgimi do të duhet të rimëkëmbet më së pari.



Duhet të bëhen përpjekje për të përdorur aftësitë dhe njohuritë tradicionale të komuniteteve vendase dhe për t'i angazhuar ato në planifikimin e rimëkëmbjes. Në fakt, faza e rimëkëmbjes së menjëhershme mund të përdoret për ta përfshirë komunitetin në zhvillimin e mundësive për rimëkëmbjen dhe ripërdorimin krijues të trashëgimisë kulturore.

Ju mund të përdorni rezultatet e analizës së situatës pas ndihmës së parë për të identifikuar se cilët aktorë apo grupe interesi duhet të përfshihen në rimëkëmbjen e trashëgimisë kulturore.



Roli i nismave nga poshtë-lart, të bazuara te komuniteti për rimëkëmbjen kulturore dhe sociale të qytetit të Aquila-s, Itali

Më 6 prill 2009, një tërmet me magnitudë 6.1 i shkallës Rihter goditi rajonin e Abruzzo-s në Apeninet Qendrore, Itali, duke shkaktuar dëme të mëdha në kryeqendrën Aquila dhe në pesëdhjetë qytete përreth.

Pas kësaj, Departamenti Italian i Mbrojtjes Civile menaxhoi menjëherë operacionet e shpëtimit gjatë fazës së emergjencës. Njerëzve iu siguroa strehim emergjent dhe qendra historike e qytetit u evakuua plotësisht, u rrethua dhe u shpall zonë e kuqe për shkak të dëmtimit të madh.

Për banorët e Aquila-s, qendra historike e qytetit kishte shërbyer gjithmonë si një hapësirë e gjallëruar sociale dhe ekonomike, ku njerëzit takoheshin, bashkëvepronin dhe argëtoheshin. Sheshet e qytetit dhe hapësirat publike ishin thelbësore për jetën e tyre të përditshme dhe për kulturën. Pas fatkeqësisë, pamundësia e qasjes në afatgjatë në këto hapësira u ndje shumë, pasi njerëzve u mungonin ato vende për të bashkëvepruar.

Si përgjigje, qytetarët e Aquila-s ndërmorën nisma të ndryshme me bazë komunitare, duke marrë pjesë në rimëkëmbjen e qytetit dhe lagjeve të tyre. Një nismë e tillë është 'Viviamolaq', e formuar nga studentë dhe të diplomuar të Universitetit të Aquila-s.

Përmes ripërdorimit të hapësirave urbane dhe zonave të braktisura, 'Viviamolaq' mbështet rimëkëmbjen sociale, urbane dhe kulturore. Projektet bazohen në parimet e qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale dhe shërbejnë si katalizatorë për të rritur kohezionin





shoqëror dhe veprimet kolektive. Pjesëmarrja dhe bashkëpunimi janë thelbësore për të gjitha projektet e kësaj nisme nga faza e planifikimit krijues deri në fazën e ndërtimit.

Kjo ishte fryma e projektit “Restart” (Rifillim), i cili erdhi në jetë në vitin 2014. Projekti “Restart” ripërdori një hapësirë publike të braktisur, që ndodhej përpara Departamentit të Shkencave Humane të Universitetit të Aquila-s, për të krijuar një hapësirë publike për kalimin e kohës së lirë për studentët dhe komunitetin lokal. Materialet e ricikluara nga procesi i rindërtimit (inerte së bashku me çelikun dhe drurin e përdorur më parë për pajandimin e ndërtesave të dëmtuara) u vunë në përdorim për të ndërtuar mobilim urban. Integrimi i kujtimit të fatkeqësisë (materialet e ricikluara) në një projekt të ri është thelbësor për forcën e “Restart”-it: dhe dëshmon për mundësinë e rimëkëmbjes dhe mënyrën sesi është e mundur të zhvillohet përtëritja dhe kohezioni social në fazën pas fatkeqësisë.

Pasi u pa që kjo lloj përqsasje për rimëkëmbjen e qytetit të Aquila-s pati sukses në komunitet, përqsasje që përqëndrohen te komuniteti u zbatuan gjithashtu edhe në përgjigjen pas tërmetit dhe fazën e rimëkëmbjes në Emilia Romagna në vitin 2012, dhe së fundi edhe në Italinë qendrore në vitet 2016 dhe 2017.

Burimi: Valentina Spano, (MA), Universiteti i Teknologjisë së Brandenburgut Cottbus- Senftenberg, ish-praktikante, Njësia e Koleksioneve, ICCROM.

Shikoni referencat në faqen 167.



Projekti “Restart”: përdorimi i inerteve të ricikluara të fatkeqësisë nga qendra historike e qytetit të Aquila-s për të rikrijuar hapësirat publike. Foto: Valentina Spano





Ngritja e kapaciteteve për artizanët: drejt rimëkëmbjes së bizneseve të vogla në Haiti

Tërmeti i vitit 2010 që goditi Haitin, la një numër të madh artizanësh të qendrës kryesore të zejeve të vendit, Jacmel, pa shtëpi, pa vende pune, pa mjete apo materiale. Tërmeti ndodhi në janar, periudhë kjo e ngarkuar për artizanët, pasi në këtë kohë ata përgatiten për karnavalet e përvitshme. Gjatë kësaj periudhe, shumë artizanë madje marrin hua për të blerë lëndë të parë të mjaftueshme për krijimin e kostumeve të veçanta të karnavaleve. Sidoqoftë, me shembjen e shtëpive dhe të vendeve të punës gjatë tërmetit, ata gjithashtu humbën stokun e tyre dhe punët e përfunduara, gjë që ua bëri të pamundur pagesat e huave.

Gjatë fazës së ndihmës së parë, vëmendja iu kushtua sigurimit të strehimit të përkohshëm dhe shërbimeve ndaj komunitetit. Sidoqoftë, gjatë fazës së rimëkëmbjes së menjëhershme, UNESCO-ja punoi me artizanët për të rindërtuar bizneset e tyre, duke u siguruar atyre një vend pune të përbashkët (të përkohshëm) dhe një vend për të shitur punët e tyre, si dhe pajisjen me materialet dhe mjetet që u nevojiteshin për të rifilluar punën.

Meqenëse tregu nuk ishte prekur në shkallë kaq të madhe, mbështetja u krijua në mënyrë të tillë që t'u mundësonte artizanëve rifillimin e punës, me mirëkuptimin se gjithçka që nevojitej ishte që ata të kapërcenin borxhin dhe humbjen e të ardhurave si rezultat i tërmetit. Sapo artizanët të ishin në gjendje të rifillonin prodhimin, shumica e tyre do të ishin në gjendje të rimëkëmbeshin.

Burimi: Elke Selter, Shkolla e Studimeve Orientale dhe Afrikane, Universiteti i Londrës, Mbretëria e Bashkuar-



Maska letre "mâché" që presin të zbukurohen për karnavalet në Jacmel, 2012. Foto: Elke Selter.



Artizanat në Jacmel, Foto: Elke Selter.

4 Vlerësoni përdorimin, funksionimin dhe kuptimin e trashëgimisë kulturore

Pas një fatkeqësie, mundësitë për rimëkëmbjen e trashëgimisë kulturore ndikohen nga përdorimet e saj të mundshme në të ardhmen dhe nga aftësia për të përmbushur nevojat pas krizës së institucionit ose të komunitetit të prekur. Vendimet për të ndryshuar përdorimin ose funksionin e trashëgimisë kulturore mund të jenë të debatueshme dhe duhet të bazohen në një konsensus të gjerë publik, i cili mund të vendoset gjatë fazës së rimëkëmbjes së menjëhershme.

Në mënyrë të ngjashme, në situata pas konfliktit, në mënyrë që të parandalohet përsëritja, diskutimet rreth trashëgimisë kulturore mund të kenë nevojë të bëhen më gjithëpërfshirëse, për të përfaqësuar komunitetet e lëna me një anë. Përpjekje të tilla duhet të jenë transparente dhe të përfshijnë konsultime me komunitetet e prekura, si dhe të gjitha palët në konflikt.

Në shumë raste, një komunitet i prekur mund të dëshirojë të krijojë trashëgimi të re, duke i kthyer vendet e shkatërrimit në memoriale; duke krijuar monumente të reja për fatkeqësinë; ose duke organizuar ngjarje përkujtimore që, me kalimin e kohës, marrin formën e trashëgimisë së re jomateriale. Një shembull i kohëve të fundit i mirënjohur është “Ground Zero” (Niveli zero) në New York, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Narrativa të tilla të reja mund të përfshijnë gjithashtu edhe objekte dhe institucione kulturore. Muzeu i Aparteid-it dhe Muzeu i Qarkut Gjashtë në Afrikën e Jugut janë shembuj të fuqishëm se si institucionet kanë shërbyer për të kontribuar në rimëkëmbjen dhe dialogun.

Disa komunitete i japin përparësi aspektit jetësor të trashëgimisë kulturore dhe zgjedhin të heqin të gjitha gjurmët e shkatërrimit. Në raste të tilla, vendimet mund të merren gjithashtu për të zëvendësuar trashëgiminë me një strukturë krejtësisht të re. Një shembull është restaurimi i Tempullit të Relikteve të Dhëmbëve të Budës në Sri Lanka, i cili u dëmtua rëndë nga një bombë në vitin 1998. Në raste të tjera, rehabilitimi i jep përparësi aspektit material të trashëgimisë dhe kryhet në atë mënyrë që nuk lë prova të shkatërrimit, p.sh., qendra historike e qytetit të Varshavës, Poloni, pas Luftës së Dytë Botërore. Sigurisht shumë përpiqen të pajtojnë këto dy përfaqesje. Gjatë viteve të fundit, shumë novacione teknologjike janë shtuar në gamën e opsioneve për rimëkëmbje, duke rezultuar në projekte tre dimensionale me lazer të trashëgimisë së shkatërruar, si p.sh., në **Bamiyan** ose printimi 3D në shkallë reale, si p.sh., rasti i **Harkut të Palmirës**.

Shikoni referencat në faqen 167.





Magazina të hapura: ripërdorimi i përshtatur në Muzeun Kombëtar të Nepalit gjatë fazës së rimëkëmbjes së menjëhershme

Menjëherë pas tërmetit në Gorkha në vitin 2015, dhjetë muzeve, përfshirë edhe Muzeun Kombëtar të Nepalit, iu desh të evakuonin koleksionet e tyre nga ndërtesat e dëmtuara rëndë, të cilat u shpallën të pasigurta për përdorim. Për arsye sigurie, koleksionet e evakuuara u ruajtën përkohësisht në sallat e ekspozimit në muzetë përkatës, gjë që, nga ana tjetër, çoi në mbylljen e tyre të pjesshme. Në fazën e rimëkëmbjes së hershme, ICCROM-i, në bashkëpunim me Departamentin e Arkeologjisë dhe me mbështetjen e Ministrisë Norvegjeze të Klimës dhe Mjedisit, zhvilluan trajnime për stafin e muzeve të prekur, për të krijuar magazina të hapura por të sigurta, duke pasur si qëllim të dyfishtë qoftë rimagazinimin e koleksioneve të zhvendosura, qoftë sigurimin e hapësirave të reja ekspozuese për të tërhequr vizitorë.

Shikoni referencat në faqen 167.



Përdorimi i përshtatur pas fatkeqësisë: një sistemim i përkohshëm, i dukshëm dhe i sigurt në Muzeun Kombëtar të Nepalit, krijuar për të magazinuar koleksionet e zhvendosura dhe për të sjellë vizitorët përsëri në muze, 2016.

Foto: Aparna Tandon, ICCROM.

5 Mbledhja e burimeve

Periudha ndërmjet ndihmës së parë dhe rimëkëmbjes së trashëgimisë kulturore duhet të përdoret për të grumbulluar burime nga agjenci të ndryshme, si qeveritë kombëtare dhe lokale, organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare të dhënies të fondeve të asistencës dhe institucionet e trashëgimisë kulturore. Raportet e vlerësimeve të gjendjes pas ndihmës së parë janë veçanërisht të dobishme në artikullimin e nevojave të rimëkëmbjes pas krizës. Përfshirja e të gjitha palëve të interesit dhe aktorëve të mundshëm në sigurimin e burimeve të nevojshme, ndihmon për të siguruar që proceset e rimëkëmbjes dhe të rehabilitimit të trashëgimisë kulturore të drejtohen nga nevoja dhe dëshira të përcaktuara në nivel lokal, jo nga përparësitë e donatorëve.

Për të promovuar përgjegjësinë dhe transparencën është e nevojshme të vendosen mekanizma efektivë për komunikimin me donatorët, qeverinë, grupet e interesit dhe publikun e gjerë.

Përfundime

Kuadri me tre hapa i përshkruar në këtë Udhëzues rrit gatishmërinë për ndihmën e parë ndaj trashëgimisë kulturore të koordinuar, e cila çon në rimëkëmbje të menjëhershme. Sidoqoftë, hamendësimi se progresioni midis secilit hap është linear, ose ndjek kornizat kohore të përcaktuara qartë, nuk përputhet me praktikën aktuale. Kur ndodh një emergjencë madhore ose komplekse, ndihma e parë kulturore për nënrajone të ndryshme gjeografike mund të duhet të kryhet në periudha të ndryshme kohore. Zbatimi i saj varet nga qasja e sigurt dhe e pandërprerë në trashëgiminë kulturore që është prekur dhe nga kapacitetet ekzistuese kombëtare dhe / ose lokale.

Për më tepër, nëse gjatë rimëkëmbjes së hershme trashëgimia kulturore mbetet e cenueshme, mund t'ju duhet të ripërsëritni operacionet e ndihmës së parë në rastin e një emergjence tjetër, p.sh., përsëritja e një tërmeti ose rikthimi i një konflikti.

Menaxhimi i vazhdueshëm i riskut, **planifikimi i emergjencave**, koordinimi midis aktorëve të ndryshëm dhe palëve të interesit, si dhe rritja e kapaciteteve për të ulur cenueshmërinë e mundshme midis institucioneve të trashëgimisë dhe komuniteteve lokale, janë thelbësore për ta bërë trashëgiminë më të qëndrueshme ndaj fatkeqësive dhe konflikteve.





FJALOR

Aktor

Një organizatë, komunitet ose individ që bashkëvepron drejtpërdrejt brenda një sistemi. Një aktor është gjithmonë një palë interesi, por jo të gjitha palët e interesit janë aktorë, pasi jo domosdoshmërisht bashkëveprojnë drejtpërdrejt me sistemin, por janë të interesuar mbi sjelljen dhe rezultatet e arritura nga aktorët. (Cockburn, 2001, fq. 53).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/8LKF-RYNJ>

Bashkërendimi / Koordinimi

Bashkërendimi / Koordinimi është “bashkëpunimi midis palëve të interesit ose aktorëve, për të përmirësuar rezultatet apo rendimentin, gjatë një përpjekjeje kolektive, ose si përgjigje ndaj një çështjeje, ngjarjeje ose konteksti të përbashkët”. (ICVA, n.d.).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/67A2-74YY>

Cenueshmëria

Karakteristikat dhe rrethanat e një komuniteti, sistemi ose prone / pasurie që e bëjnë atë të ndjeshëm ndaj efekteve dëmtuese të një rreziku. Faktorët mund të jenë fizikë, socialë, ekonomikë dhe mjedisorë. Cenueshmëria mund të ndryshojë ndjeshëm brenda një komuniteti dhe me kalimin e kohës. (UNIDSR, 2009, fq. 30).

UNIDSR: <https://perma.cc/85M4-6TB9>

Dëmi

Një cenim fizik ndaj vlerave, përdorueshmërisë, apo funksionit të diçkaje. (“Oxford Living Dictionary”, 2017).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/5XGA-8SYQ>

Dokumentimi

Dokumentimi është një tekst përshkrimor ose mjet pamor që përdoret për të përcaktuar ose përshkruar një objekt, model, specifikim, udhëzim ose procedurë. Si aktivitet, ai përfaqëson mbledhjen sistematike dhe arkivimin e të dhënave, në mënyrë që t'i ruajë ato si referencë në të ardhmen. (UNECE, 2000, f. 12; Letellier, 2007, fq. xv)..

Lexoni më shumë:

UNECE, 2000: <https://perma.cc/NG4Z-V7YE>

Letellier, 2007: <https://perma.cc/QW3W-FA9U>

Drejtësia kalimtare / tranzitore

Drejtësia kalimtare / tranzitore përfshin proceset dhe mekanizmat gjyqësore dhe jogjyqësore, bashkë me nismat e ndjekjes penale, lehtësimin e nismave në lidhje me të drejtën për të vërtetën, shpërndarjen e dëmshpërblimeve, reformën institucionale dhe konsultat kombëtare. (“United Nations Secretary-General”, 2010, fq. 2).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/A8H5-DPTK>

Drejtues i operacionit

Individi përgjegjës për të gjitha aktivitetet e incidentit, përfshirë zhvillimin e strategjive, të taktikave, renditjen dhe shpërndarjen e burimeve. Drejtuesi i operacionit ka gjithë autoritetin dhe përgjegjësinë për kryerjen e operacioneve në lidhje me incidentin dhe është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha operacioneve në vendin e ngjarjes. (FEMA, fq. 5).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/CF9H-D462>

Emergjencë

Një ngjarje e papritur dhe zakonisht e paparashikuar, që kërkon masa të menjëhershme për të minimizuar pasojat e saj të pafavorshme (UNDHA 1992). Një emergjencë mund të klasifikohet si **madhore** nëse prek një pjesë të konsiderueshme të popullsisë dhe karakterizohet nga humbje të mëdha. Në situata të tilla, pushteti lokal mund të kërkojë ndihmë nga jashtë, duke përfshirë agjenci të shumta. Një emergjencë madhore mund të përfshijë dëmtime në shkallë të gjerë të trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale, si për shembull, tërmeti i vitit 2015 në Nepal.

Një **emergjencë komplekse** i referohet një krize humanitare që kombinohet me rreziqe të sigurisë, shqetësime politike dhe civile dhe pengesa për ndihmën humanitare. Emergjencat komplekse kanë shumë shkaqe dhe kërkojnë përgjigje të koordinuara ndërkombëtare, të cilat tejkalojnë mandatin ose kapacitetin e një agjencie të vetme. Shpesh, emergjencat komplekse kanë një cikël shumë më të gjatë se emergjencat e papritura.

Emergjencat komplekse mund të përfshijnë shkatërrimin e qëllimshëm të trashëgimisë kulturore, siç janë ato që janë dëshmuar në konfliktet e fundit në Irak, Siri, Somali dhe Mali. Brenda sistemit të OKB-së, një **emergjencë madhore ose komplekse** zakonisht klasifikohet si një emergjencë e Nivelit 3. Pasi të jetë deklaruar ky status, aktivizohet një mekanizëm që përfshin sistemin e OKB-së në tërësi.

Një **emergjencë e Nivelit 2 ose N2** është një emergjencë më pak e rëndë dhe mund të kërkojë ndonjë ndihmë nga OKB-ja. Ndërsa **Niveli 1** është një emergjencë e lokalizuar, e cila mund të trajtohet nga një shtet pa ndihmë nga jashtë.

Lexoni më shumë:

IASC, 1994: <https://perma.cc/973S-7TEU>

IASC, 2012: <https://perma.cc/CQU7-FLK2>

ICDO, 2017: <http://www.icdo.org/en/disasters>

IFRC, 2017: <https://perma.cc/X8XD-HBC6>

UNDHA, 1992: <https://perma.cc/F5AP-ACVD>

Emergjencë e shkaktuar nga rreziqe natyrore

Emergjencat e shkaktuara nga rreziqet natyrore janë ngjarje të shkaktuara nga dukuri natyrore ekstreme që prekin seriozisht shoqërinë, ekonominë dhe / ose infrastrukturën e një rajoni. Në varësi të cenueshmërisë së popullatës dhe kapacitetit lokal të përgjigjes, fatkeqësitë natyrore mund të paraqesin sfida dhe probleme të një natyre humanitare. Shembujt përfshijnë: tërmete, cunami, uragane, përmbytje, zjarre masive në pyje, shpërthime vullkanike, rrëshqitje toke dhe epidemi. (IFRC, 2017; IASC, 2011).

Lexoni më shumë:

IFRC, 2017: <https://perma.cc/WP7R-ELK8>

IASC, 2011: <https://perma.cc/85SP-6HKW>

Emergjencë e shkaktuar nga njeriu

Emergjencat e shkaktuara nga njeriu janë ngjarje të shkaktuara nga aktivitetet njerëzore që ndikojnë ndjeshëm në popullatë dhe mjedis. Shembujt përfshijnë: aksidente bërthamore dhe radioaktive, çlirime të lëndëve kimike, shktretëzimi i tokës, ndotja e mjedisit, konfliktet, epidemitë dhe zjarret. (ICDO, 2017; UNISDR 2018).

Lexoni më shumë:

ICDO, 2017: <http://www.icdo.org/en/disasters/>

UNISDR, 2018: <https://perma.cc/6PKN-W9ND>

Fasha shtrënguese perimetrale

Një sistem fashash që vepron si një rrip shtrëngues për të parandaluar që muret e dëmtuar të shemben nga jashtë. (Kelley, 2010, f. 10).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/PNF6-CEL9>

Fatkeqësi

Një ndërprerje serioze e funksionimit të një komuniteti ose shoqërie, që përfshin humbje të mëdha në njerëz, materiale, ekonomi dhe mjedis, dhe ndikon në atë masë që tejkalon mundësitë e komunitetit apo shoqërisë përkatëse për ta përballuar me burimet e veta. (UNISDR, 2009, p. 9).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/85M4-6TB9>

Fotogrametria

Fotogrametria është një metodë për matjen e saktë të përmasave të një objekti, monumenti ose peizazhi, përmes përdorimit të informacionit fotografik digjital. Pikat e referencës në secilën shkrepje fotografike shërbejnë si pika lidhjeje për të bashkuar imazhet. Kur përdoret një skaner lazer 3D, fotogrametria lejon të dhëna skanimi jashtëzakonisht të sakta. (“Cultural Heritage Imaging”, 2018).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/Z4YF-WWSW>

Grup / grupim

Një grup i organizatave humanitare, qoftë pjesë e OKB-së apo jashtë OKB-së, përgjegjëse për koordinimin e sektorëve kryesorë të veprimit humanitar, si p.sh., uji, shëndeti dhe logjistika. Ato përcaktohen nga “Inter-Agency Standing Committee” (IASC) - Komiteti i Përhershëm ndër-Agjencor, (“Humanitarian Response”, 2017).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/TRD5-YFMG>

Inventar

Një listë e hollësishme e pasurive dhe burimeve aktuale: siç mund të jetë një katalog në pronësi të një individi, [organizate] ose pasuri e paluajtshme. (“Merriam-Webster”, 2017).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/V2C8-YBA9>

Kapacitet

Kombinimi i të gjitha forcave,tributeve dhe burimeve të disponueshme brenda një komuniteti, shoqërie apo organizate për të menaxhuar dhe për të zvogëluar risqet ndaj fatkeqësive dhe për të forcuar aftësinë përtëritëse. Kapaciteti përfshin: infrastrukturën, institucionet, njohuritë dhe aftësitë njerëzore dhe atributet kolektive, siç janë marrëdhëniet shoqërore, aftësitë drejtuese dhe menaxhimi (UNISDR, 2017).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/L88V-8EBA>

Komunikim

Dhënia ose shkëmbimi i informacionit i cili mund të jetë me gojë, me shkrim apo me mjete të tjera në dispozicion; transmetimi ose ndarja e suksesshme e ideve dhe e ndjenjave (“Oxford Living Dictionary”, 2017).

Lexoni më shumë: <https://en.oxforddictionaries.com/definition/communication>

Kontaminues / Ndotës

Termi ndotës në koleksionet muzeore i referohet çdo materiali kimik ose biologjik të gjetur në sendet muzeore, që paraqet një rrezik të mundshëm për ata që i

përdorin ose kujdesen për to. Kontaminuesi mund të jetë i brendshëm, siç është prania e metaleve të rënda që gjenden te pigmentet. Ai mund të jetë marrë më vonë pa dashje nga jashtë ose përmes trajtimeve, si ato me konservues kimikë apo me aplikim pesticidesh.

(Departamenti i Brendshëm i SHBA-së, 2006, f. 1).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/DX5W-UJN8>

Koordinator i përgjigjes ndaj emergjencave

Koordinatori i përgjigjes ndaj emergjencave (“Emergency Response Coordinator”, ERC) i referohet personit përgjegjës për koordinimin e të gjitha veprimtarive të përgjigjes dhe rimëkëmbjes gjatë një situatë emergjente. (Dorge & Jones, 1999, fq. 4).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/QZ7N-BRCK>

Mbingarkesë

Kur ngarkesa është më e madhe se ngarkesa që mund të mbajë vetë struktura, atëhere kemi mbingarkesë të saj. Kjo ngarkesë mund të shkaktojë shembje apo kolaps të strukturës.

Lexoni më shumë:

Merriam-Webster, 2017: <https://perma.cc/3BWH-FSC4>

Levy & Salvadori, 1992: <https://perma.cc/B3XW-HJ4F>

Menaxhim i riskut

Përçasja dhe praktika sistematike e menaxhimit të pasigurisë për të minimizuar dëmin e mundshëm. (UNISDR, fq. 26–27).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/85M4-6TB9>

Ndërtim i kapaciteteve shtetërore

Një proces i brendshëm për të rritur kapacitetin, institucionet dhe legjitimitetin e shtetit, të udhëhequr nga marrëdhëniet shtet-shoqëri. (Bailey et al., 2009, fq. 8).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/927F-UPE2>

Ndërtim i paqes

Aktivitetet e ndërmarra nga aktorë kombëtarë ose ndërkombëtarë për të parandaluar konfliktin e dhunshëm dhe për të institucionalizuar paqen, në kuptimin e mungesës së konfliktit të armatosur dhe e përdorimit të mjeteve të politikës pjesëmarrëse, pa patur nevojë për një operacion ndërkombëtar të paqes. (Call & Couzens, 2007 cituar në Bailey et al., 2009, fq. 8).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/927F-UPE2>

Ngarkesë

Forcat me të cilat përballet një strukturë për shkak të peshave që i mbivendosen, ose nën presionin e erës në sipërfaqet e saj vertikale. (Merriam-Webster.com, 2017).

Bazuar në këtë përkufizim, mund të identifikohen lloje të ndryshme të ngarkesave:

- **Ngarkesat statike**; këto rriten ngadalë dhe veprojnë statikisht.
- **Ngarkesat e përhershme**; këto përfshijnë elemente masive të një strukture arkitektonike me peshën tyre vetjake, p.sh., kolona, harqe, trarë, kupola. Në përgjithësi, kjo kategori përfshin të gjitha elementet fikse të palëvizshme.
- **Ngarkesa e përkohëshme**: këto janë ngarkesa të ndryshueshme që lidhen me funksionin dhe qëllimin e strukturës arkitektonike. Kjo kategori përfshin ngarkesën e njerëzve, mobilie, dëborës dhe të tjera.
- **Ngarkesat dinamike**: këto ngarkesa veprojnë në mënyrë dinamike dhe rriten në mënyrë të papritur të menjëhershme, si p.sh., era ose tërmetet. Ato janë shkak i shumë shembjeve dhe shkatërrimit të ndërtesave. (Levy & Salvadori, 1992, fq. 269-276).

Pajandë

Një sistem mbështetës për parandalimin e fundosjes ose përkuljes dhe shmangies nga vertikalliteti.

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/QK5P-TLYX>

Pajandim

Procesi i stabilizimit emergjent për një ndërtesë ose i seksioneve të një ndërtese me pajanda (puntela), i cili ka për funksion të shmangë ngarkesat e ndërtesave që kanë humbur ekuilibrin, duke i shkarkuar ato në tokë në mënyrë të sigurt pa ndikuar në strukturën ekzistuese të elementeve të ndërtesës. Pajandimi mund të jetë vertikal, diagonal ose horizontal. (el-Habashi, 2017).

Përkufizim alternativ:

Pajandimi është një mbështetje e përkohshme për strukturat e paqëndrueshme, të cilat janë identifikuar që mund të dëmtohen, shemben pjesërisht ose plotësisht, duke siguruar qëndrueshmërinë e duhur për mbrojtjen e objektit, punëtorëve dhe publikut. “Një sistem pajandimi duhet të funksionojë si një sistem dopio-hinkë, i cili mbledh ngarkesat nga trarët e qatisë / kulmit dhe i shkarkon ato poshtë, nëpërmjet shtyllave / puntelave në strukturën mbështetëse. (FEMA, 2009).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/WF28-Q5QU>

Palët e interesit

Palët e interesit janë njerëzit që kanë një interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ose që ndikojnë apo ndikohen nga zbatimi dhe rezultati i një ndërhyrjeje. Zakonisht ato përfshijnë individë dhe përfaqësues të komuniteteve, të institucioneve dhe / ose të organizatave dhe agjencive të lidhura me zonën e projektit. Palët e interesit zakonisht ndahen në tri kategori kryesore; parësore, dytësore dhe kyç. (IUCN, n.d.; IFRC, 2010, fq. 16-17).

- **Palët parësore të interesit:** janë ato që janë më të varura ose janë të lidhura drejtpërdrejt me trashëgiminë kulturore që është prekur dhe për këtë arsye ka të ngjarë të ndikohen pozitivisht ose negativisht nga ndonjë ndërhyrje në zonën e projektit. Shembujt përfshijnë bashkësitë fetare të lidhura me një sit të veçantë; grupe indigjene me të drejta mbi pronën; dhe komunitetet e varura nga burimet e trashëgimisë kulturore si pjesë e jetesës së tyre.
- **Palët dytësore të interesit:** nuk janë drejtpërdrejt të varura ose të lidhura me trashëgiminë kulturore që është prekur, por kanë një interes specifik në mënyrën se si menaxhohet ose shfrytëzohet kjo trashëgimi. Ato janë të interesuara për projektin, por kanë ndikim dhe autorizim të kufizuar mbi burimet. Shembujt e palëve të interesit dytësore janë OJQ-të, institucionet arsimore dhe sektori privat.
- **Palët kyç të interesit:** mund të ndikojnë ndjeshëm ose janë jetike për suksesin e çdo ndërhyrjeje të përzgjedhur për të ndihmuar rimëkëmbjen e komunitetit. Palët kyç të interesit mund të përfshijnë departamentet qeveritare dhe ministritë, zotëruesit kryesorë të burimeve dhe donatorët

Lexoni më shumë:

IFRC, 2010: <https://perma.cc/3Q8E-EU7M>

IUCN, n.d.: <https://perma.cc/EG6K-E3TQ>

Pasuri kulturore

Një pasuri kulturore është një send ose vend, vlera e të cilit bazohet në domethënien e tij brenda shoqërisë, njohurive dhe kulturës së një komuniteti ose kombi. Rëndësia e tij rrjedh nga vlerat estetike, historike, shkencore, shoqërore ose shpirtërore. Një pasuri kulturore mund të jetë materiale ose jomateriale. ("Resource Planning and Development Commission", 2003).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/CNS7-SZNA>

Përgjigje

Ofrimi i shërbimeve emergjente dhe të asistencës para dhe gjatë një fatkeqësie, ose menjëherë pas saj, për mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës së trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, për të garantuar sigurinë publike dhe për të përmbushur nevojat themelore për mbijetesën e njerëzve të prekur. (UNISDR, 2009, fq. 24-25).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/85M4-6TB9>

Planifikim për emergjenca

Planifikimi për emergjenca është një mjet menaxhimi i cili analizon risqet e mundshme për ndodhjen e fatkeqësive dhe vendos rregulla paraprake për të mundësuar përgjigje efektive dhe të përshtatshme ndaj një emergjence dhe ndikimit të saj të mundshëm te njerëzit. Planifikimi i emergjencës koordinon dhe përcakton qartë veprimet me rolet e institucioneve, burimet, procedurat e dhënies së informacionit dhe marrëveshjet operationale për aktorët përkatës në kohë nevoje. Kjo i lejon aktorët të parashikojnë dhe të paraprijnë zgjidhjet e problemet që mund të lindin gjatë fatkeqësive. (IFRC, 2017; UNISDR, 2017).

Lexoni më shumë:

IFRC, 2017: <https://perma.cc/W2BZ-U92R>

UNISDR, 2017: <https://perma.cc/L88V-8EBA>

Prioritizim (Përcaktimi i përparësive)

Përcaktimi i rendit për trajtimin e një sërë objektesh ose detyrash sipas rëndësisë së tyre. ("Oxford Living Dictionary", 2017).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/2Z4V-2UKN>

Reaguesit e parë

Një person [...] i cili është ndër ata që janë përgjegjës për të shkuar menjëherë në vendngjarjen e një aksidenti, ose të një emergjence, për të dhënë ndihmën e parë. (Merriam-Webster.com, 2017).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/6CW4-VCTE>

Regjistri themeltar i objekteve

Një regjistër themeltar është një regjistër i përhershëm i të gjitha objekteve që janë pjesë e koleksioneve të përhershme të një muzeu. Ai është dokumenti më i rëndësishëm në sistemin e dokumentacionit të muzeut. Ai përmban informacion në lidhje me objektet e muzeut dhe shërben si një listë zyrtare e koleksioneve për të cilat muzeu është përgjegjës. ("Collections Trust", 2018).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/J4GF-WHWN>

Rehabilitimi

Rivendosja e shërbimeve dhe e strukturave themelore për funksionimin e një komuniteti ose të një shoqërie të prekur nga një fatkeqësi. (UNISDR, 2017).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/L88V-8EBA>

Restaurimi

Akti, ose procesi, i paraqitjes së saktë të formës, veçorive dhe karakterit të një prone ashtu siç dukej në një periudhë të caktuar kohe, nëpërmjet heqjes së tipareve të fituara nga periudha të tjera gjatë historisë së saj, si dhe nëpërmjet rindërtimit të tipareve që kanë humbur prej asaj periudhe që do merret si baza për restaurimin. Përmirësimi i kufizuar dhe i ndjeshëm i sistemeve mekanike, elektrike dhe hidraulike dhe i punimeve të tjera të kërkuara nga kodet e ndryshme, për t'i bërë pronat funksionale dhe të përshtatshme brenda një projekti restaurimi. (Tolles et al., 2002, fq. 120).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/6TCW-WUPX>

Rëndësia (domethënia)

Kuptimi dhe vlerat e një objekti, koleksioni ose tradite dhe çka i bën ato të rëndësishme. Rëndësia përbëhet nga vlerat historike, estetike, shkencore dhe sociale që një pasuri kulturore ka për brezat e shkuar, të tashëm dhe të ardhshëm. (Russell & Winkworth, 2009).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/GJ8G-ERAN>

Rimëkëmbja

Rivendosja ose përmirësimi i mjeteve të jetesës dhe të shëndetit, pasurive ekonomike, fizike, shoqërore, kulturore dhe mjedisore, sistemeve dhe aktiviteteve të një komuniteti ose shoqërie të prekur nga fatkeqësitë, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe konceptit “rindërto më mirë”, për të shmangur ose zvogëluar riskun e fatkeqësive të ardhshme. (UNISDR, 2017).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/L88V-8EBA>

Rindërtimi

Akti, ose procesi, i paraqitjes me anë të një ndërtimi të ri së formës, tipareve dhe detajimit të një siti, peizazhi, ndërtese, strukture ose objekti të shkatërruar, me qëllim përsëritjen e pamjes së tij nga një periudhë e caktuar kohore dhe në vendndodhjen e tij historike. (Tolles et al., 2002, fq. 120).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/6TCW-WUPX>

Rindërto më mirë

Integrimi i masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë në restaurimin e infrastrukturës fizike dhe sistemeve shoqërore dhe rijetëzimi i mjeteve të jetesës, ekonomive dhe mjedisit. (UNISDR, 2017).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/3D78-H6DJ>

Risk

Risqet në situata emergjente janë në thelb ndikimet e mundshme negative në jetën e njerëzve, në komponentët e trashëgimisë dhe vlerat shoqëruese. Risqet identifikohen duke kërkuar rreziqet e mundshme dhe cenimet ekzistuese të siteve / muzeve dhe komponentëve të trashëgimisë së luajshme dhe asaj të ndërtuar. Risqet përcaktohen gjithashtu si kombinim i mundësive të zhvillimit të një ngjarjeje dhe të pasojave të saj negative. (UNISDR, 2009, fq. 25).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/85M4-6TB9>

Risku nga fatkeqësitë

Humbja e mundshme e jetës, lëndimi, ose shkatërrimi dhe dëmtimi i pasurisë që mund t'i ndodhin një sistemi, shoqërie ose një komuniteti në një periudhë të caktuar kohore, të përcaktuar përmes probabilitetit si një mundësi rreziku, ekspozimi, cenueshmëria dhe kapaciteti. (Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 2016, fq. 14).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/TR42-CA9D>

Rrezik

Një fenomen, substancë, aktivitet njerëzor ose gjendje që konsiderohet e rrezikshme dhe që mund të shkaktojë humbje të jetës, plagosje apo ndikime të tjera shëndetësore, dëmtim të pronës, humbjen e mjeteve të jetesës dhe shërbimeve, ndërprerje të veprimtarisë sociale dhe ekonomike ose degradim mjedisor (UNISDR, 2009, fq. 17). Shiko: **Rreziku emergjent i shkaktuar nga njeriu dhe emergjenca e shkaktuar nga rreziku natyror.**

Lexoni më shumë:

IASC, 2011: <https://perma.cc/85SP-6HKW>

IFRC, 2017: <https://perma.cc/WP7R-ELK8>

UNISDR, 2009: <https://perma.cc/85M4-6TB9>

Rruga e ngarkesës

Rruga apo skema sipas së cilës ngarkesat e një strukture transmetohen në themele. (Jamal, 2017).

Lexoni më shumë:

<https://perma.cc/4KQE-XVQP>

Sistemi i Informacionit Gjeografik (GIS)

Sistemet e Informacionit Gjeografik (GIS) janë mjete kompjuterike të përdorura për vizualizimin, punimin, analizimin e të dhënave hapësinore dhe interpretimin e të gjitha formave të të dhënave me gjeo-referenca për të kuptuar lidhjet, strukturën dhe prirjet në formën e hartave, globeve, raporteve dhe grafikëve. (ESRI, 2018; "National Geographic Society", 2017).

Lexoni më shumë:

ESRI, 2018: <https://perma.cc/W3R9-TGSU>

“National Geographic Society”, 2017: <https://perma.cc/XU43-PRHP>

Sistemi i menaxhimit të emergjencave

Një sistem i vendosur i krijuar për të mundësuar organizimin dhe menaxhimin e burimeve dhe përgjegjësitë për trajtimin e të gjitha aspekteve të emergjencave, në veçanti të gatishmërisë, të përgjigjes dhe të hapave fillestarë të rimëkëmbjes.

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/85M4-6TB9>

Skaner lazer 3D

Është një pajisje që nuk shkakton dëme dhe nuk ka nevojë për kontakt me sipërfaqen, që përdor dritën lazer në mënyrë që të kapë formën fizike të një objekti, ta rilevojë atë në mënyrë digjitale duke reflektuar dritën nga objekti dhe duke e përthyer atë në lentin e kamerës për të krijuar një bazë të dhënash ose “re pikash” bazuar në sipërfaqen e objektit përkatës. Skanimi me lazer 3D është një mënyrë për të kapur madhësinë dhe formën e saktë e një objekti fizik në një prezantim tre-dimensional digjital. Ai është më i përshtatshëm për matjen dhe kontrollin e sipërfaqeve të konturuara jo të sheshta dhe objekteve komplekse që kërkojnë sasi të madhe të të dhënave për përshkrimin e saktë të tyre, i cili do të ishte i vështirë për t’u arritur duke përdorur metodat tradicionale të matjes. (“Historic England”, 2018).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/YLM5-LQL2>

Skeleri

Një strukturë e përkohshme që përdoret për të qëndruar njerëzit dhe materialet gjatë procesit të ndërtimit ose riparimit të ndërtesave. (el-Habashi, 2016).

Stabilizim

Një ndërhyrje ose veprim që synon të ruajë integritetin dhe të minimizojë përkeqësimin e mëtejshëm të trashëgimisë kulturore që mund të jetë e pasigurt, e dëmtuar ose në përkeqësim. Mund të përdoret si masë e përkohshme ose të përfshijë konservimin afatgjatë. (“US National Park Service”, 2015).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/4EVW-LK9W>

Trashëgimia Kulturore

Trashëgimia kulturore mund të përkufizohet si shprehje e mënyrave të jetesës që janë zhvilluar në një komunitet që transmetohet nga brezi në brez, duke përfshirë zakonet, praktikat, vendet, objektet dhe shprehitë artistike dhe vlerat. Shpesh, trashëgimia kulturore karakterizohet si materiale dhe jomateriale. (ICOMOS, 2002).

Trashëgimia kulturore jomateriale

Trashëgimia kulturore jomateriale nënkupton praktikat, paraqitjet, shprehjet, dijet, aftësitë dhe krijimtarinë popullore, si dhe veglat, objektet, artizanatin dhe hapësirat kulturore që një komunitet, grup, ose sipas rastit edhe individët, i pranojnë si pjesë përbërëse të trashëgimisë së tyre kulturore. Kjo trashëgimi kulturore jomateriale, përcjellë brez pas brezi, ripërcaktohet vazhdimisht nga bashkësitë dhe grupet në funksion të mjedisit të tyre, të ndërveprimit të tyre me natyrën dhe të historisë së tyre, dhe u jep atyre ndjenjën e identitetit dhe vazhdimësisë, duke ndihmuar kështu për promovimin e respektit të larmisë kulturore dhe të krijimtarisë tradicionale njerëzore. Një trashëgimi e tillë shprehet përmes folklorit; zakoneve dhe dokeve; gjuhës; artit skenik; ritualeve dhe ngjarjeve festive; sporteve popullore; ushqimeve dhe artit të kulinarisë; mjekësisë dhe farmaceutikës popullore; zejeve tradicionale dhe aftësive të prodhimit; njohurive dhe praktikave që kanë të bëjnë me mjedisin natyror. (ICOMOS, 2002; UNESCO, 2003).

Lexoni më shumë: UNESCO: <http://perma.cc/5ZXN-XCPV>

Trashëgimi kulturore materiale

Trashëgimia kulturore materiale përbëhet nga paraqitja fizike e kulturës së krijuar, të mirëmbajtur dhe të trashëguar nga brezi në brez brenda një shoqërie. E mbushur me domethënie kulturore, trashëgimia kulturore materiale mund të jetë:

- Trashëgimi kulturore e paluajtshme:** vendbanime të njerëzve, përfshirë ndërtesa; fshatra; qyteza dhe qytete, dhe struktura.
- Trashëgimi kulturore e luajtshme:** dokumente dhe arkiva; vepra arti; punime artizanale; vegla muzikore; mobilie; sende, veshje popullore me zbukurime; objekte fetare, objekte ritualesh dhe funeralesh; mjete dhe pajisje mekanike; si dhe sisteme industriale.

Vazhdimësi strukturore

Një strukturë karakterizohet nga vazhdimësia strukturore kur elementet strukturore (trarët, nyjet, kolonat) janë të lidhura me synimin që ngarkesa të transmetohet, shpërndahet dhe tejçohet në mënyrë uniforme në të gjithë strukturën.

Vlerësimi i dëmit

Vlerësimi i dëmit është një vlerësim paraprak në vend dhe dokumentim i dëmit ose humbjes së shkaktuar nga një aksident ose ngjarje natyrore. Vlerësimi i dëmit regjistron shkallën e dëmit dhe atë çfarë mund të zëvendësohet, restaurohet ose shpëtohet. Mund të përdoret gjithashtu për të vlerësuar kohën e nevojshme për riparim, zëvendësim dhe rimëkëmbje. Kjo është thelbësore për të bërë sa më të lehtë një përgjigje efektive nga reaguesit e emergjencave. ("Office of Disaster Management and Preparedness", 2013).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/6PUJ-5Z24>

Vlerësimi i riskut

Gjykim i bazuar mbi mirinformimin dhe një metodologji për të përcaktuar natyrën dhe shkallën e riskut për trashëgiminë kulturore, duke analizuar rreziqet e mundshme të përkeqësimit e të dëmtimit dhe duke vlerësuar kushtet ekzistuese të ekspozimit dhe cenueshmërisë, që së bashku mund të dëmtojnë potencialisht njerëzit e ekspozuar, pronën, shërbimet, jetesën dhe mjedisin e ekspozuar nga i cili varen dhe vlerat përkatëse të trashëgimisë. (Abarquez & Murshed, 2004; UNISDR, 2015).

Lexoni më shumë:

Abarquez & Murshed, 2004: <https://perma.cc/2PU2-V57Q>

UNISDR, 2015: <https://perma.cc/85M4-6TB9>

Zhvillimi i qëndrueshëm

Zhvillim që plotëson nevojat aktuale pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre ("United Nations World Commission on Environment and Development", 1987).

Lexoni më shumë: <https://perma.cc/U3SD-AKMZ>



REFERENCAT

Prezantimi i ndihmës së parë ndaj trashëgimisë kulturore

Abarquez, I. & Murshed, Z. 2004. *Field Practitioners' Handbook, Community-Based Disaster Risk Management*. Thailand, Asian Disaster Preparedness Center. Available at: <https://www.adpc.net/igo/category/ID428/doc/2014-xCSf7I-ADPC-12handbk.pdf> [Accessed 29 April 2018].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/2PU2-V57Q>

Department of Homeland Security Federal Emergency Management Agency. 2017. *ICS Glossary*. Washington, DC, United States Department of Homeland Security. Available at: <https://training.fema.gov/emiweb/is/icsresource/assets/icsglossary.pdf> [Accessed 2 June 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/CF9H-D462>

Dorge, V. & Jones, S.L. 1999. *Building an Emergency Plan: A Guide for Museums and Other Cultural Institutions*. Los Angeles, The Getty Conservation Institute. Available at: http://www.getty.edu/conservation/publications_resources/pdf_publications/pdf/emergency_plan.pdf [Accessed 14 November 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/QZ7N-BRCK>

Hammer, J. 2017. The Salvation of Mosul. *Smithsonian Magazine*. Washington, DC, Smithsonian Institution. Available at: <https://www.smithsonianmag.com/history/salvation-mosul-180964772/> [Accessed 24 December 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/B7YF-NA2S>

Humanitarian Response. 2017. *What is the Cluster Approach?* New York, United Nations Office for the Coordination of Humanitarian Affairs. Available at: <https://www.humanitarianresponse.info/en/about-clusters/what-is-the-cluster-approach> [Accessed 24 December 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/TRD5-YFMG>

Inter-Agency Standing Committee. 1994. Definition of Complex Emergencies. Inter-Agency Standing Committee Working Group XVIth Meeting, 30 November 1994, Geneva, Inter-Agency Standing Committee. Available at: https://interagencystandingcommittee.org/system/files/legacy_files/WG16_4.pdf [Accessed 2 June 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/973S-7TEU>

Inter-Agency Standing Committee. 2011. *IASC Operational Guidelines on the Protection of Persons in Situations of Natural Disasters*. Washington, DC, The Brookings – Bern Project on Internal Displacement. Available at: <https://docs.unocha.org/sites/dms/Documents/Operational%20Guidelines.pdf> [Accessed 27 April 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/85SP-6HKW>

Inter-Agency Standing Committee. 2012. *Humanitarian System-Wide Emergency Activation: Definition and Procedures*. Geneva, Inter-Agency Standing Committee. Available at: https://interagencystandingcommittee.org/system/files/legacy_files/2.%20System-Wide%20%28Level%203%29%20Activation%20%2820Apr12%29.pdf [Accessed 2 June 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/CQU7-FLK2>

International Centre for the Study of the Preservation and Restoration of Cultural Property (ICCROM). 2018. *First Aid to Cultural Heritage in Times of Crisis (FAC)*. Rome, ICCROM. Available at: <https://www.iccrom.org/section/disaster-resilient-heritage/first-aid-cultural-heritage-times-crisis-fac> [Accessed 17 January 2018].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/EEK9-MEZK>

International Civil Defence Organisation. 2017. *Disasters*. Geneva, International Civil Defence Organisation. Available at: <http://www.icdo.org/en/disasters/> [Accessed 2 June 2017].

International Council on Monuments and Sites (ICOMOS). 2002. *ICOMOS International Cultural Tourism Charter, Principles and Guidelines for Managing Tourism at Places of Cultural and Heritage Significance*. Charenton-le-Pont, ICOMOS International Cultural Tourism Committee.

International Council of Voluntary Agencies. n.d. *Definition of Humanitarian Coordination*. Geneva, International Council of Voluntary Agencies. Available at: <https://ngocoordination.org/content/definition-humanitarian-coordination> [Accessed 26 April 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/67A2-74YY>

International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies. 2017. *Complex/Man-Made Hazards: Complex Emergencies*. Geneva, International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies. Available at: <http://www.ifrc.org/en/what-we-do/disaster-management/about-disasters/definition-of-hazard/complex-emergencies/> [Accessed 2 June 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/X8XD-HBC6>

International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies. 2017. *Disaster and crisis management*. Geneva, International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies. Available at: <http://www.ifrc.org/en/what-we-do/disaster-management/> [Accessed 8 June 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/WP7R-ELK8>

Italian Civil Protection Department. 2016. *Terremoto Centro Italia: procedure per la messa in sicurezza dei beni culturali (Earthquake in Central Italy: Procedures for the Safeguarding of Cultural Assets)*. Rome, Italian Civil Protection Department - Presidency of the Council of Ministers. Available (in Italian) at: http://www.protezionecivile.gov.it/jcms/en/view_new.wp?contentId=NEW59794 [Accessed 2 June 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/4H2Q-SFUJ>

Letellier, R. 2007. *Recording, Documentation, and Information Management for the Conservation of Heritage Places, Guiding Principles*. Los Angeles, The Getty Conservation Institute. Available at: http://www.getty.edu/conservation/publications_resources/pdf_publications/pdf/guiding_principles.pdf [Accessed 22 June 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/QW3W-FA9U>

L'Institut de Sauvegarde du Patrimoine National. n.d. *Les bulletins de l'Institut de Sauvegarde du Patrimoine National*. Haiti, l'Institut de Sauvegarde du Patrimoine National. Available (in French) at: <http://www.mappinghaitianhistory.com/new-page/> [Accessed 2 June 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/NFP5-VPZH>

Ministry of Cultural Heritage and Activities and Tourism. 2017. *Emergenza Terremoto e Beni Culturali*. Rome, Ministry of Cultural Heritage and Activities and Tourism. Available (in Italian) at: http://www.beniculturali.it/mibac/export/MiBAC/sito-MiBAC/Contenuti/MibacUnif/Comunicati/visualizza_asset.html_1142856925.html [Accessed 2 June 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/Z7NE-UTHV>

National Disaster Management Authority. 2005. *National Disaster Management Act, 2005*. New Delhi, Government of India. Available at: http://www.ndma.gov.in/images/ndma-pdf/DM_act2005.pdf [Accessed 2 June 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/L86C-E3KS>

National Park Service. 2017. *Definitions – Preservation Maintenance*. Washington, DC, U.S. Department of the Interior. Available at: https://www.nps.gov/dscw/definitionsdc_p.htm#preservmain [Accessed 2 June 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/4EVW-LK9W>

Office of Disaster Management and Preparedness. 2013. *Damage Assessment*. Port of Spain, Government of the Republic of Trinidad and Tobago. Available at: <http://www.odpm.gov.tt/node/70> [Accessed 22 June 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/6PUJ-52Z4>

Oxford University Press. 2018. *Oxford Living Dictionary*. Oxford, Oxford University Press. Available at: <https://en.oxforddictionaries.com/> [Accessed 20 January 2018].

Thapa, M. 2016. *Out of Barracks: Civil-Military Relations in Disaster Management – A Case Study of Nepalese Army's Humanitarian Response during 2015 Earthquake in Nepal*. San José, University for Peace. Available at: <https://www.upeace.org/uploads/file/Ideas01.pdf> [Accessed 2 June 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/ZZ2D-WLPG>

United Nations Department of Humanitarian Affairs. 1992. *Internationally agreed basic glossary of terms related to Disaster Management*. Geneva, United Nations Department of Humanitarian Affairs. Available at: <http://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/004DFD3E15B69A67C1256C4C006225C2-dha-glossary-1992.pdf> [Accessed 2 June 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/F5AP-ACVD>

United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization (UNESCO). 2003. *Convention for the Safeguarding of the Intangible Cultural Heritage*. Paris, UNESCO. Available at: <https://ich.unesco.org/en/convention> [Accessed 26 April 2017].

Adresa e internetit: <http://perma.cc/5ZXN-XCPV>

United Nations International Strategy for Disaster Reduction. 2009. *UNISDR Terminology on Disaster Risk Reduction*. Geneva, United Nations International Strategy for Disaster Reduction. Available at: http://www.unisdr.org/files/7817_UNISDRTerminologyEnglish.pdf [Accessed 8 June 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/85M4-6TB9>

United Nations Office for Disaster Risk Reduction. 2017. *Terminology – Capacity*. Geneva, United Nations Office for Disaster Risk Reduction. Available at: <https://www.unisdr.org/we/inform/terminology#letter-c> [Accessed 5 May 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/L88V-8EBA>

United Nations Office for Disaster Risk Reduction. 2017. *Terminology – Contingency Planning*. Geneva, United Nations Office for Disaster Risk Reduction. Available at: <https://www.unisdr.org/we/inform/terminology#letter-c> [Accessed 5 May 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/L88V-8EBA>

United Nations Office for Disaster Risk Reduction. 2018. *Words into Action Guidelines: Man-made and Technological Hazards. Practical considerations for Addressing Man-made and Technological Hazards in Disaster Risk Reduction*. Geneva, United Nations Office for Disaster Risk Reduction. Available at: https://www.unisdr.org/files/54012_manmadetechhazards.pdf [Accessed 29 April 2018].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/6PKN-W9ND>

United Nations Statistical Commission and Economic Commission for Europe. 2000. *Terminology on Statistical Metadata*. United Nations Statistical Commission and Economic Commission for Europe Conference of European Statisticians Statistical Standards and Studies No. 53, Geneva, United Nations. Available at: http://ec.europa.eu/eurostat/ramon/coded_files/UNECE_TERMINOLOGY_STAT_METADATA_2000_EN.pdf [Accessed 27 April 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/NG4Z-V7YE>

Hapi 1: Analiza e situatës

Australia International Council on Monuments and Sites (ICOMOS). 2013. *The Burra Charter: The Australia ICOMOS Charter for Places of Cultural Significance, 2013*. Burwood, ICOMOS. Available at: <http://australia.icomos.org/wp-content/uploads/The-Burra-Charter-2013-Adopted-31.10.2013.pdf> [Accessed 21 June 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/ULL9-UY9U>

Avrami, E., Mason R. & de la Torre, M. 2000. *Values and Heritage Conservation: Research Report*. Los Angeles, The Getty Conservation Institute. Available at: http://www.getty.edu/conservation/publications_resources/pdf_publications/pdf/valuesrpt.pdf [Accessed 18 January 2018].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/T4PS-KNPC>

Cockburn, A. 2001. *Writing Effective Use Cases*. New Jersey, Addison-Wesley. Available at: <http://alistair.cockburn.us/get/2465> [Accessed 29 April 2018].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/8LKF-RYNJ>

Department for International Development (DFID), n.d. *Conducting Conflict Assessments: Guidance Notes*. Available at: <http://www.conflictrecovery.org/bin/dfid-conflictassessmentguidance.pdf> [Accessed 20 January 2018].

Permalink: <https://perma.cc/XFC9-4HMN>

Inter-Agency Standing Committee. 2011. *IASC Operational Guidelines on the Protection of Persons in Situations of Natural Disasters*. Washington, DC, The Brookings – Bern Project on Internal Displacement. Available at: <https://docs.unocha.org/sites/dms/Documents/Operational%20Guidelines.pdf> [Accessed 27 April 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/85SP-6HKW>

International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies. 2010. *Project/Programme Planning Guidance Manual*. Geneva, International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies, Geneva. Available at: <http://www.ifrc.org/Global/Publications/monitoring/PPP-Guidance-Manual-English.pdf> [Accessed 8 May 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/3Q8E-EU7M>

International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies. 2012. Practical application of the recovery approach programme cycle. *IFRC Recovery programming guidance 2012*. Geneva, International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies. Available at: <http://www.ifrc.org/PageFiles/41104/IFRC%20Recovery%20programming%20guidance%202012%20-%201232900.pdf> [Accessed 8 May 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/L88B-XKZM>

International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies. 2017. *Contingency Planning*. Geneva, International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies. Available at: <http://www.ifrc.org/en/what-we-do/disaster-management/preparing-for-disaster/disaster-preparedness-tools/contingency-planning-and-disaster-response-planning/> [Accessed 8 June 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/W2BZ-U92R>

International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies. 2017. *Disaster and crisis management*. Geneva, International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies. Available at: <http://www.ifrc.org/en/what-we-do/disaster-management/> [Accessed 8 June 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/WP7R-ELK8>

International Union for Conservation of Nature (IUCN). *Situation Analysis – An Approach and Method for Analysing the Context of Projects and Programme*. Gland, International Union for Conservation of Nature. Available at: http://cmsdata.iucn.org/downloads/approach_and_method.pdf [Accessed 9 April 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/EG6K-E3TQ>

Kelley, S.J. 2013. *Typhoon and Earthquake Damage Assessment of Cultural Heritage: Damage assessment from natural disaster on the islands of Cebu, Bohol, Samar and Leyte*. Chicago, Stephen J. Kelly Preservation Architect/Engineer. Available at: <http://www.kelleyaia-se.com/philippines-typhoon-and-earthquake-damage-assessment.html> [Accessed 20 January 2018]

Adresa e internetit: <https://perma.cc/6LJB-2953>

Merriam-Webster. 2017. *Definition of Inventory*. Springfield, Merriam-Webster, Incorporated. Available at: <https://www.merriam-webster.com/dictionary/inventory> [Accessed 30 June 2017].

Pan American Health Organization (PAHO). 2009. *Information Management and communication in emergencies and disasters*. Washington, DC, Pan American Health Organization. Available at: https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/753BA3EC98D0AE21852576A40078B90C-PAHO_CommGuide_ResponseTeams_dec09.pdf [Accessed 20 January 2018].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/4BZQ-46TA>

Resource Planning and Development Commission. 2003. *Understanding Heritage Assets. State of the Environment Tasmania 2003*. Hobart. Department of Justice, Government of Tasmania. Available at: <http://soer.justice.tas.gov.au/2003/copy/73/index.php> [Accessed 29 April 2018].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/CNS7-SZNA>

United Nations International Strategy for Disaster Reduction. 2009. *UNISDR Terminology on Disaster Risk Reduction*. Geneva, United Nations International Strategy for Disaster Reduction. Available at: http://www.unisdr.org/files/7817_UNISDRTerminologyEnglish.pdf [Accessed 8 June 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/85M4-6TB9>

United Nations Refugee Agency. 2008. *A Community-based Approach in UNHCR Operations*. Geneva, United Nations Refugee Agency. Available at: <http://www.unhcr.org/47f0a0232.pdf> [Accessed 8 May 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/DVF2-K66V>

Van Balen, K. 2008. The Nara Grid: An Evaluation Scheme Based on the Nara Document on Authenticity. *APT Bulletin*, 39(2/3): 39-45. Available at: <http://orcp.hustoj.com/wp-content/uploads/2016/01/2008-The-Nara-Grid-An-Evaluation-Scheme-Based-on-the-Nara-Documents-on-Authenticity.pdf> [Accessed 17 January 2018].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/DL8A-E32V>

Hapi 2: Vlerësimi i dëmit dhe riskut në vend, pas ngjarjes

Abarquez, I. & Murshed, Z. 2004. *Field Practitioners' Handbook, Community-Based Disaster Risk Management*. Thailand, Asian Disaster Preparedness Center. Available at: <https://www.adpc.net/igo/category/ID428/doc/2014-xCSf7I-ADPC-12handbk.pdf> [Accessed 29 April 2018].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/2PU2-V57Q>

BC Housing. 2018. *Rapid Damage Assessment*. Burnaby, BC Housing. Available at: <https://www.bchousing.org/about/rapid-damage-assessment> [Accessed 18 February 2018].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/686P-5JFE>

Connecticut Technology Transfer Center. 2010. *Protective Equipment for Workers in Hurricane Flood Response*. Connecticut, School of Engineering, University of Connecticut. Available at: <https://www.t2center.uconn.edu/pdfs/SAFETY%20BRIEF%202010-7.pdf> [Accessed 9 February 2018].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/LG2T-FTDZ>

Department of Homeland Security Federal Emergency Management Agency (FEMA). 2016. *Damage Assessment Operations Manual: A Guide to Assessing Damage and Impacts*. Washington, DC, FEMA. Available at: <https://www.fema.gov/media-library-data/1459972926996-a31eb90a2741e86699ef34ce2069663a/PDAManualFinal6.pdf> [Accessed 31 January 2018].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/B3HC-8W2P>

Department of Homeland Security Federal Emergency Management Agency (FEMA). 2017. *ICS Glossary*. Washington, DC, FEMA. Available at: <https://training.fema.gov/emiweb/is/icsresource/assets/icsglossary.pdf> [Accessed 2 June 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/CF9H-D462>

Dorge, V. & Jones, S.L. 1999. *Building an Emergency Plan: A Guide for Museums and Other Cultural Institutions*. Los Angeles, The Getty Conservation Institute. Available at: http://www.getty.edu/conservation/publications_resources/pdf_publications/pdf/emergency_plan.pdf [Accessed 14 November 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/QZ7N-BRCK>

Esri. 2018. *What is GIS?* California, Esri. Available at: <http://www.esri.com/what-is-gis> [Accessed 7 February 2018].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/W3R9-TGSU>

Heritage Collections Council. 1998e. *reCollections: Caring for Collections Across Australia – Managing People*. Canberra, Heritage Collections Council. Available at: https://aiccm.org.au/sites/default/files/docs/reCollections/5_managing_people.pdf [Accessed 18 February 2018].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/RR45-BJDW>

Inter-Agency Standing Committee. 2011. *IASC Operational Guidelines on the Protection of Persons in Situations of Natural Disasters*. Washington DC, The Brookings – Bern Project on Internal Displacement. Available at: <https://docs.unocha.org/sites/dms/Documents/Operational%20Guidelines.pdf> [Accessed 27 April 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/85SP-6HKW>

International Council on Monuments and Sites (ICOMOS). 2010. *Methodology for Building Assessment and Mitigation following the January 12, 2010 Haiti Earthquake*. Paris, ICOMOS. Available at: http://www.rdmuch.jp/en/project/itc/training_guide/sections/section_3/files/ICOMOS_Haiti_Methodology.pdf [Accessed 6 March 2018].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/QYZ7-F93W>

International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies (IFRC). 2017. *Disaster and crisis management*. Geneva, IFRC. Available at: <http://www.ifrc.org/en/what-we-do/disaster-management/> [Accessed 8 June 2017].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/WP7R-ELK8>

Japan ICOMOS National Committee. 2011. *The Great East Japan Earthquake, Report on the Damage to Cultural Heritage*. Tokyo, Japan ICOMOS National Committee. Available at: http://www.japan-icomos.org/pdf/earthquake_report_20111120.pdf [Accessed 17 April 2018].

Adresa e internetit: <https://perma.cc/5QBL-ZNL7>

